



Banka Popullore
e Republikës së Maqedonisë së Veriut

RAPORTI VJETOR I VITIT 2022

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



Raport vjetor për vitin 2022

Shkup, prill 2023

Përmbajtja

Fjalimi i Guvernatores.....	4
I. Politika monetare në vitin 2022.....	9
1.1. Qëllime të politikës monetare.....	9
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	10
II. Mjedisi ndërkombëtar	15
III. Lëvizjet makroekonomike në vitin 2022.....	20
3.1. PBB-ja dhe inflacioni	21
3.2. Tregu i punës	25
3.3. Financat publike.....	27
3.4. Bilanci i pagesave, PNI dhe borxhi i jashtëm	31
3.5. Agregatët monetarë dhe kreditorë	36
3.5.1. Agregatët monetarë.....	36
3.5.2. Aktiviteti kreditor	39
IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare 2023 - 2025	41
V. Instrumentet monetare.....	44
Shtojcë 1. Lëvizje në tregun e valutave dhe ndërhyrjet e Bankës Popullore.....	47
Shtojca 2. Lëvizje në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara dhe në tregun sekondar të letrave me vlerë	51
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore	53
6.1. Gjendja dhe ndryshimet e rezervave valutore	53
6.2. Kushtet e tregjeve financiare ndërkombëtare dhe qasja aktive e investimit të rezervave valutore	54
6.3. Struktura e rezervave valutore	56
6.4. Rezultatet e menaxhimit dhe të investimit të rezervave valutore	57
VII. Shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave	60
7.1. Transaksionet e pagesave të kryera me instrumente pagesash pa para të gatshme	61
7.1.1. Transfertat e kredisë të iniciuara nga persona fizikë dhe juridikë	62
7.1.2. Kartelat e pagesave.....	63
7.2. Infrastruktura e pagesave.....	64
7.3. Sistemet e pagesave në vend.....	65
7.4. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht	66
VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe i monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut - operacionet e thesarit	67
8.1. Paratë e emetuara në qarkullim	67

8.2.	Furnizimi i bankave dhe i qendrave të parave të gatshme me kartmonedha dhe monedha	69
8.3.	Përpunimi dhe shkatërrimi i kartmonedhave dhe monedhave	69
8.4.	Ekspertiza e parave të dyshimta/falsifikuara	69
8.5.	Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për operacionet me para të gatshme në banka dhe qendrat e parasë së gatshme.....	71
8.6.	Shitja e monedhave për qëllime koleksioni	71
IX.	Auditimi i brendshëm.....	72
9.1.	Funksionimi i Komitetit të Auditimit.....	73
X.	Menaxhimi i burimeve njerëzore	74
XI.	Zbatimi i Programit të Punës për vitin 2022	77
	Qëllimi Strategjik 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës	79
	monetare	79
	Qëllimi Strategjik 2 – Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës	80
	së sistemit bankar.....	80
	Qëllimi Strategjik 3 – Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të pagesave të sigurta, inovative dhe efikase.	82
	Qëllimi Strategjik 4 – Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit.....	83
	Qëllimi Strategjik 5 - Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore.....	83
	Qëllimi Strategjik 6 – Rritje e transparencës dhe llogaridhënies.....	85
	Qëllimi Strategjik 7 – Edukim financiar dhe përfshirja.....	87
	Qëllimi Strategjik 8 - Rritja e vetëdijes për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër	90
	Qëllimi Strategjik 9 - Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore	91
	Kapaciteti institucional.....	94
11.1.	Kapaciteti institucional 1 – Integriteti dhe besimi në njësinë monetare kombëtare...94	
11.2.	Kapaciteti institucional: Burimet njerëzore.....	94
11.3.	Kapaciteti institucional: Sistemi i informacionit	95
11.4.	Kapaciteti institucional: Të dhënat statistikore.....	95
11.5.	Kapaciteti institucional: Veprimtari hulumtuese.....	96

Fjalimi i Guvernatores

Të nderuar!

Viti i kaluar 2022 ka një rëndësi të madhe për ne në shumë aspekte. Në vitin 2022 shënuam 30 vjetorin e mëvetësisë monetare. Shënuam tri dekada nga fillimi i ndërtimit të një shtylle të rëndësishme të shtetësisë - sovranitetit monetar. Gjatë viteve dëshmuam kriza dhe ristrukturime, të cilat me përpjekjet e gjeneratave para nesh, kontribuan në forcimin e Bankës Popullore si institucion. Por ky vit na solli edhe një sfidë të re ekonomike në nivel global dhe na kujtoi që, si bartës të politikave makroekonomike, duhet të monitorojmë vazhdimisht dhe me vigjilencë lëvizjet, për të reaguar në kohë.

Kështu, pas një dekade me inflacion të ulët global, në të cilin, krahas likuiditetit të madh, inflacioni ishte në synimet e bankave qendrore. Kjo prirej u ndërpre në gjysmën e dytë të vitit 2021 dhe inflacioni filloi të lëvizë në drejtim rritës, kryesisht nën ndikimin e rreziqeve globale dhe të krizës energjetike. Me fillimin e luftës në Ukrainë në muajt e parë të vitit 2022, pasiguria globale u rrit më tej dhe u pasqyrua në çmimet e produkteve bazë në tregun botëror. Për rrjedhojë, në vitin 2022, inflacioni arriti nivele historikisht të larta pothuajse në të gjitha ekonomitë dhe veçanërisht në ato më pak të zhvilluara. Kështu, në rajonin e Europës Qendrore dhe Juglindore, inflacioni mesatar arriti në 13.3%, ndërkohë që ne arriti në 14.2%, kundrejt 9% në Bashkimin Europian.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh se inflacioni ul të ardhurat reale të disponueshme të amvisërive, sidomos të atyre me të ardhura më të ulëta, rrit pasigurinë dhe primin e rrezikut, duke ndikuar kështu negativisht si në vendimet e konsumit ashtu edhe në ato të investimit, përkatësisht në mjedisin e rritjes ekonomike, bankat qendrore, duke përfshirë Bankën Popullore, ndonëse nuk bëhet fjalë për goditje standarde të kërkesës, nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të shtrëngojnë politikën monetare. Gjithashtu, pasiguria globale dhe rreziqet aktuale imponuan nevojën për një reagim të përshtatshëm ndaj politikave për të frenuar pritshmëritë inflacioniste.

Duke pasur parasysh strategjinë tonë monetare për kurs të qëndrueshëm të denarit, vendosja e politikës sonë monetare varet nga dy faktorë kyç - gjendjet e tregut valutor dhe trysnitë mbi kursin, si dhe lëvizjet e pritshmëritë inflacioniste. Trysnitë e para në këto dy segmente u vunë re me shfaqjen e krizës energjetike në fund të vitit 2021, kur edhe reaguam. Fillimisht filluam me uljen graduale të likuiditetit nëpërmjet ndërhyrjeve në tregun valutor dhe më pas, nga prilli i vitit 2022, vazhduam me rritjen e normës bazë të interesit (8 herë me 350 pikë bazë, duke e çuar normën e interesit në nivelin 4,75 % në fund të vitit). Në të njëjtën kohë u rritën edhe normat e interesit për depozitat njëditore, depozitat shtatëditore, kreditë njëditore dhe normat e interesit për operacionet repo. Në disa raste ndryshuam instrumentin e rezervës së detyrueshme, përmes të cilit nxitet procesi i denarizimit dhe financimi i gjelbër, të gjitha me qëllim të mbështetjes së stabilitetit në ekonomi.

Si rezultat i masave tona, së bashku me masat e politikëbërësve të tjerë, si dhe të stabilizimit të çmimeve të produkteve primare, tashmë është vërejtur një ngadalësim gradual i inflacionit, që prej nëntorit 2022. Njëkohësisht, në fund të vitit u vunë re edhe përmirësime në strukturën valutore të depozitave, gjatë lëvizjeve pozitive të depozitave në denarë dhe në afat më të gjatë. Në kushtet e reduktimit gradual të trysnive të krizës ekonomike në tregun valutor, në gjysmën e dytë të vitit u realizua një blerje neto në tregun valutor. Gjatë flukseve hyrëse të realizuara në bazë të huamarrjes së shtetit jashtë vendit dhe njëkohësisht rritjes së dukshme të flukseve

hyrëse në bazë të investimeve të huaja të drejtpërdrejta, rezervat valutore shënuan rritje. Edhe pse është ngadalësuar, ekonomia vazhdon të jetë në rritje, gjë që ka kontribuar edhe nga mbështetja solide e kredisë nga bankat (rritja e totalit të kredive në dhjetor arriti në 9,4%) dhe parakusht për këtë ishte dhe do të jetë ruajtja e stabilitetit financiar. Edhe pse e ngadalësuar, ekonomia vazhdon të jetë në rritje, për të cilën gjë kontribuoï edhe mbështetja solide kreditore e bankave (rritja e totalit të kredive në dhjetor arriti në 9,4%) dhe parakusht për këtë ishte dhe do të jetë ruajtja e stabilitetit financiar.

Në kontekst të ruajtjes së stabilitetit financiar, në vitin 2022 Banka Popullore miratoi disa masa për forcimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë së balanceve të sistemit bankar, në kushtet e pasigurisë së zgjatur në mjedisin ekonomik vendor dhe global. Në një mjedis të këtillë, kur ka mundësi të shfaqjes së rreziqeve të ardhshme, u vlerësua se bankat duhet të kenë kujdes në menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe në planifikimin e pozicioneve të tyre kapitale. Për këtë qëllim, në korrik u mor vendimi për vendosjen e një norme të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në ekonominë vendore në lartësinë 0,50%. Norma e shtresës kundërciklike të kapitalit u rrit nga 0,25 pikë përqindjeje, në 0,75% në dhjetor, duke vlerësuar pasiguritë e mëtejshme mjedisore dhe rritjen e rreziqeve sistimore ciklike, sidomos për shkak të çmimeve më të larta të pasurive të paluajtshme të ndjekura nga rritja e kredive banesore. Krahas kësaj mase makroprudenciale, u mor një vendim që përcakton më saktë mënyrën e llogaritjes së treguesve për cilësinë e kërkesës për kredi, për unifikimin më të madh të mënyrës së llogaritjes së këtyre treguesve nga bankat. Këta tregues të kërkesës për kredi janë në përputhje me Ligjin e Stabilitetit Financiar të miratuar gjatë vitit 2022, si dhe në përputhje me praktikën përkatëse europiane.

Treguesit e gjendjeve në sistemin bankar theksojnë ruajtjen e suksesshme të qëndrueshmërisë dhe aftësisë së tij për të dhënë mbështetje kreditore edhe në periudhën e ardhshme. Aftësia e pagesës e sistemit bankar u përmirësua, me ç'rast shkalla e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi rritje për 0,4 pikë përqindjeje, deri në nivelin më të lartë dhjetëvjeçar prej 17,7% në fund të vitit 2022. Likuiditeti i bankave i shprehur nëpërmjet pjesëmarrjes së mjeteve likuide në totalin e aktiveve u ruajt në nivel të kënaqshëm prej 30% në fund të vitit. Megjithatë mjedisi në të cilin punonin bankat ishte i mbushur me pasiguri dhe sfida të shumta për shkak të konfliktit ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, thellimit të krizës energjetike dhe të trysnive inflacioniste, nuk kishte efekte negative në bilanci të bankave, të cilat mbajnë cilësinë e mirë të portofolit të kredisë. Kështu, shkalla e kredive me probleme ishte 2,9% dhe ishte dukshëm më e ulët në krahasim me periudhën para e pandemisë.

Zotimet e Bankës Popullore për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe të çmimeve në vitin 2022 i theksoi edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në kuadër të Raportit të miratimit të mjeteve nga Instrumentit të Maturimit dhe të Likuiditetit. FMN-ja theksoi se Banka Popullore vazhdimisht zbaton politika të duhura dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj goditjeve të ndryshme, duke ruajtur me sukses stabilitetin dhe duke mbrojtur kursin e denarit. Për sa i përket stabilitetit financiar, FMN-ja tregoi se sistemi bankar është i mirëkapitalizuar dhe u reziston goditjeve. Në këtë kontributon edhe mbikëqyrja efektive, e cila funksionon sipas standardeve të larta ndërkombëtare, ka një kornizë të fortë juridike e rregulluese dhe praktika të duhura operative. Gjithashtu, FMN-ja në raport theksoi që gjatë realizimit të funksioneve të saj, Banka Popullore zbaton standarde të forta për funksionimin e përgjegjshëm dhe shkallë të lartë të transparencës në punë.

Puna dhe vendimet e Bankës Popullore u pranuan edhe nga Banka Qendrore Europiane (BQE), e cila mori një vendim duke zgjatur mundësinë që Banka Popullore të përdorë linjën e repove deri më 15 janar 2024, me ç'rast bankës sonë qendrore i vihet në dispozicion likuiditet valutash prej 400 milionë eurosh për thujtje një vit tjetër. Linja repo është vetëm një shtresë tjetër

mbrojtëse, duke marrë parasysh nivelin e lartë të rezervave valutore dhe likuiditetin e lartë të bankave, të cilat garantojnë stabilitetin e denarit dhe stabilitetin makrofinanciar. Një mbështetje e rëndësishme për politikat e zbatuara nga banka jonë qendrore përfaqëson edhe qasja e përdorimit të këtij instrumenti.

Në kuadër të [Raportit vjetor për përparimin drejt anëtarësimit në Bashkimin European](#), Komisioni European gjithashtu konstaton se, në përgjithësi, përcaktimi i politikës monetare në vitin 2022 është në përputhje me bazat ekonomike, duke iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme pritshmërive të tregut për rritjen e mëtejshme të inflacionit, duke zbutur njëkohësisht ndikimin negativ në ekonomi, të shkaktuar nga pandemia dhe kriza energjetike.

Ekipi i Bankës Popullore punoi pa u lodhur dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. Duke u përballur me trysnitë e çmimeve dhe sigurimin e stabilitetit të denarit, jo vetëm që i vazhduam projektet aktuale, por edhe përforcuam përpjekjet tona për të ruajtur hapin me bankat tjera qendrore dhe për të funksionuar sipas standardeve europiane.

Gjatë vitit 2022, banka qendrore ndërmori aktivitete të shumta për krijimin e parakushteve për zbatimin e Ligjit të ri të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave, zbatimi i të cilit filloi në fillim të vitit 2023. Dispozitat e kuadrit të ri rregullator përcaktojnë qartë detyrimet e ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe rrisin mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve të pagesave. Ligji i Shërbimeve të Pagesave dhe i Sistemeve të Pagesave transponon një numër të madh direktivash dhe rregulloresh të Bashkimit European në fushën e pagesave dhe pritet që të ndodhin ndryshime të rëndësishme në drejtim të zgjerimit të listës së ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe grupit të shërbimeve të pagesave, si dhe në drejtim të rregullimit më të hollësishëm të marrëdhënieve ndërmjet ofruesve dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave. Banka Popullore përgatiti dhe miratoi 25 akte nënligjore të paracaktuara për bankat, me të cilat operacionalizohet zbatimi i ligjit.

Duke marrë parasysh nevojën për ofrimin e të dhënave të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse të instrumenteve financiare, Banka Popullore filloi publikimin e të dhënave të reja statistikore për treguesin e letrave me vlerë të borxhit. Ky tregues pasqyron lidhjet financiare midis sektorëve të ekonomisë kombëtare, si dhe ndërmjet sektorëve të ekonomisë kombëtare dhe sektorit të jashtëm, në bazë të letrave me vlerë të borxhit. Prodhimi i treguesit për letrat me vlerë të borxhit është një hap tjetër i Bankës Popullore drejt sigurimit të treguesve të nevojshëm shtesë në kornizat e standardit më të lartë statistikor për shpërndarjen e të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar - SDDS plus.

Në faqen e saj të internetit, në mesin e të dhënave dhe të treguesve të sistemit bankar, Banka Popullore filloi të publikojë të dhëna tremujore për kreditë e financimit të gjelbër të miratuara për individët dhe shoqëritë jofinanciare. Publikimi i këtyre të dhënave është një nga aktivitetet e Bankës Popullore që kontribuon në krijimin e një ekonomie "të gjelbër" dhe të qëndrueshme. Në fillim të vitit 2022, Banka Popullore bëri një Anketë për rreziqet nga ndryshimet klimatike, sipas së cilës, 40% e bankave vendore dhe e kursimoreve kanë ofruar produkte dhe shërbime si reagim ndaj ndryshimeve klimatike, ndërsa 80% e të pyeturve u përgjigjën që po mendojnë të ofrojnë produkte dhe shërbime të reja si përgjigje ndaj ndryshimeve klimatike.

Me nismë të Bankës Popullore dhe për të krijuar kushte për mbështetjen e zhvillimit të sektorit fintech, rregullatorët financiarë - Banka Popullore (BP), Ministria e Financave (MF), Komisioni i Letrave me Vlerë (KLV), Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve Pensionale të Financuara Kapitale (MAPAS) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), lidhën një Memorandum Bashkëpunimi. Memorandumi vendos një sistem, përmes të cilit rregullatorët do të koordinohen kur të veprojnë – secili sipas kompetencave që ka, në lidhje me zbatimin e

Strategjisë kombëtare për sektorin fintech, versionin e parë të së cilës Banka Popullore tashmë e ka përgatitur.

Në vitin 2022, Banka Popullore vazhdoi me aktivitete të përforcuara në fushën e edukimit financiar, që kontribuon në ngritjen e edukimit financiar dhe të përfshirjes financiare të popullsisë në vendin tonë. Në të njëjtën kohë, vazhduan aktivitetet për zbatimin e Strategjisë së edukimit financiar dhe të përfshirjes financiare, të miratuar në korrik të vitit të kaluar. Banka Popullore, gjatë vitit të kaluar i kushtoi vëmendje të veçantë forcimit të mbrojtjes së konsumatorëve në sektorin bankar, me ç'rast në tremujorin e parë filloi punën një njësi e veçantë organizative për mbrojtjen e konsumatorëve dhe për edukimin financiar. Krahas përgatitjes së akteve të brendshme, vendosjes së një sistemi të regjistrimit, verifikimit të gjetjeve nga ankesat e konsumatorëve ndaj bankave dhe reagimi i tyre, u punua edhe në mbledhjen e të dhënave dhe analizën e pozicionit të bankave në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Perspektivat europiane vazhdojnë të kenë rëndësi të madhe strategjike për Bankën Popullore. Në kornizat e monitorimit fillestar, në gjysmën e dytë të vitit 2022, përfaqësues të Bankës Popullore morën pjesë në takimet e fazës dypalëshe të shqyrtimit analitik të disa kapitujve në të cilat është përfshirë Banka Popullore.

Ky vit ka një rëndësi të madhe për ne në shumë aspekte. Në vitin 2022 festuam edhe [30 vjetorin e mëvetësisë monetare](#). Banka Popullore e festoi këtë përvjetor duke e gërshtuar në aktivitete me të cilat u rikthye në histori. Për përvjetorin e rëndësishëm kombëtar, ne ruajtëm Akademinë solemne dhe Konferencën kërkimore të Bankës Popullore, organizuar në partneritet me Bankën Europiane të Investimeve (BEI), ku morën pjesë guvernatorët e bankave qendrore nga rajoni dhe nga Europa, si dhe përfaqësues të organizatave financiare ndërkombëtare, publikut shkencor dhe sektorit bankar. Me rastin e 30 vjetorit të mëvetësisë monetare, përkatësisht funksionimit të bankës sonë të pavarur qendrore, Banka Popullore publikoi botimin ["30 vjet nga mëvetësia e Bankës Popullore: sfidat, reformat dhe përmirësimi i punës"](#).

Në Muzeun e Bankës Popullore u hap solemnisht ekspozita "Vlerat dhe vlefshmëritë", me të cilën për një periudhë gjashtëmujore, qytetarët kishin mundësinë të shohin trashëgiminë tonë kulturore të përkthyer në kartëmonedha maqedonase. Në hapësirat e ekspozitës muzeale, Banka Popullore organizoi debat për të nxjerrë në pah të mendimit shkencor dhe artistik, nxitur diskutimin për vlerat nga këndvështrime të ndryshme profesionale, për të dhënë një retrospektivë të ngjarjeve dhe të përvojave gjatë mëvetësisë monetare të vendit dhe krijimit të sistemit modern ekonomik, si dhe për të përfshirë perspektivat e ardhshme në kornizat e zhvillimeve aktuale ekonomike globale. Si pjesë të mozaikut të manifestimeve kushtuar shënimit të tridhjetëvjetorit të mëvetësisë sonë monetare, u organizua një tribunë ku gazetarët e redaksive ekonomike të të gjitha medieave diskutuan për transparencën e Bankës Popullore, me ç'rast u theksua bashkëpunimi i deritashëm dhe komunikimi i hapur, si domosdoshmëri e tashme dhe e mëtejshme për gazetari ekonomike cilësore dhe mbështetje të transparencës për zbatimin efikas të politikës monetare.

Dhe pikërisht këtë vit, 2022, në të cilin shënuam përvjetorin e shënuar, u dëshmuua se investimi në kapitalin njerëzor, të cilin Banka Popullore e bën rregullisht, ngjashëm si në dekadat e fundit, bëri të mundur fitoret e korrura gjatë 30 vitet e fundit, në periudha krizash, por edhe të suksesshme. Në të gjitha vitet e kaluara, përfshirë edhe këtë, majtëm stabilitetin e denarit, një nga simbolet e shtetësisë sonë dhe spirancën e stabilitetit të ekonomisë sonë.

Të respektuar!

I respektuar,

Vënia në dukje e zotimeve dhe e sukseseve gjatë festimit të çdo viti të kaluar është një kënaqësi profesionale dhe morale për ne. Raporti vjetor është një rast për t'iu rikthyer angazhimit tonë të pandalshëm për arritjen e qëllimit tonë kryesor – ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, edhe në kushte të këtilla sfidash të jashtëzakonshme për politikën monetare. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore do të vazhdojë të monitorojë me kujdes zhvillimet makroekonomike dhe është e gatshme të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të garantuar stabilitetin afatmesëm të çmimeve, i cili është parakusht për rritjen e qëndrueshme ekonomike, si dhe për një jetë më të mirë të qytetarëve.

Viti që kaloi ishte i vështirë për të gjithë. Për Bankën Popullore ishte një sfidë të cilës iu përgjigjëm me profesionalizëm dhe kompetencë.

28 prill 2023
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja e Këshillit të
Bankës Popullore
Dr. Anita Angellovska-Bezhovska

I. Politika monetare në vitin 2022

Stabilitet i ruajtur i kursit
valutor të denarit

Ngadalësim i filluar i
inflacionit në fund të vitit

Ruajtje e nivelit të
mjaftueshëm të rezervave
valutore


1.1. Qëllime të politikës monetare

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve është qëllimi kryesor i përcaktuar ligjërisht i politikës monetare të Bankës Popullore. Një objektiv tjetër, në varësi të objektivit kryesor, është të kontribuojë në ruajtjen e një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe konkurrues, të orientuar nga tregu. Banka Popullore mbështet edhe politikën e përgjithshme ekonomike pa e rrezikuar arritjen e qëllimit kryesor dhe në përputhje me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë. Nga pikëpamja strategjike, nga tetori i vitit 1995, strategjia e mbajtjes së kursit nominal stabil të denarit është zbatuar deri në vitin 2001 në raport me markën gjermane, e më pas në raport me euron.

Në fillim të vitit 2022, ekonomia e vendit u përball me një goditje të re, të papritur, me karakter joekonomik, e cili e ndërlikoi më tej mjedisin për zhvillimin e politikës monetare. Lufta në Ukrainë që filloi në shkurt të vitit 2022 dhe sanksionet e kufizimet tregtare të vendosura ndaj Rusisë, rritën përsëri pasigurinë në ekonominë globale dhe shkaktuan goditje të mëtejshme të çmimeve në tregjet botërore të energjisë dhe të produkteve ushqimore. Nisur nga hapja e lartë dhe varësia e ekonomisë së vendit nga importi, efektet e mjedisit global u pasqyruan në ekonominë e vendit, e cila, në kushtet kur ende ka pasoja të Covid-19, u përball me inflacionin e lartë, thellimin e disbalancave të jashtme dhe trysnitë e tregut valutor. **E prirë nga dispozitat themelore ligjore, gjatë vitit 2022, Banka Popullore monitoroi me kujdes mjedisin e ndryshueshëm, duke përshtatur në mënyrën e duhur politikën monetare për të realizuar qëllimet e përcaktuara me ligj.** Në kushtet e një strategjie të kursit valutor fiks "de fakto" të denarit në raport me euron, këto zhvendosje imponuan nevojën për ndryshime në politikën monetare nëpërmjet stabilizimit të pritshmërive inflacioniste dhe të inflacionit në afat të mesëm, duke ruajtur stabilitetin e valutës vendore, njëkohësisht duke ndjekur edhe ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane. Për këtë qëllim, nga fundi i vitit 2021 Banka Popullore filloi me normalizimin gradual të politikës monetare, që u bë përmes menaxhimit të përshtatshëm të likuiditetit, si dhe me rritje graduale të normës bazë të interesit në disa raste, duke filluar nga prilli 2022. Shtrëngimi i politikës monetare kontribuoi në uljen e pritshmërive inflacioniste, në stabilizimin e tregut valutor, ndërkaq në fund të vitit edhe në inflacion. Inflacioni mesatar në vitin 2022 ishte 14,2%, që është një lëvizje më e theksuar rritëse e çmimeve të vendit me bazë vjetore. Niveli më i lartë i çmimeve është kryesisht një pasqyrim i faktorëve në anën e ofertës dhe i rritjes historikisht të lartë të çmimeve të importit, i cili shkaktoi rritjen e komponentit vendas të çmimeve të energjisë dhe të produkteve ushqimore, ndërkaq në një masë më mesatare, edhe të inflacionit bazë. Megjithë mjedisin e pasigurt dhe nivelit më të lartë të çmimeve në vitin 2022, stabiliteti i kursit të këmbimit u ruajt me sukses dhe rezervat valutore mbetën në nivelin e duhur në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe janë në zonën e sigurt. Në vitin 2022, stabiliteti financiar u ruajt gjithashtu me sukses, ndërkaq u morën disa vendime makroprudenciale që kontribuan në forcimin plotësues të bazës së kapitalit të bankave dhe rezistimin e tyre ndaj goditjeve.

Grafiku 1

Hendeku prodhues dhe inflacioni*



Grafiku 2


Rezervat valutore bruto



* Hendeku i prodhimit paraqet treguesin e pozicionit ciklik të ekonomisë dhe llogaritet si një devijim të realizuar nga niveli potencial i PBB-së në raport me nivelin e mundshëm të PBB-së (hendeku i prodhimit = (PBB e realizuar – PBB potencial)/PBB potencial). Ndryshimi mesatar vjetor (në %) tregohet te inflacioni total dhe ai bazë.

Grafiku 3

Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave Tregues të përzgjedhur të stabilitetit financiar



* Sipas rregullit Greenspan dhe Guidotti, vendi duhet të ruajë mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimit të mbetur) me rezerva valutore.

** Aktivitetet likuide përbëhen nga aktive me likuiditet të lartë dhe depozita me afat të shkurtër pranë bankave të huaja. Totali i aktiveve nuk përfshin mjetet e bankat vendase.

*** Treguesi ka të bëjë me kreditë për sektorin financiar dhe jofinanciar, ndërsa të dhëant e vitit 2016 përfshijnë ndryshime nga ndryshimet rregullatore.

Burimi: BPRMV dhe ESSh.

1.2. Pozicionimi i politikës monetare


Edhe gjatë vitit 2022, Banka Popullore normalizon politikën monetare, proces i nisur nga fundi i vitit 2021. Si përgjigje ndaj lëvizjeve në rritje të inflacionit dhe pritshmërive inflacioniste, në prill të vitit 2022 Banka Popullore filloi me një rritje graduale të normës bazë të interesit, ndërsa në fund të të njëjtit vit, në disa raste deri në nivelin 4,75%, duke ruajtur njëkohësisht shumën e ofruar të bonove të thesarit në nivelin prej 10.000 milionë denarë. Njëkohësisht, u rritën normat e interesit për depozitat njëditore dhe shtatëditore, në nivelin 2,65%, përkatësisht 2,70%. Duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit valutor stabil të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare të vendit pasuan ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane. Pozicionimi monetar u mbështet edhe me masa shtesë, pra me ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme që synojnë reduktimin e euroizimit, por edhe nxitjen e kreditimit të projekteve për burimet e rinovueshme të energjisë. Ky pozicionim i politikës monetare kontribuoi edhe në uljen e trysnive në tregun

valutor dhe në ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor. Gjatë vitit 2022 u miratuan masa makroprudenciale, si vendosja e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për ekspozimet ndaj vendeve të tjera, që forcon edhe më shumë mekanizmat mbrojtës në sistemin bankar. Totali i depozitave vazhdon të rritet në bazë vjetore, por ngadalë, në kushte pasigurie. Rreziqet afatshkurtëra dhe afatmesme për ekonominë globale dhe vendase mbeten të larta, kurse lufta në Ukrainë është ende burimi kryesor i rreziqeve, veçanërisht në tregjet e energjisë dhe të produkteve ushqimore. Banka Popullore monitoron rregullisht dhe me kujdes parametrat kryesorë ekonomikë dhe rreziqet e mundshme nga mjedisi i vendit dhe i jashtëm, me qëllim të përshtatjes së duhur të politikës monetare dhe të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve në afat të mesëm.

Mjedisi makroekonomik në vitin 2022 imponoi nevojën për normalizimin e mëtejshëm të politikës monetare, me një shtrëngim gradual të kushteve financiare, për të stabilizuar trysnitë e çmimeve dhe pritshmëritë inflacioniste. Këto ndryshime kanë të bëjnë edhe me stabilizimin e tregut valutor, i cili në gjysmën e parë të vitit ishte në tryzni më të madhe, kryesisht si pasqyrim i krizës energjetike, dhe pjesërisht nën ndikimin e prirjes për të disponuar valutë. Në fillim të vitit, në tregun valutor kishte nevojë të shtuar për valuta nga kompanitë, për shkak të rritjes së importit të energjisë, në kushtet e rritjes së ndjeshme të çmimeve botërore të këtyre produkteve. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, këto tryzni u ulën ndjeshëm si rezultat i lëvizjeve solide në bilancin e pagesave dhe pjesërisht si rezultat i përdorimit të një spektri të gjerë instrumentesh nga Banka Popullore.

Niveli i çmimeve në ekonominë së vendit në vitin 2022 shënoi rritje mesatare vjetore prej 14,2%, e cila shoqërohet më së shumti me çmimet më të larta të energjisë dhe të produkteve ushqimore, të shkaktuara nga goditjet e ofertës globale. Megjithatë, gjatë pritshmërive inflacioniste në rritje, rreziqet e pranishme në kushtet e rritjes së pagave, si dhe me perceptimet për efekte më të theksuara të transferueshme ndaj çmimeve të tjera, Banka Popullore veprimi me shtrëngim, në përputhje me ciklin fillestar të shtrëngimit monetar dhe në korniza globale.

Grafiku 5
Rishikime të projeksioneve makroekonomike



Burimi: BPRMV dhe ESHS. Projektionet për të gjithë treguesit kanë të bëjnë me projektionet makroekonomike të BPRMV-së.

Rezervat valutore shënuan rritje gjatë vitit 2022, duke mbetur në zonën e sigurt. Rritja e rezervave valutore në pjesën më të madhe është rezultat i transaksioneve në emër të shtetit¹. Nga ana tjetër, Banka Popullore ndërhyr me shitje neto të valutave në tregun valutor, pak më shumë në krahasim me vitin 2021, për shkak të ngjarjeve në gjysmën e parë të vitit, kur efektet e rritjes së çmimeve të energjisë dhe të produkteve ushqimore në mbarë botën ishin më të theksuara, ndërkaj të shkaktuara nga lufta në Ukrainë. Megjithatë, zhvillimet e qëndrueshme pozitive financiare në korniza të llogarisë financiare të bilancit të pagesave, sidomos në gjysmën e dytë të vitit, mundësuan financimin e plotë të deficitit të lartë të llogarisë rrjedhëse dhe të rritje shtesë të rezervave valutore.

¹ Huamarrja e shtetit në tregun e huaj nëpërmjet një obligacioni për tregun financiar gjerman, të emetuar në fund të shtatorit 2022, me vlerë prej 250 milionë euro dhe tërheqja e kështu të parë të Instrumentit të Kujdesit dhe të Likuiditetit (PLL), miratuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në nëntor 2022, në vlerë prej 110 milionë euro (nga 530 milionë euro gjithsej të miratuar nga marrëveshja).

Grafiku 6
Ndërhyrja e BPRMV-së në tregun valutor (milione euro)



Burimi: BPRMV.


Gjatë vitit rriten edhe depozitat e sektorit privat, por ngadalë, për shkak të pasigurisë së shkaktuar nga kriza e re gjeostrategjike, e cila ka ndikuar edhe në strukturën valutore, të maturimit dhe sektorale të depozitave. Rritja vjetore e depozitave të përgjithshme në vitin 2022 është 4,9%. Nga pikëpamja sektorale, rritja vjen kryesisht nga rritja e depozitave të individëve, gjatë rritjes vjetore më të ulët të depozitave të ndërmarrjeve. Nga këndvështrimi valutor, rritja vjen nga depozitat në valutë të huaj, të cilat shënuan rritje më të fortë në gjysmën e parë të vitit, ndonëse në gjysmën e dytë të vitit është përshpejtuar edhe rritja e depozitave në denarë (përfshirë edhe paratë depozituese). Nga këndvështrimi i strukturës së maturimit, rritja vjen kryesisht nga komponenti më likuid i depozitave, pra nga rritja e parasë depozituese, gjatë rritjes edhe të depozitat afatshkurtra, ndërsa rënie të lehtë shënuan depozitat afatgjata. Megjithatë, duhet theksuar se kah fundi i vitit është vërejtur rritje e depozitave në denarë dhe e atyre afatgjata, që tregojnë për forcimin e besimit në monedhën vendase dhe në sistemin bankar, ndërkohë që pjesërisht është rezultat i ndryshimeve monetare nga Banka Popullore.

Nga pikëpamja e *kredive të sektorit privat*, rritja e tyre u përshpejtua gjatë vitit 2022, duke arritur në 9,4%. Nga pikëpamja sektorale, rritja rezulton nga kontributi më i lartë pozitiv i kredive të ndërmarrjeve, gjatë kontributit pozitiv më të ulët të kredive të amvisërive. Në aspekt të strukturës valutore, kontribut pozitiv kanë edhe kreditë në valutë vendase dhe të huaj (përfshirë kreditë në denarë me klauzolë valutore).

Duke pasur parasysh zbatimin e e strategjisë së kursit të qëndrueshëm nominal të denarit në raport me euron, ndryshimet e *normave të interesit në eurozonë*, si spirancë ekonomike, luajnë një rol të rëndësishëm në pozicionimin e politikës monetare të vendit. Gjatë vitit 2022, Banka Qendrore Europiane (BQE) filloi të shtrëngonte politikën monetare, me ç'rast në fund të vitit, norma bazë e interesit arriti në nivelin 2,5%, ndërkohë që dallimi ndërmjet normave të interesit të Bankës Popullore dhe BQE-së ishte 2,25 p.p. Sa u përket normave të interesit të bankave në ekonominë vendase, dallimi ndërmjet normës së interesit në denarë dhe normës së interesit në depozita në valuta në vitin 2022 shënoi zgjerim minimal (nga 0,6 p.p në 0,7 p.p), si rezultat i zhvendosjes pak më të theksuar në rritje të normës së interesit të depozitave në denarë, në raport me rritjen e normës së interesit të depozitave në valutë, në përputhje me masat e ndërmarra nga Banka Popullore.


Grafiku 7

Dallimi i normave bazë të interesit të BPRMV-së dhe BQE-së, në p.p.



Grafiku 8

Dallimi i normave të interesit të bankave në ekonominë vendase, në p.p.



Norma bazë e interesit e BPRMV-së: norma e interesit për bonot e thesarit të BPRMV-së.

Norma bazë e interesit BQE-së: norma e interesit për operacionet kryesore të rifinancimit të BQE-së.

II. Mjedisi ndërkombëtar²

Në fillim të vitit 2022, ekonomia globale u përball me një tjetër goditje të natyrës joekonomike, por me pasoja të mëdha ekonomike globale. Pushtimi ushtarak i Ukrainës shkaktoi një ringritje të pasigurisë së nivelit të lartë, një rënie të besimit dhe goditje çmimesh në tregjet globale të ushqimit dhe të energjisë, të cilat, së bashku me zinxhirët e ngadalësuar të furnizimit për shkak të pandemisë, çuan në inflacion global që nuk mbahet mend në dekadat e fundit. Në këtë kontekst, bankat qendrore, përfshirë edhe ato të rëndësishme botërore, filluan të shtrëngojnë politikën monetare, me ç'rast u ashpërsuan ndjeshëm edhe kushtet e tregjeve financiare.


Duke pasur parasysh mjedisin e pafavorshëm, rritja e ekonomisë globale në vitin 2022 vlerësohet në 3,4%, që paraqet një ngadalësim të konsiderueshëm në krahasim me vitin 2021 (6,2%). Ngadalësimi i rritjes ekonomike është i përhapur në mbarë botën, por një ngadalësim më i fortë vërehet në ekonomitë e përparuara, të cilat arritën shkallë, mesatarisht, dyfish më të ulët të rritjes, në krahasim me vitin 2021.

Rritja ekonomike globale do të ngadalësohej më tej në vitin 2023 dhe do të shoqërohej me pasiguri të lartë. Përkeqësimi i situatës ushtarake në Ukrainë vazhdon të jetë burimi kryesor i cenueshmërisë së ekonomisë globale, veçanërisht i vendeve evropiane dhe me të ardhura të ulëta, e pasqyruar nga një rritje e mundshme e serishme e çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve, me pasoja negative në të ardhurat reale, konsumin dhe tregtinë globale.


Përkeqësimi i situatës ushtarake në Ukrainë vazhdon të jetë burimi kryesor i cenueshmërisë për ekonominë globale, veçanërisht për vendet evropiane dhe me të ardhura të ulëta, e pasqyruar nga një rikthim i mundshëm i çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, me pasoja negative në të ardhurat reale, konsumin dhe tregtinë globale. Ndikim të njëjtë do të kishin edhe mbijetesa e zgjatur e niveleve të larta të inflacionit, përkeqësimi i problemeve të borxhit në kornizat e kushteve të shtrënguara financiare globale, përkeqësimi i mundshëm i problemeve që lidhen me zinxhirët e furnizimit dhe forcimi i fragmentimit gjeopolitik. Nga ana tjetër, rënia e mundshme më e shpejtë e inflacionit, e me këtë edhe kushtet më të ngadalësuara financiare globale, si dhe rritja më e fortë e kërkesës agregate, mund të ndikojnë në mënyrë të favorshme në rritjen ekonomike globale.

² Analiza bazohet në "Analiza ekonomike botërore" të FMN-së, të përditësuar në tetor të vitit 2020 dhe janar të vitit 2021; "Perspektiva Ekonomike Globale e Bankës Botërore", janar 2021; raportet tremujore të Bankës Popullore.

Grafiku 9
Rritja ekonomike globale (në %)



Grafiku 10
Rritja ekonomike në vendet e zhvilluara (në %)



Burimi: Analiza ekonomike botërore, përditësuar në tetor të vitit 2022 dhe janar të vitit 2023, FMN.

Në lidhje me inflacionin global, rritja e çmimeve, e cila filloi të përshpejtohej nga fundi i vitit 2021, vazhdoi fuqishëm në vitin 2022 dhe arriti në 8,8% (4,7% në 2021).


Rritja e përshpejtuar e çmimeve është kryesisht një pasqyrim i rritjes së çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve, në përputhje me lëvizjet e çmimeve në tregjet botërore të aksioneve, të ndikuar nga konflikti ushtarak ruso-ukrainas dhe kur zinxhirët e furnizimit janë ende të ngadalësuar. Vështruar në grupe vendesh, më 2022, norma e inflacionit në ekonomitë e zhvilluara është 7,3% (3,1% në 2021), kurse në ekonomitë me rritje të shpejtë dhe ato në zhvillim, inflacioni u rrit në 9,9% mesatarisht (5,9% në 2021). Megjithatë, në muajt e fundit të vitit, nën ndikimin e uljes së çmimeve të produkteve primare, inflacioni global shënoi një rrugë rënësë, e cila do të ishte karakteristike edhe për periudhën e ardhshme.

Grafiku 11
Shkalla globale e inflacionit (në %)



Burimi: Burimi: Analiza ekonomike botërore, përditësuar në tetor të vitit 2022 dhe janar të vitit 2023, FMN.

Grafiku 12
Norma referente interesi në vendet e zhvilluara (në %)



Burimi: Bankat qendrore.

Në lidhje me treguesit sasiorë që pasqyrojnë mjedisin e jashtëm të ekonomisë maqedonase, rritja te kërkesa e huaj efektive vlerësohet të ngadalësohet në vitin 2022, ndërkohë që inflacioni i huaj efektiv u përshpejtua ndjeshëm. Vlerësimet tregojnë rritje të kërkesës së huaj efektive prej 2,6% (kundër rritjes prej 4,3% në vitin 2021), gjatë një rritjeje ekonomike në të gjitha vendet partnere tregtare, me kontributin më të madh pozitiv të Gjermanisë, Greqisë dhe Bullgarisë. Rritja më e ngadaltë e kërkesës së huaj efektive është

kryesisht një pasqyrim i përkeqësimit të mjedisit ekonomik global, për shkak të ndikimeve negative të luftës në Ukrainë, e më fuqishëm në ekonominë gjermane, e cila është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar. Sa u përket çmimeve të huaja efektive për vitin 2022, mesatarisht, realizuan një rritje të lartë prej 9,6% (kundër rritjes prej 2,7% në 2021), si pasqyrim i rritjes së çmimeve në të gjitha vendet, me kontributin më të madh të Gjermanisë, Servisë dhe Bullgarisë³.

Grafiku 13
Kërkesa efektive e jashtme



Grafiku 14
Inflacioni efektiv i jashtëm



Burimi: Entet kombëtare të statistikës dhe llogaritjet e PBRMV-së⁴.

Në tregjet e produkteve primare, në vitin 2022, sipas mesatares, është vërejtur rritje e çmimeve në krahasim me vitin 2021, që ka ardhur si pasojë e rritjes së fortë të çmimeve në gjysmën e parë të vitit, për shkak të përshkallëzimit të luftës në Ukrainë. Çmimi i naftës në qershor arriti kulmin dhe ishte 111,4 euro për fuçi, që më pastaj të ndjekë një rrugë në rënie, në kushte të frikës në rritje të një recesioni global dhe të kërkesës më të dobët për naftë nga Kina, për shkak të masave kufizuese në lidhje me Covid-19. Rrjedhimisht, çmimi mesatar i naftës së papërpunuar në vitin 2022 është 94,1 euro për fuçi dhe është për 56,8% më i lartë se në vitin 2021 (60,0 euro për fuçi). Në vitin 2022, çmimet e produkteve ushqimore bazë në bursat botërore shënuan gjithashtu një rritje të konsiderueshme prej 28,1%, nën ndikimin e efekteve të luftës në Ukrainë, kurse rritja e çmimeve të metaleve bazë ishte më e dobët dhe ishte 5,7%.

³ Inflacioni në Serbi, Kroaci dhe Poloni është përshtatur për ndryshimet e kursit valutor.

⁴ Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shuma e indekseve të PBB-së së ponderuar të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të vendit tonë. Në përllogaritjen e indeksit janë përfshirë: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Peshat janë llogaritur në bazë të peshës së eksporteve në këto vende në totalin e eksporteve. Ponderët janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksporteve në këto vende në totalin e eksporteve. Inflacioni i jashtëm efektiv përfaqëson një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve partnere më të rëndësishme të vendit tonë, në fushën e importit të mallrave të konsumit të gjerë. Struktura ponderuese bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal të secilit prej vendeve në totalin e importit nominal në periudhën 2016-2018. Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihen: Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Spanja, Austria, Sllovenia, Bullgaria, Polonia, Kroacia dhe Serbia.


Grafiku 15

Lëvizja mujore e çmimeve të prodhimeve primare energjetike dhe joenergjetike (euro, indeksi: 2010=100)



Grafiku 16

Lëvizja mujore e çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve⁵ dhe ushqimit (euro, indeksi: 2010=100)



Burimi: Baza e të dhënave të FMN-së për çmimet e prodhimeve primare.

Gjatë vitit 2022, pjesa më e madhe e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara udhëhoqën një politikë monetare të shtrënguar, në kushtet e rritjes së trysnive inflacioniste. Kështu, në mars, FED-i rriti normën referente të interesit për 0,25 p.p., rritja e parë në pak më shumë se tre vjet. Më herët, në shkurt, FED-i vazhdoi të reduktonte blerjen e letrave me vlerë të thesarit dhe të letrave me vlerë të hipotekave, ndërsa kjo masë u ndërpre në në mars. Në muajt në vijim, gjatë trysnive të zgjatura të çmimeve, FED-i vazhdoi me shtrëngime më të shpeshta dhe më të forta të politikës monetare. Kështu, gjatë vitit, norma referente e interesit u rrit shtatë herë, pra me 4,25 p.p., bashkërisht, që në dhjetor lëvize në një interval prej 4,25% në 4,5%. Në të njëjtën kohë, gjatë kësaj periudhe FED-i reduktoi gradualisht portofolin e saj të letrave me vlerë të thesarit dhe të letrave me vlerë të hipotekave. Pas rritjes fillestare në fund të vitit 2021, Banka e Anglisë vazhdoi me një korrigjim gradual, në rritje, të normës referencë të interesit në katër raste, me 0,25 p.p., bashkërisht, gjatë gjysmës së parë të vitit 2022. Në periudhën në vijim, gjatë shkallëve maksimale të inflacioni, ajo vazhdoi me shtrëngimin monetar, pra me 2,25 p.p., bashkërisht në gjysmën e dytë të vitit, duke e çuar normën referente të interesit në 3,5% në dhjetor. Gjithashtu, në vitin 2022, Banka e Anglisë filloi ekzekutimin e programit të shitjes së mjeteve, duke ulur portofolin e letrave me vlerë në bilancin e bankës.

Normat themelore të interesit të Bankës Qendrore Europiane (BQE) mbetën të pandryshuara gjatë gjysmës së parë të 2022, por rritja graduale e tyre u njoftua në gjysmën e dytë, pas përfundimit të programit të lehtësimit sasior (APP), i cili u mbyll më 1 korrik të vitit 2022. Veç kësaj, deri në fund të marsit, BQE vazhdoi blerjen e letrave me vlerë, në bazë të programit të blerjes së mjeteve për mbështetje të menjëhershme të ekonomisë për shkak të pandemisë (PEPP), por në mënyrë të moderuar⁶. Për herë të parë në më shumë se një dekadë, BQE-ja rriti në korrik tre normat bazë të interesit (me 0,5 p.p.), që njëkohësisht përfaqëson një dalje nga zona negative e normës së interesit për depozitat e disponueshme⁷. Në shtator dhe tetor, BQE rriti më tej normat bazë të interesit me 0,75 p. p. dhe në dhjetor me 0,5 p.p. Që nga fillimi i procesit të normalizimit, normat bazë të interesit u rritën me 2,5 p.p, me ç'rast

⁵ Indeksi i metaleve është një indeks i përbërë që përfshin çmimet e bakrit, aluminit, mineraleve të hekurit, kallajit, nikelit, zinkut, plumbit dhe uranimit.

⁶ Gjithashtu në mars u njoftua zgjatja e linjave të repove të likuiditetit valutor të BQE-së për bankat qendrore jashtë zonës së euros, deri më 15 janar 2023 dhe për shkak të pasigurisë së vazhdueshme globale, në dhjetor 2022, vlefshmëria e tyre u zgjat deri më 15 janar 2024.

⁷ Në korrik, BQE vendosi të përdorë një instrument shtesë të quajtur instrumenti i mbrojtjes së transmetimit (TPI), me qëllim transmetimin efektiv të politikës monetare në të gjitha vendet e eurozonës, gjatë procesit të normalizimit të politikës monetare, i cili parashihet të aktivizohet në kushtet e padëshirueshme të lëvizjeve të tregut që do të kërcënonin transmetimin monetar.

norma e interesit për operacionet bazë të rifinancimit, për kreditë e disponueshme njëditore dhe për depozitat e disponueshme në dhjetor ishte 2,5%, 2,75%, përkatësisht 2,0%. përkatësisht. Në të njëjtën kohë, BQE do të vazhdojë me riinvestimin e të gjitha letrave me vlerë të maturuara në korniza të programit të blerjes së mjeteve (APP) deri në fund të shkurtit 2023, pas së cilës parashikohet reduktimi i portofolit në përputhje me dinamikën e përcaktuar.

III. Lëvizjet makroekonomike në vitin 2022

Tabela 1
Tregues themelor të ekonomisë maqedonase

Ndryshimet vjetore, në %	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sektori real										
Prodhimi i Brendshëm Bruto*	2,9	3,6	3,9	2,8	1,1	2,9	3,9	-4,7	3,9	2,1
Inflacioni	2,8	-0,3	-0,3	-0,2	1,4	1,5	0,8	1,2	3,2	14,2
Shkalla e papunësisë	29,0	28,0	26,1	23,7	22,4	20,7	17,3	16,4	15,7	14,4
Sektori i jashtëm										
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% të PBB-së)	-1,6	-0,4	-1,8	-2,6	-0,8	0,2	-3,0	-2,9	-3,1	-6,0
Bilanci tregtar (% të PBB-së)	-22,9	-21,7	-20,1	-18,8	-17,8	-16,2	-17,3	-16,6	-20,3	-26,8
Investimet e huaja të drejtpërdrejta (% të PBB-së)	2,8	2,3	2,2	3,3	1,8	5,6	3,2	1,4	3,3	5,2
Borxhi i jashtëm bruto (% të PBB-së)**	64,0	70,0	69,3	74,7	73,4	73,0	72,4	78,7	80,8	80,7
Rezervat valutore bruto (në milionë Euro)	1.993,0	2.436,5	2.261,8	2.613,4	2.336,3	2.867,1	3.262,6	3.359,9	3.643,3	3.862,9
Sektori monetar										
Paraja e gjerë (M4)	5,2	10,6	6,9	6,2	5,1	11,8	9,3	6,9	7,0	5,1
Totali i kredive	6,6	10,0	9,6	6,5***	5,4	7,3	7,6***	4,7	8,3	9,4
Totali i depozitave (me para depozite)	5,4	10,5	6,4	6,1	5,0	12,1	9,0	5,7	7,5	4,9
Sektori fiskal										
Bilanci buxhetor (% të PBB-së)	-3,8	-4,2	-3,5	-2,7	-2,7	-1,8	-2,0	-8,0	-5,4	-4,1
Borxhi publik (% të PBB-së)	40,3	45,8	46,6	48,8	47,7	48,4	49,2	59,7	61,0	55,2
Sektori bankar										
Shkalla e majftueshmërisë së kapitalit (%)	16,8	15,7	15,5	15,2	15,7	16,5	16,3	16,7	17,3	17,7
Kreditë me probleme të sektorit jofinanciar/kreditë bruto (%)	11,5	11,3	10,8	6,6	6,3	5,2	4,8	3,4	3,2	2,9
Aktivët likuide/totali i aktiveve (%)	31,2	29,8	28,2	28,9	27,1	26,7	26,9	23,3	23,0	21,3

Burimi: BPRMV, EShS, Minsitria e Financave

*Të dhëna të mëparshme për vitin 2021, të dhëna të vlerësuara për vitin 2022

**Pa detyrime të pushtetit monetar (pa marrëveshje repo)


***E korrigjuar për fshirjet

3.1. PBB-ja dhe inflacioni

Sipas të dhënave të vlerësuara të EShS-së, në vitin 2022, PBB-ja shënoi rritje reale prej 2,1%⁸, që paraqet ngadalësim, në krahasim me rritjen prej 3,9% të vitit 2021. Gjatë vitit 2022 në pah dolën efektet negative të ndërhyrjes ushtarake të Rusisë në Ukrainë, e cila imponoi sfida të reja globale për krizën energjetike dhe norma të larta të inflacionit, të cilat çuan në ngadalësimin e rritjes ekonomike. Këto efekte shkaktuan rënie të prodhimit industrial vendas, në radhë të parë në segmentet më fuqishme energjetike (industria e metaleve), dhe përveç kësaj, thellim të rënies në ndërtimtari. Për rrjedhojë, rritja e aktivitetit ekonomik në anën e prodhimit u nxit nga rimëkëmbja e shërbimeve (kryesisht tregtia, transporti, turizmi dhe hoteleria). Vështruar nga komponentët individualë, nga aspekti i kërkesës vendore, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2022 vjen më së shumti nga kontributi pozitiv i investimeve bruto, kryesisht nën ndikimin e inventarëve. Në vitin 2022, kontributi i konsumit personal në rritje u ul ndjeshëm, ndërkaq kontributi i konsumit publik ishte negativ. Komponenti i eksportit neto kishte kontribut të lartë negativ, në kushtet e rritjes më të lartë të importeve në raport me rritjen e eksporteve, e që lidhet me rritjen e inventarëve.


Grafiku 17

PBB-ja dhe kërkesa efektive e jashtme (shkallët vjetore të ndryshimit real, në %)



Grafiku 18

PBB-ja (ritja reale, në %) dhe komponentët dalës të PBB-së (kontribute në rritjen придонеси кон растот, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat, llogaritjet e BPRMV-së. Të dhënat e PBB-së për vitin 2021 janë të mëparshme, ndërsa për vitin 2022 janë vlerësuar.


Vështruar më hollësisht, nga krahu i prodhimtarisë, rritja e ekonomisë gjatë vitit 2022 është më e theksuar në **grupin e veprimtarive të "tregtisë, transportit dhe hotelarisë"**, prandaj vazhdon të rimëkëmbet, si më e prekura nga kriza e shkaktuar prej pandemisë. Njëkohësisht, rritja e **tregtisë** vjen si pasojë e rritjes së lartë në të tri llojet e tregtisë (tregtia me pakicë, tregtia me shumicë dhe tregtia e automjeteve). Gjithashtu, sipas të dhënave më të hollësishme për udhëtarët dhe mallrat e transportuara, rritje të veprimtarisë shënon edhe **transporti**. Rritje e lartë e veprimtarisë vihet re edhe në industrinë e **hotelarisë**, si një nga sektorët më të prekur nga pandemia, me rritje të lartë të numrit të turistëve dhe të bujtjeve, si dhe të totalit të qarkullimit. Kur bëhet fjalë për **industrinë**, analizuar përmes indeksit të prodhimit industrial, rënia është kryesisht për shkak të kontributit negativ të industrisë përpunuese, si pasojë e realizimeve të pafavorshme të disa prej aktiviteteve tradicionale, siç janë: prodhimi i metaleve, prodhimi i produkteve ushqimore dhe prodhimi i produkteve të duhanit. Nga ana tjetër, kontribut pozitiv kishin aktivitetet përpunuese ku janë aktive kapacitetet më të mëdha të jashtme eksportuese nga industria automobilistike, si dhe

⁸ PBB-ja reale gjatë vitit 2022 ndoqi këtë dinamikë: tremujori i parë, 2,2%; tremujori i dytë, 4%; tremujori i tretë, 2% dhe tremujori i katërt, 0,6%.

prodhimi i produkteve farmaceutike bazë dhe i preparateve farmaceutike. Gjithashtu, sektori energjetik kishte kontribut pozitiv si rezultat i rritjes së prodhimit vendor të energjisë elektrike në kushtet e krizës energjetike, që shkaktoi edhe gërmimin më të madh të thëngjillit dhe të linjtit. Vlera e shtuar në **sektorin e ndërtimitarisë** shënoi rënie edhe në vitin 2022, e cila, vështuar nga të dhënat me frekuencë të lartë, është rezultat i rënies, si në inxhinierinë civile ashtu edhe në ndërtimet e larta.

Grafiku 19


Kontributi në ndryshimet vjetore reale të PBB-së (në pikë përqindjeje)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Komisioni European, llogaritjet e BPRMV-së. Të dhënat e PBB-së për vitin 2021 janë të mëparshme, ndërsa për vitin 2022 janë vlerësuar.

Grafiku 20

PBB-ja, instrua dhe shfrytëzimi i kapaciteteve



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Komisioni European.


Nga këndvështrimi i kërkesës agregate, në vitin 2022 rritja e veprimtarisë ekonomike është tërësisht si pasojë e kërkesës vendore, ndërkohë që eksportet neto kishin kontribut negativ. Në kornizat e kërkesës vendore, kontributin më të madh pozitiv e dhanë **investimet**, që pjesërisht është rezultat i rritjes së inventarëve të shkaktuar nga rritja e importit të produkteve të ndërmjetme, lëndëve të para dhe energjisë. Grumbullimi i rezervave është një dukuri e zakonshme gjatë kohërave të pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë së disponueshmërisë dhe çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, të këtillë siç e shkaktuan pandemia dhe konflikti ushtarak. Kontribut pozitiv shtesë në rritje ka edhe **konsumi i amvisërive**, por dukshëm më i dobët në krahasim me një vit më parë, por në kushtet e rënies reale të rrogave, rritjes së ngadaltë të kredive konsumatore dhe rritjes së pasigurisë. Nga ana tjetër, **shpenzimet publike** kishin një kontribut të vogël negativ. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, eksportet shënuan rritje relativisht të lartë, të nxitura nga rritja e veprimtarisë eksportuese të një pjese të kapaciteteve prodhuese në pronësi të huaj. Rritja e eksporteve dhe e kërkesës vendore, në radhë të parë e inventarëve, kontribuoi në rritjen e lartë të importeve të mallrave dhe të shërbimeve, me ç'rast komponenti i eksportit neto shënoi kontribut negativ në PBB-në e përgjithshme.

Pas një periudhe të gjatë të inflacionit të ulët, në vitin 2022 inflacioni u përshpejtua, me ç'rast shkalla mesatare e inflacionit arriti në 14,2%. Faktori kryesor për lëvizjet më të theksuara në rritje të çmimeve vendase është rritja historikisht e lartë e çmimeve të importit të ushqimeve dhe energjisë.


Këto ndryshime ndërlidhen kryesisht me ndërprerjen paspandemike të zinxhirëve të furnizimit global, si dhe me efektet e luftës në Ukrainë. Nisur nga këto zhvillime, zhvendosja e inflacionit pasqyron kryesisht çmimet më të larta të ushqimeve dhe energjisë, si efekt të drejtpërdrejtë të trysnive të importeve, të cilat kontribuojnë me tre të katërtat e rritjes së çmimeve të konsumit vendas në vitin 2022. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e këtyre

lëvizjeve të çmimeve globale dhe pasigurinë që i rrethon, këto trysni janë transmetuar në çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të tjera në indeksin e çmimeve.

Grafiku 21
Inflacioni vendor dhe inflacioni efektiv i jashtëm
(shkallët e rritjes, në %)



Grafiku 12
Komponenti afatgjatë i ndryshueshëm inflacionit
(ushqimi dhe energjia)
(kontributet vjetore, në pikë përqindjeje)



Burimi: ESHS, Eurostat dhe llogaritë e BPRMV-sl.

Çmimet e ushqimeve kanë kontributin më të madh në inflacion e vitit 2022, i cili shënoi një rritje prej 21,5%, duke shpjeguar 56,4% të rritjes totale të çmimeve të konsumit, nisur nga pjesëmarrja e lartë e komponentit ushqimor në shportën e konsumit.

Në kushtet e varësisë relativisht të lartë nga importi, rritja e çmimeve të ushqimeve rezulton kryesisht nga faktorë të jashtëm, si rritja e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregjet ndërkombëtare dhe efekti transferues i çmimeve më të larta të energjisë elektrike dhe të derivateve të naftës në shpenzimet e punës së ndërmarrjeve veprimtarinë ushqimore.

Të njëjtin ndikim kishin edhe rritja e çmimeve të plehrave artificiale, ushqimit për kafshët dhe përbërësve të tjerë mbështetës në prodhimin primar, ndërkaq deri diku edhe mbivlerësimi i dollarit amerikan. Nga pikëpamja strukturore, rritja e çmimeve është në një bazë të gjerë, me kontribut më të madh nga rritja e çmimeve të bukës, drithërave, mishit, qumështit, djathit dhe vezëve. Për të zbutur trysnitë e çmimeve të produkteve ushqimore bazë, gjatë vitit u marën disa masa (ngrirje e çmimeve në shitje me pakicë dhe shumicë⁹, uljen e normës preferenciale të TVSH-së nga 5% në 0% dhe kufizimin e marzhave tregtare¹⁰,

⁹ Më 4 dhjetor 2021, Qeveria e RMV-së mori vendim për ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë (bukë, sheqer, miell, vaj luledielli ushqimor, qumësht, djathë, gjizë, mish të freskët dhe produkte të mishit të thatë, si dhe oriz, vezë dhe makarona, në përputhje me listën e zgjeruar më 14 dhjetor) në nivelin e 1 dhjetorit, me vlefshmëri deri më 28 shkurt 2022 (në përputhje me vendimin oplotësues të Qeverisë së datës 28 janar 2022).

¹⁰ Më 9 mars 2022, Qeveria e RMV-së miratoi një paketë masash për t'u përballur me rritjen e çmimeve të ushqimeve. Kështu, norma preferenciale e TVSH-së për produktet ushqimore bazë u ul nga 5% në 0%, dhe marzha tregtar u kufizua në nivelin 4%, në tregtinë me shumicë dhe në nivelin 3%, në tregtinë me pakicë. Këto masa ishin të vlefshme deri më 31 maj 2022 dhe kishin të bënin me produktet e mëposhtme: bukë, miell (tipi 400), qumësht me përmbajtje yndyre 2,8%, 3,2% dhe 3,5%, sheqer i bardhë, vaj luledielli, oriz i bardhë, vezë, mish dhe produkte të tjera të thertoreve për ngrënie. Më 14 qershor, Qeveria mori vendim për vazhdimin e masës për kufizimin e marzhës tregtar, e cili u vendos deri në 5% në tregtinë me shumicë dhe pakicë, për bukën e bardhë, sheqerin e bardhë dhe vajin e lulediellit ushqimor (me përjashtim të presimit të ftohtë), pra deri në 10% për miell gruri (tipi 400 dhe 500), makarona dhe shpageta nga gruri i fortë, orizi i bardhë maqedonas, qumështi i përhershëm i lopës me përmbajtje yndyre 2,8%, 3,2% dhe 3,5% dhe vezët e pulës. Kjo masë fillimisht ishte e vlefshme deri më 30 shtator, ndërsa më pas u vendos që të vazhdojë zbatimi deri në fund të vitit. Gjithashtu, më 6 tetor është marrë vendim për kufizimin e marzhës tregtar deri në 10% për produktet e qumështit, si: gjizë, djathë i bardhë lope dhe i përzier, djathë, qumësht i thatë, ajkë dhe kos, i vlefshëm deri në fund të vitit.

kufizimi i eksporteve dhe heqja e detyrimeve doganore për disa produkte ushqimore bazë¹¹, si dhe masat për energjinë elektrike për prodhuesit vendas të produkteve ushqimore¹²). Nga pikëpamja dinamike, rritja e çmimeve të ushqimeve me bazë vjetore filloi të ngadalësohet në muajt e fundit të vitit, në kushtet e një prirjeje në rënie të çmimeve të produkteve ushqimore bazë në bursat botërore.

Çmimet e **energjisë** shënuan rritje prej 20,2%, duke zënë 18,7% të inflacionit total. Rritja e çmimeve të komponentit të energjisë është kryesisht si pasojë e rritjeve rregullatore të çmimit vendor të energjisë elektrike për amvisëritë. Çmimi i energjisë elektrike për amvisëri u rrit në muajt janar dhe korrik, me zbatimin në korrik të çmimit të shkallëzuar për konsum në tarifën e lartë¹³. Rritje e lartë është shënuar edhe në çmimet e derivateve të naftës, si pasojë e rritjes së çmimeve të këtyre burimeve energjitike në tregun ndërkombëtar, efekt i cili u zbutu vetëm pjesërisht nga masat e marra¹⁴. Trysni shtesë në komponentin energjetik të inflacionit shkaktuan edhe rritja e çmimeve të lëndëve djegëse të ngurta, për të cilat u miratua një masë për kufizimin e eksportit të druve të zjarrit dhe peletit, e plotësuar me një kufi në marzhën tregtare¹⁵, dhe në një masë më të vogël, rritja e çmimeve të ngrohjes qendrore¹⁶. E vështuar në mënyrë dinamike, në kushtet e një prirjeje në rënie të çmimit të naftës në bursat botërore në gjysmën e dytë të vitit, rritja e çmimeve në komponentin e energjisë u ngadalësua në tremujorin e fundit.

Rritja e përsheptuar e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë, të cilat janë një komponent mbështetës për shumë produkte dhe shërbime të tjera, krijoi trysni edhe në **inflacionin bazë**, i cili regjistroi një rritje prej 7,1% dhe kontribuon në një të katërtën e rritjes totale të çmimeve të konsumit. Rritja e këtij komponenti është më së shumti për shkak të çmimeve më të larta të shërbimeve në restorante dhe hotele, e cila lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve të ushqimit dhe energjisë, ndërkaq në një masë ndoshta edhe me ruajtjen e kërkesës, në kushtet e rritjes së mëtejshme të të ardhurave të disponueshme. Çmimet e pijeve joalkoolike, trafikut rrugor dhe ajror për shkak të rritjes së udhëtimeve, çmimet e produkteve të higjienës personale dhe mirëmbajtjes rutinë të amvisërive, si dhe

¹¹ Në kuadër të paketës së masave të datës 9 mars 2022, Qeveria mori vendim për kufizimin e eksportit të vajit të lulediellit, i vlefshëm deri më 31 maj. Më 20 korrik u mor vendimi për kufizimin e eksportit të grurit dhe thekrës dhe të miellit të grurit dhe thekrës dhe më 11 gusht u mor vendimi për kufizimin e eksportit të farave të lulediellit, masa që supozohej të ishin të vlefshme deri në fund të vitit, por më 6 tetor u vendos ndërprerja e vlefshmërisë së tyre. Më 9 mars 2022, Qeveria mori vendim edhe për importin pa doganë të vajit të lulediellit ushqimor, i cili do të ishte i vlefshëm deri më 31 maj, por më 20 korrik u vendos që zbatimi i kësaj mase të vazhdojë deri në fund të vitit, ndërsa më 30 gusht u mor vendim për anulimin e tarifave doganore për qumështin dhe ajkën, të vlefshme deri në fund të vitit.

¹² Më 30 tetor 2022 është marrë vendimi sipas të cilit, kompanitë që prodhojnë produkte ushqimore bazë si vaj për gatim, bukë dhe produkte furre, miell, qumësht dhe produkte qumështi dhe mish, do t'u lejohet të furnizohen me energji elektrike me një çmim të subvencionuar prej 80 euro për megavat/orë, për periudhën kohore sa zgjat situata e krizës në furnizimin me energji elektrike, duke filluar nga dhjetori 2022. Gjithashtu, më 9 shtator 2022, Qeveria miratoi një vendim sipas të cilit marzha më e lartë e tregtimit të energjisë elektrike për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë, që kryejnë tregti në tregun me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, caktohet maksimalisht 10%, masë kjo e cila u planifikua të zgjasë deri më 15 prill 2023.

¹³ Во согласност со одлуките на Регулаторната комисија за енергетика (РКЕ), цената на електричната енергија за универзалниот снабдувач е зголемена за 9,48% во јануари и во просек за 9,9% во јули 2022 година (ниската тарифа за 8,8%, а високата тарифа во просек за 10,4%). Притоа, од 1 јули, РКЕ за првпат вовеле скалесто тарифирање за потрошувачката во високата тарифа, односно вовеле модел со 4 блок-тарифи. Во однос на дотогашната единствена висока тарифа, цената на електрична енергија за блокот 1 е повисока за 5,5%, блокот 2 за 10,3%, блокот 3 за 18,3% и блокот 4 за 138,7%.

¹⁴ Në pjesën e karburanteve, në kuadër të pakos së masave të 9 marsit 2022, u miratuan këto masa: ulja e normës së TVSH-së nga 18% në 10% në shitjen e benzinës pa plumb, gazit, gazit të lëngshëm të naftës dhe metanit, si dhe ulja e akcizës.

¹⁵ Qeveria e RMV-së, më 20 korrik 2022, mori vendim për të kufizuar eksportin e druve të zjarrit dhe peletit deri në fund të vitit. Gjithashtu, më 11 gusht, Qeveria mori vendim për përcaktimin e marzhës më të lartë tregtare në tregtinë me pakicë për dru zjarri dhe pelet, në lartësinë prej më së shumti 10%, e vlefshme deri në fund të vitit.

¹⁶ Çmimi final i energjisë termike të dërguar është rritur mesatarisht për 14,05% në janar, te tri kompanitë në territorin e qytetit të Shkupit, ndërsa në gusht, për 14,18%, për konsumatorët e furnizuar nga BEG.


çmimet e duhanit, ku në një masë të madhe ka edhe efekte të rregullimeve të njehershme të çmimeve, kanë një kontribut më të theksuar¹⁷.

3.2. Tregu i punës

Në përputhje me zhvillimet në mjedisin e jashtëm dhe me ndryshimet në ekonominë vendase, pjesa më e madhe e treguesve të tregut të punës¹⁸ gjatë vitit 2022, tregojnë prirje kryesisht më pak të favorshme, si në aspekt të kërkesës, ashtu edhe në atë të ofertës së punës. Rritja më e ngadaltë ekonomike, në kushtet e pasigurisë së lartë nga zhvillimi i luftës në Ukrainë dhe përkeqësimi i tregut të energjisë, u pasqyrua edhe në kërkesën e tregut të punës. Kështu, numri i të punësuarve në vitin 2022 u ul me 0,2%. Analizuar sipas sektorëve, rënia e të punësuarve më së shumti shoqërohet me uljen e numrit të të punësuarve në sektorin e bujqësisë, kurse në një masë më të vogël edhe me uljen e numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimeve. Nga ana tjetër, numri i të punësuarve në industri është në rritje. Kështu, shkalla e punësimit ngeci duke qëndruar në nivelin prej 47,3%. Edhe gjatë vitit 2022 janë duke u zbatuar masa aktive punësimi¹⁹ për të mbështetur punësimin në ekonomi.


Grafiku 23

Tregues të përgjedhur të tregut të punës (në %)



Grafiku 24

Shkalla e papunësisë sipas grupmoshave (në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritë e BPRMV-së.

Nga ana e ofertës së fuqisë punëtore, gjatë vitit 2022 janë vërejtur edhe lëvizje të pafavorshme. Popullsia aktive e përgjithshme shënoi rënie prej 1,4%, që gjatë rritjes së popullsisë joaktive për 1,2%, çoi në zhvendosjen në rënie të shkallës së aktivitetit (për 0,6 p.p.), e cila u reduktua në 55,2%. Në kushtet e stabilizimit të shkallës së punësimit, kalimi i një pjese të të papunëve në popullatën joaktive ishte arsyeja kryesore për uljen e mëtejshme të shkallës së papunësisë, e cila në vitin 2022 u ul në nivelin më të ulët historik prej 14,4% (ulja vjetore prej 1,1 p.p.). Njëkohësisht, duke parë grupmoshat, ulja e shkallës totale të papunësisë vërehet në të gjitha

¹⁷ Që nga shkurti i vitit 2022, çmimet e shumicës së markave dhe llojeve të cigareve u rritën për 10 denarë, si rezultat i prirjes së rritjes së çmimeve të lëndëve të para, repromaterialeve dhe burimeve të energjisë, para së gjithash i gazit dhe energjisë elektrike, të cilat kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në prodhim, si dhe për shkak të rritjes së rregullt vjetore të akcizës (çdo vit, duke filluar nga viti 2013 deri më 1 korrik 2023, akciza për cigaret rritet për 0,2 denarë/copë).


¹⁸ Analiza e tregut të punës është bërë duke përdorur anketat tremujore të fuqisë punëtore, pra treguesit vjetorë për vitin 2022 janë nxjerrë si një mesatare e të dhënave tremujore të publikuara. Sipas njoftimeve të EShS-së të publikuara më 10.3.2023 dhe 4.4.2023, për popullatën aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rezultatet e Anketës së fuqisë punëtore për tremujorin IV të vitit 2022 dhe të dhënat e përpunuara për vitin 2021 dhe tremujorët pasues, gjatë përpunimit të të dhënave sipas tremujorëve për 2021 dhe 2022, shpërndarjet demografike rajonale sipas gjinisë dhe sipas grupmoshave pesëvjeçare u përdorën për të kalibruar popullsinë sipas të dhënave të Censusit 2021. Sipas EShS-së, të dhënat e përpunuara për vitin 2019 dhe 2020 do të publikohen gjatë vitit 2023.

¹⁹ Edhe gjatë vitit 2022, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale dhe Agjencia e Punësimit vazhduan të zbatojnë masa dhe programe aktive për rritjen e punësimit. Me Planin Operativ për programet dhe masat aktive të punësimit dhe të shërbimeve në tregun e punës në vitin 2022, u përfshinë rreth 13,000 persona të papunë, përmes 9 llojeve të ndryshme programesh, të cilat përbëjnë edhe masa të veçanta (më shumë informacion në <https://av.gov.mk/operativen-plan.nspx> dhe <https://vlada.mk/node/27001>).

grupmoshat, ndërkaq rënia është më e theksuar në grupmoshat nga 15 në 24 vjeç (nga 36,1% në 32,5%), ku megjithatë, shkalla vazhdon të jetë më e larta midis grupmoshave.


Rritja nominale e rrogave mesatare të paguara vazhdoi edhe në vitin 2022. Rritja është pjesërisht si rezultat i rritjes së rrogës minimale prej 18,5%, në mars të vitit 2022²⁰, si dhe i rritjes së një pjese të rrogave në sektorin publik²¹, në shtator të vitit 2022. Një ndikim plotësues kishin edhe disa faktorë strukturorë, si mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara të tregut të punës. Për rrjedhojë, rrogat nominale neto dhe bruto²² shënuan rritje vjetore prej 11%²³, përkatësisht 11,1% (5,7% më 2021). Rritja vjetore e rrogave neto është vërejtur në të gjithë sektorët e veprimtarive, ndërsa rritja më e lartë është shënuar në veprimtaritë që fillimisht ishin më të prekura nga pandemia. Kështu, rritja më e lartë u vu re në rrogat e veprimtarive të "objekteve të akomodimit" (18,4%), "artit, argëtimit dhe pushimit" (16,4%), "industrisë së përpunimit" (14,6%), "tregtisë" (14,2%).). Në kushtet e rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit, rroga reale neto dhe bruto janë ulur për 2,7%, përkatësisht 2,6%.

Grafiku 25
Rrogat mesatare bruto dhe neto
(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ilogaritjet e BPRMV-së.

Grafiku 26
Просечни нето-плати по сектори
(ndryshimet vjetore, në %)



²⁰ Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e rrogës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 41/22), nga marsi i vitit 2022, u bë rritja e jashtëzakonshme e rrogës minimale neto për 2.806 denarë, në përputhje me marrëveshjen tripalëshe të arritur në mes të qeverisë, sindikatave dhe punëdhënësve, ku shteti do të subvencionojë pjesën që lidhet me kontributet (nga marsi 2022 deri në dhjetor 2022, në vlerë prej 1.197 denarë për çdo muaj). Lartësia e rrogës minimale në shumën bruto, duke filluar nga marsi 2022, deri në shkurt 2023, është 26.422 denarë (më parë 22.146 denarë), përkatësisht rroga minimale në shumën neto është 18.000 denarë (më parë 15.194 denarë). Gjithashtu, me ndryshimet dhe plotësimet e fundit, u përcaktua një metodologji e re me të cilën do të rregullohet rroga minimale në periudhën e ardhshme (nga marsi 2023), përkatësisht me rritjen për vitin paraprak të rrogës mesatare të paguar në RMV dhe indeksit të shpenzimeve të jetesës – 50% e rritjes nga secili tregues. Po ashtu është përcaktuar që shuma e rrogës minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e shumës së rrogës mesatare neto të paguar në RMV për vitin e mëparshëm.


²¹ Në përputhje me ribalancimin e Buxhetit, rroga e shtatorit ka një rritje prej 15% për punonjësit në drejtësi, arsimin e mesëm dhe fillor dhe kujdesin ndaj fëmijëve, 7% rritje të rrogave për punonjësit në arsimin e lartë dhe 5% rritje të rrogave për punonjësit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në shëndetësi.

²² Totali i rrogave të paguara bruto përfshin: rrogat neto të paguara për muajin raportues, tatimin personal të paguar dhe kontributet e paguara (për sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësor, për punësim, për sëmundje profesionale). Të dhënat u referohen rrogave të paguara.


²³ Normat sipas të cilave paguhen kontributet në vitin 2022 janë 18,8% për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe 7,5% për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, njësoj si një vit më parë.

Nga aspekti i treguesve të konkurrencës²⁴, gjatë vitit 2022 produktiviteti i punës²⁵ vazhdon të rritet, por më mesatarisht, në krahasim me një vit më parë, duke shënuar një rritje prej 2,6% (rritje prej 4,4% në 2021). Rritja e produktivitetit në vitin 2022 është rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, në kushtet e një pakësimi minimal të numrit të të punësuarve. Vështruar sipas sektorëve, kontributi më i madh pozitiv vjen nga sektori i shërbimeve dhe një pjesë e vogël e bujqësisë, ndërsa industria ka një kontribut minimal negativ. Për shkak të rritjes më të lartë të pagave sesa rritjes së produktivitetit, shpenzimet nominale të punës për njësi janë 8,5% më të larta në vitin 2022 (nga 1,2% në 2021). Në të njëjtën kohë, pjesa më e madhe e rritjes së shpenzimeve të punës për njësi produkt shpjegohet me shpenzimet më të larta në sektorin e shërbimeve dhe në një masë më të vogël në industri, ndërsa një rënie e lehtë e shpenzimeve të punës është vërejtur në bujqësi.

Grafiku 27
Produktiviteti i punës
(kontribute në rritjen vjetore, në p.p.)



Grafiku 28
Shpenzime pune sipas njësive të prodhimit
(kontribute në rritjen vjetore, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ilogaritjet e BPRMV-së.

3.3. Financat publike

Edhe gjatë vitit 2022, shënohet një konsolidim fiskal paspandemik. Deficiti buxhetor në vitin 2022 u ngushtua mesatarisht për 4,5% të PBB-së, nga 5,4% të PBB-së së një viti më parë. Ulja e deficitit është rezultat i rimëkëmbjes së mëtejshme paspandemike të të ardhurave buxhetore dhe mbi të gjitha të rritjes së të ardhurave nga taksat. Bilanci primar buxhetor gjithashtu po tkurret²⁶, që në vitin 2022 ishte 3,3% e PBB-së, kundrejt 4,1% të PBB-së në vitin 2021.

Në performancën e sektorit fiskal gjatë vitit 2022 ndikoi pjesërisht kriza energjetike, e cila u përkeqësua nga zhvillimet ushtarake në Ukrainë në tremujorin e parë të vitit 2022. Ky lloj mjedisi ekonomik dhe ndryshueshmëria e madhe imponuan nevojën për rritjen e


²⁴ Produktiviteti dhe harxhimet e punës për njësi produkti për të gjithë ekonominë llogariten në bazë të të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës për: PBB, numrin e të punësuarve dhe rrogat nominale mesatare bruto. Produktiviteti total llogaritet si një shumë e ponderuar e produktivitetit të llogaritur në nivel sektori individual. Brenda secilit sektor, produktiviteti llogaritet si raport ndërmjet vlerës së shtuar në atë sektor dhe numrit të të punësuarve.

²⁵ Të dhënat e produktivitetit janë llogaritje të brendshme të Bankës Popullore dhe duhet të interpretohen me kujdes. Në përputhje me Censurin e Popullsisë, Familjeve dhe Apartamenteve 2021, ndodhi edhe ndërprerje strukturore në serinë për numrin e të punësuarve në tremujorin e parë të vitit 2021. Për të vazhduar me një analizë të qëndrueshme të produktivitetit, BPRMV-ja bën disa rregullime në të dhënat për numrin e të punësuarve.

²⁶ Bilanci primar buxhetor është dallimi ndërmjet të hyrave totale buxhetore dhe të dalave totale buxhetore, e zvogëluar nga shlyerja e detyrimeve aktuale në bazë të huave të marra (interesi). Ky tregues fiskal konsiderohet më i përshtatshëm në analizën e rrjedhës aktuale të politikës, për faktin se nuk integron shpenzimet fiskale që lidhen me sjelljen e mëparshme të politikës fiskale në raport me borxhin publik.


mbështetjes nga shteti për një pjesë të kompanive, si dhe ndihmën financiare për kategoritë e cenueshme të qytetarëve. Në këto rrethana, kah mesi i vitit u bë ribalancimi i buxhetit, me korrigjim rritës të deficitit të planifikuar për vitin 2022, nga shuma e planifikuar fillimisht prej 33.529 milionë denarë (4,2% e PBB-së) në 42.736 milionë denarë (5,4% e PBB), gjatë rritjes më të theksuar të shpenzimeve në raport me të ardhurat²⁷.

Grafiku 29
Treues fiskalë (% të PBB-së)



Burimi: Minsitria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Grafiku 30
Të hyra të përgjithshme buxhetore dhe komponentët kryesorë të tyre (% të PBB-së)



Burimi: Minsitria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Të hyrat totale buxhetore në vitin 2022 janë më të larta për 11,5%, në bazë vjetore (pas rritjes prej 15% në vitin e mëparshëm). Rritja e të hyrave totale rezulton nga rritja e pothuajse të gjitha kategorive, me përjashtim të të hyrave të tjera²⁸ që shënuan rënie. Gjatë vitit 2022, shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 8,4% në bazë vjetore (rritje prej 5,5% në vitin e mëparshëm). Rritja e shpenzimeve vjen si pasojë e rritjes së shpenzimeve aktuale për 7% në bazë vjetore (nga 2,7% në vitin e mëparshëm), gjatë uljes së shpenzimeve. Rritja vjetore e shpenzimeve aktuale është më së shumti si pasojë e rritjes së kategorisë së

²⁷ Më 19 korrik 2022 u miratua ribalancimi i buxhetit për vitin 2022 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 164, datë 20.7.2022), ndërsa vendimet për rishpërndarjen e fondeve ndërmjet përdoruesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve u morën në muajt nëntor dhe dhjetor ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 232, datë 2.11.2022 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 272, datë 16.12.2022).

²⁸ Të hyrat e tjera përfshijnë të hyrat nga kapitali, donacionet e huaja dhe të hyrat nga huat e shlyera.

“transfereve”²⁹ dhe kryesisht rrjedh nga mbështetja financiare e sektorit të energjisë dhe shpenzimet më të larta për pensione³⁰. Deficiti buxhetor i realizuar në vitin 2022 është financuar kryesisht nga huamarrja e jashtme neto³¹ e shtetit, si dhe huamarrja neto në tregun vendas dhe nga depozitat e shtetit në Bankën Popullore.

Grafiku 31
Struktura e financimit të bilancit buxhetor *
(në milionë denarë)



* Ndryshimi negativ i depozitave në strukturën e financimit të bilancit buxhetor paraqet rritjen e depozitave shtetërore.
Burimi: Minsitria e Financave dhe Ilogaritjet e BPRMV-së.

Në aspektin e financimit përmes tregut vendor primar të letrave me vlerë, gjendja e letrave me vlerë të emetuara u rrit për 7.013 milionë denarë dhe në fund të vitit ishte 153.322 milionë denarë. Emetimet e reja të letrave me vlerë, të shtetit, kryesisht kishin një maturim më të gjatë se maturimi i letrave me vlerë që ishin në maturim (kryesisht me afat maturimi 15 vjet), që kontribuoi në rritjen e maturimit mesatar të letrave me vlerë të emetuara, të shtetit, e me këtë edhe në thellimin e këtij segmenti të tregut financiar, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së obligacioneve shtetërore në strukturën e letrave me vlerë, të shtetit. Zhvendosje veçanërisht të favorshme u vërejtën edhe në strukturën valutore, e cila vihet re nëpërmjet rritjes së letrave me vlerë të emetuara, të shtetit, në valutë vendase.

²⁹ Kategoria e "transfereve" u referohet shpenzimeve të pensioneve, shpenzimeve të mbrojtjes sociale, shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe transfereve të tjera (kryesisht subvencione).

³⁰ Shpenzimet e pensioneve janë rritur për shkak të rritjes prej 2,9% në janar dhe 6,8% në shtator 2022, në bazë të harmonizimeve të rregullta të pensioneve (me rritjen e shpenzimeve së jetesës). Po ashtu, në periudhën prill-qershor, secilit pensionist i është paguar ndihmë prej 1.000 denarësh në muaj, në përputhje me pakon e masave ekonomike të 9 marsit 2022.

³¹ Huamarrja e shtetit në tregun e huaj, më masë më të madhe, del nga obligacioni për tregun financiar gjerman të emetuar në fund të shtatorit 2022, në vlerë prej 250 milionë euro dhe nga tërheqja e kështit të parë të Instrumentit të Kujdesit dhe të Likuiditet (PLL.) miratuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, në nëntor 2022, në vlerë prej 110 milionë euro (nga 530 milionë euro gjithsej të miratuar nga marrëveshja).


Grafiku 32

Struktura valutore e letrave me vlerë, të shtetit
(në milionë denarë)



Grafiku 33

Struktura e maturimit të letrave me vlerë, të shtetit
(në milionë denarë)



Burimi: Minsitria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Për sa i përket huamarrjes totale të shtetit, borxhi i qeverisë qendrore ishte 50,9% e PBB-së në vitin 2022, nga 51,9% e PBB-së në vitin 2021. Një rënie e lehtë u vu re si në borxhin e jashtëm, ashtu edhe në atë vendas të qeverisë qendrore, të cilat arritën në 30,9%, përkatësisht 20%, të PBB-së (31,2%, përkatësisht 20,6% të PBB-së së një viti më parë). Lëvizjet në totalin e borxhit publik janë të ngjashme³², i cili në fund të vitit 2022 u reduktua në 59,7% të PBB-së (61% e PBB-së së një viti më parë), me një borxh publik të jashtëm dhe vendas më të ulët (39,2%, përkatësisht 20,5% të PBB-së). Në kuadër të borxhit publik, borxhi i përgjithshëm shtetëror (borxhi i qeverisë qendrore, fondeve publike dhe i komunave) në vitin 2022 është 51% e PBB-së dhe është më i ulët për 1 p.p., në krahasim me një vit më parë, ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të pagarantuara)³³ është 8,7% e PBB-së, që është një rënie vjetore prej 0,3 p.p. Sa i përket strukturës së borxhit, nuk vërehen ndryshime të dukshme, kështu që në fund të vitit 2022, pjesëmarrja e borxhit të shtetit në totalin e borxhit publik është 85,4%, ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të pagarantuara) merr pjesë me 14,6 %.

³² Borxhi publik përcaktohet me Ligjin e Borxhit Publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019), sipas të cilit, përfaqëson një shumë të borxhit shtetëror dhe të borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose të shumicës së shtetit ose komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

³³ Në përputhje me ndryshimet në Ligjin e Borxhit Publik, nga maji i vitit 2019, borxhi i pagarantuar i ndërmarrjeve publike dhe i shoqërive aksionare të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit llogaritet në borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019).

Grafiku 34

Borxhi i qeverisë qendrore dhe borxhi i përgjithshëm publik (% e PBB-së)




Burimi: Minsitria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

3.4. Bilanci i pagesave, PNI dhe borxhi i jashtëm

Gjatë vitit 2022, kur filloi pushtimi rus i Ukrainës, por ndërkohë kishte ende probleme në zinxhirët e furnizimit global, si dhe përkeqësim të tregjeve të produkteve primare, veçanërisht të energjisë, deficitin në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave shënoi zgjerim vjetor prej 2,9 p.p. dhe ishte 6% të PBB-së. Vëhtruar sipas komponentëve, thellimi i deficitit në llogarinë rrjedhëse i detyrohet tërësisht rritjes së deficitit tregtar (për 6,5 p.p të PBB-së), pra rritjes më të lartë të importeve sesa rritjes së eksporteve të mallrave, e cila vjen më së shumti nga efekti i rritjes së çmimeve të bursës të energjisë dhe ushqimeve në tregjet botërore në vitin 2022. Nga ana tjetër, komponentët e tjerë të llogarisë rrjedhëse kontribuan në përmirësimin e lëvizjeve negative në bilancin tregtar. Kontribut pozitiv më të theksuar ka rritja e suficitit në shërbime (me 1,5 p.p të PBB-së), e shprehur përmes arritjeve më të larta në shërbimet e biznesit dhe të telekomunikacionit, shërbimet kompjuterike dhe të informacionit. Përmirësimi i suficitit të të ardhurave sekondare, i cili kryesisht pasqyron rritjen e transfereve private (një rritje e ndjeshme e flukseve hyrëse nga neto efektiva e blerë në tregun valutor), ishte gjithashtu i dobishëm, pjesërisht si rezultat i heqjes së plotë të masave kufizuese që lidhen me udhëtimin, për dallim prej lëvizjes së kufizuar ndërkombëtare të pasagjerëve në vitin 2021. Reduktimi i deficitit të të ardhurave primare (për 0,1 p.p të PBB-së) vjen më së shumti nga dalja më e ulët e të ardhurave nga investimet.


Grafiku 35

Llogaria rrjedhëse financiare
(në milionë euro)



Grafiku 36

Komponentët themelorë të llogarisë rrjedhëse (% të PBB-së)




Burimi: BPRMV.

Në vitin 2022, në llogarinë financiare të bilancit të pagesave u realizuan flukse neto prej 990,7 milionë euro, ose 7,7% të PBB-së, të cilat kanë mundësuar financimin e plotë të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe njëkohësisht, rritjen e rezervave valutore. Realizimet e favorshme janë rezultat i flukseve hyrëse neto të realizuara pothuajse në të gjithë përbërësit e llogarisë financiare, me përjashtim të kategorisë "valuta dhe depozita". Flukset hyrëse në llogarinë financiare vijnë më së shumti nga flukset neto në investime të drejtpërdrejta, të cilat në vitin 2022 janë 670,2 milionë euro, ose 5,2% e PBB-së, që paraqet një rritje prej 1,9 p.p., në krahasim me një vit më parë. Për sa i përket strukturës së investimeve të drejtpërdrejta, mbizotërojnë flukset hyrëse neto të bazuara në borxhin e ndërkompanive, me hyrjen e konsiderueshme neto edhe të kapitali vetjak, në kushtet e daljeve të vogla neto në fitime të riinvestuara. Flukse hyrëse neto shtesë në llogarinë financiare janë realizuar në bazë të kredive tregtare dhe kredive afatshkurtra. Flukset hyrëse neto të realizuara në investimet e portofolit janë si rezultat i huamarrjes së shtetit jashtë vendit, në bazë të letrave me vlerë të emetuara të borxhit³⁴. Nga ana tjetër, në kategorinë e valutave dhe depozitave, janë regjistruar flukse të larta neto, të cilat u detyrohen tërësisht daljeve neto të realizuara në sektorët e tjerë.


Grafiku 37

Llogaria financiare (% të PBB-së)



Grafiku 38

Investimet e drejtpërdrejta (% të PBB-së)



Burimi: BPRMV.

Në vitin 2022, bilanci negativ në shkëmbimin tregtar të mallrave me jashtë shënoi një rritje vjetore prej 40,9% (ose për 6,4 p.p të PBB-së), me rritje më të fortë të importit sesa


³⁴ Më 29.9.2022 u emetua në tregun gjerman një obligacion ("Namensschuldverschreibungen" – NSV) në vlerë prej 250 milionë euro, me afat maturimi prej 3 vjet dhe me normë interesi EURIBOR 6-mujor + komision 3,75%.

rritja e komponentit të eksportit. Ky thellim i deficitit tregtar më së shumti (rreth 80%) shpjegohet me zgjerimin e deficitit energjetik, në kushtet e goditjeve globale të çmimeve midis burimeve të energjisë, si pasojë e zhvillimeve ushtarake në Ukrainë dhe e sanksioneve të vendosura ndaj Rusisë. Rritja e lartë e çmimeve të energjisë elektrike dhe e gazit natyror në vitin 2022, e plotësuar nga varësia e lartë energjetike e ekonomisë vendase nga importet, çoi në thellimin e ndjeshëm të deficitit tregtar me bazë vjetore. Rritja e lartë e çmimeve të bursës të ushqimeve, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit, dhe ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit global që ekzistojnë ende, shkaktuan trysni të mëtejshme mbi bilancin tregtar.

Pavarësisht mjedisit të jashtëm të pafavorshëm dhe të pasigurt, eksporti i mallrave në vitin 2022 vazhdon të rritet, me një shkallë vjetore prej 19,9%. Rreth gjysma e rritjes lidhet me rritjen e eksportit të kapaciteteve industriale në pronësi të huaj, kur vihet re rimëkëmbja paspandemike e industrisë së automobilave, shfrytëzimi në rritje të një pjese të kapaciteteve ekzistuese, por edhe të reja. Gjatë vitit 2022, disa nga aktivitetet tradicionale, si dhe eksporti i energjisë, kanë një kontribut solid në realizimet më të mira të sektorit të eksportit. Konkretisht, në vitin 2022 është vërejtur rritje e eksportit të energjisë elektrike, me rritjen e çmimeve, por edhe rritje sasiore të eksportit për shkak të tepcave të prodhimit që kanë të bëjnë me kushtet jashtëzakonisht të favorshme të motit në fund të vitit dhe uljen e konsumit.


Nga ana e importit, në bazë vjetore u shënua një rritje e fortë prej 25,8%, kryesisht si pasojë e realizimeve në komponentin energjetik, që shpreh cenueshmërinë e theksuar të ekonomisë vendase ndaj goditjeve energjetike. Në të njëjtën kohë, thuajse gjysma e kontributit të importeve të energjisë vjen nga kontributi i importit të derivateve të naftës, nën ndikimin e ndjeshëm të çmimeve të larta të importit, duke rritur njëkohësisht importet sasiore. Kontribut pozitiv shënon edhe importi i burimeve të tjera të energjisë, si importi i energjisë elektrike dhe importi i gazit, që paraqet efekt çmimi, në të njëjtën kohë me reduktimin e importeve sasiore në bazë vjetore. Një kontribut të rëndësishëm pozitiv shënoi importi i lëndëve të para të industrisë së automobilave, i analizuar nëpërmjet kontributit të importit të pajisjeve dhe makinerive, si dhe importi i metaleve me ngjyra. Një kontribut më të vogël në rritjen e importeve dha importi i hekurit dhe çelikut.

Grafiku 39
Kontribute në ndryshimin vjetor të eksportit
(në p.p)



Burimi: ESHS.

Grafiku 40
Kontribute në ndryshimin vjetor të importit (në p.p)




Për sa i përket treguesve të konkurrencës së çmimeve të ekonomisë vendase³⁵, në vitin 2022, kursi real efektiv valutor i deflatuar nga shpenzimet e jetesës realizoi një mbivlerësim

³⁵ Analiza e treguesve të konkurrencës së çmimeve është bazuar në indekset REDK, të llogaritura me ponderë të bazuara në tregtinë e jashtme, pa produkte primare. Produktet primare që nuk përfshihen në përlogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, hekuri dhe çeliku, xehet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja industriale në pronësi të huaj.

prej 4,4% në bazë vjetore, kundrejt indeksit të llogaritur me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale, të cilët realizuan një nënçmim prej 3,3%. Në të njëjtën kohë, kursi nominal efektiv valutor u mbivlerësua për 3,5%, në bazë vjetore, si rezultat i zhvlerësimit të mëtejshëm të lirës turke në raport me denarin. Shpenzimet relative të jetesës u rritën për 0,9%, ndërsa çmimet relative të prodhuesve industrialë u ulën për 6,5% (më shumë rritje të çmimit e jashtme sesa çmimet vendase gjatë vitit 2022).


Grafiku 41

NEDK dhe REDK, pa prodhimet primare, të llogaritur sipas indeksit të shpenzimeve të jetesës dhe të çmimeve të prodhuesve (2015=100)



Grafiku 42

Çmimet relative (2015=100)




Burimi: BPRMV.

Në fund të vitit 2022, pozicioni negativ neto ndërkombëtar investues (PNI) të ekonomisë vendase është 8.150,8 milionë euro, ose 63,2% të PBB-së. Në krahasim me situatën në fund të një viti më parë, ajo u përkeqësua për 1,2 p.p. të PBB-së, në kushtet e rritjes së detyrimeve ndërkombëtare dhe të reduktimit të mjeteve ndërkombëtare (përkatesisht për 0,6 p.p. të PBB-së). Analiza sektorale e PNI-së tregon se thellimi vjen më së shumti nga zvogëlimi i mjeteve neto të bankës qendrore në bazë vjetore, si pasojë e rritjes së detyrimeve të bazuara në kreditë afatshkurtra (që kanë të bëjnë me operacionet e rregullta të administrimit të rezervës valutore), si dhe më pak mjeteve në rezervat valutore. Në të njëjtën kohë, detyrime neto më të larta u realizuan edhe në sektorë të tjerë (me detyrime më të larta në bazë të investimeve të drejtpërdrejta), si dhe në institucionet depozituese. Nga ana tjetër, zhvendosje të favorshme u vërejtën në pozicionin neto të shtetit, ku detyrimet neto të bazuara në investimet e portofolit, përkatesisht në letrat me vlerë të borxhit, janë zvogëluar.

Grafiku 43


Pozicioni ndërkombëtar investues (% të PBB-së)



Burimi: BPRMV.

Grafiku 44


Pozicioni ndërkombëtar investues sipas sektorëve (% të PBB-së)



Borxhi i jashtëm bruto në fund të vitit 2022 është 10.411 milionë euro³⁶, ose 80,7% të PBB-së, që është thujse identike me nivelin e fundit të vitit 2021 (80,8% e PBB-së). Ky realizim është në kushtet e uljes së borxhit të sektorit publik për 3,0 p.p. të PBB-së, me një rritje të njëkohshme të borxhit privat për 3,0 p.p. të PBB-së. Borxhi më i ulët i sektorit publik është kryesisht rezultat i një reduktimi të borxhit të qeverisë qendrore me detyrime më të ulëta të bazuara në letrat me vlerë të borxhit. Nga ana tjetër, rritja vjetore e borxhit privat rezulton kryesisht nga rritja e borxhit të ndërkompanive të subjekteve të lidhura me kapitalin, por në një masë më të vogël, nga borxhi më i lartë i sektorit privat jobankar (si rezultat i kredive më të larta tregtare) dhe i bankave private (për shkak të rritjes së detyrimeve afatshkurtra në bazë të valutave dhe depozitave).

Grafiku 45

Borxhi i jashtëm bruto sipas huamarrësve dhe sektorëve institucionalë (% të PBB-së)



Burimi: BPRMV.

Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë vendase vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm bruto në PBB vazhdon të jetë në intervalin e borxhit të lartë, ndërsa të gjithë treguesit e tjerë tregojnë për borxh të ulët të ekonomisë vendase³⁷.

Më 31.12.2022, borxhi i jashtëm neto është 4.048,6 milionë euro, ose 31,4% të PBB-së, që në raport me fundin e një viti më parë, paraqet një rritje prej 0,9 p.p. të PBB-së. Borxhi

³⁶ Të dhënat e borxhit të jashtëm bruto dhe neto nuk përfshijnë detyrimet e bankës qendrore në bazë të marrëveshjeve repo.

³⁷ Niveli i borxhit të jashtëm bruto, pa përfshirë kreditë tregtare dhe borxhin e ndërkompanive, është 49,5% të PBB-së, që është një tregues i borxhit mesatar.

i jashtëm neto më i lartë vjen si pasojë e rritjes së borxhit neto privat (për 2,8 p.p. të PBB-së), ndërsaq të uljes së borxhi neto publik (për 1,9 p.p. të PBB-së).

Tabela 2 Tregues të huamarrjes së jashtme

Treguesit e borxhit të jashtëm	Aftësia e pagesës				Likuiditeti		
	Shlyerja e interesit/eksporti i mallrave dhe i shërbimeve dhe derdhje të tjera	Borxhi bruto/eksporti i mallrave dhe i shërbimeve dhe derdhje të tjera	Borxhi bruto/PBB	Shlyerja e interesit/eksporti i mallrave dhe i shërbimeve dhe derdhje të tjera	Rezervat valutore/borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/borxhi afatshkurtër me maturimin e mbetur*	Borxhi afatshkurtër/Borxhi i përgjithshëm
	në %	në %	në %	në %	raporti	raporti	në %
31.12.2004	2,4	129,3	47,3	12,4	1,1	0,9	30,3
31.12.2005	2,7	147,0	54,2	11,1	1,7	1,0	26,7
31.12.2006	3,4	131,3	49,8	21,7	2,0	1,3	29,0
31.12.2007	2,8	119,3	51,3	19,4	1,3	1,1	39,8
31.12.2008	2,7	116,9	54,1	10,2	1,3	0,9	35,2
31.12.2009	2,4	131,0	57,8	11,8	1,3	0,9	32,9
31.12.2010	3,2	140,4	59,7	13,9	1,5	1,0	27,9
31.12.2011	3,1	148,4	64,6	16,8	1,8	1,2	25,2
31.12.2012	2,9	142,1	67,6	13,1	1,6	1,0	26,7
31.12.2013	2,5	137,3	67,3	15,8	1,6	1,1	23,3
31.12.2014	3,0	148,9	74,0	17,2	1,8	1,1	22,3
31.12.2015	2,7	143,4	73,2	19,9	1,7	1,1	21,3
31.12.2016	2,4	148,8	79,3	14,8	1,7	1,2	21,9
31.12.2017	2,7	138,6	76,9	12,7	1,3	0,9	23,9
31.12.2018	2,2	130,7	77,3	15,7	1,4	1,0	25,8
31.12.2019	2,0	121,9	76,3	9,0	1,6	1,0	25,6
31.12.2020	1,9	122,3	77,9	13,6	1,9	1,1	20,4
31.12.2021	2,2	126,9	83,8	16,3	1,8	1,3	21,5
31.12.2022	1,8	124,3	88,1	9,2	1,5	1,0	25,0
Kriteri i borxhit mesatar	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1,00		

* Kriteri i borxhit mesatar merret sipas metodologjisë së Bankës Botërore, për përpunimin e treguesve të borxhit, që nënkupton shfrytëzimin e mesatare të lëvizshme trivjeçare të PBB-së dhe vlerës së mallrave dhe shërbimeve, si dhe derdhjeve të tjera, si emërues në logaritmen e treguesve.

Përpiluar në përputhje me "External debt statistics: Guide for compilers and users", botuar nga FMN-ja.

Sipas rregullës së Grenspan-Guidotti, shteti duhet të ruajë mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi i mbetur) me rezerva valutore.

Burimi: BPRMV

3.5. Agregatët monetarë dhe kreditorë³⁸

3.5.1. Agregatët monetarë

Edhe gjatë vitit 2022 vihet re një rimëkëmbje paspandemike e ekonomisë, por më mesatare. Në aktivitetin ekonomik vendas ndikoi goditja joekonomike e shkaktuar nga zhvillimet ushtarake në Ukrainë. Në rrethana të këtilla, pasiguria u rrit përsëri, ndërsaq në tregun botëror të energjisë çmimet vazhdojnë të rriten, duke çuar në krizë energjetike. Për rrjedhojë, në vitin 2022 u vërejt një rritje e ngadaltë në paranë e gjerë dhe totalin e depozitave në sektorin financiar³⁹. Në të njëjtën kohë, efektet e krizës u zbutën pjesërisht nga masat e shtetit për mbështetjen financiare të kompanive të sektorit energjetik dhe të kategorive të cenueshme të amvisërive të prekura nga kriza, të cilat në këtë vit, si në vitin e kaluar, kontribuan pjesërisht në rritjen e parasë së gjerë dhe të depozitave.

³⁸ Të dhënat e totalit të depozitave dhe të kredive, nga gushti i vitit 2020 e në vazhdim, nuk përfshijnë të dhënat e një banke të cilës, në gusht të vitit 2020 iu hoq licenca e themelimit dhe e funksionimit dhe u çel procedurë falimentimi. Për të vërejtur më realisht flukset e realizuara në sistemin bankar, pa efekt të një ndryshimi të këtyre në pasqyrimin e të dhënave në statistikën monetare, në realizimin e totalit të flukseve të depozitave dhe të kredive në vitin 2020, janë bërë rregullime në flukse me të dhënat për bankën përkatëse. Përshtatja e totalit të depozitave u bë duke përfshirë shumën e depozitave që nuk i nënshtrohet kompensimit përmes FOD në gjendjen aktuale të totalit të depozitave, ndërsa përshtatja e totalit të kredive u bë duke përfshirë të dhënat e korrikut për gjendjen e kredive të bankës në gjendjen aktuale të totalit të kredive.

³⁹ Të dhënat kanë të bëjnë me depozitat e sektorit joshkëmbësor në banka dhe kursimore, mjetet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë në Bankën Popullore dhe mjetet e njësisë të vetëqeverisjes lokale në llogaritë në Bankën Popullore. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore të qershorit të vitit 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në këtë link: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspj.

Grafiku 47


Para të gjera M4 dhe depozitat e përgjithshme



Burimi: BPRMV.

Grafiku 48

Paratë e gjera M4, pjesëmarrja në PBB



Në vitin 2022, rritja vjetore e shtrirjes së parasë së gjerë M4 u ngadalësua dhe ishte 5,1%. Nga pikëpamja strukturore, në kushtet e rritjes së pasigurisë për shkak të zhvillimeve ushtarake në Ukrainë dhe prirjes për të mbajtur fonde në formë polilikuide, komponentët më likuidë të M4 vazhdojnë të shënojnë rritje - paratë e gatshme në qarkullim dhe paratë depozituese, të cilat shënuan rritje vjetore prej 6,8%, përkatësisht 5,8%. Rritje mesatare shënuan edhe depozitat afatshkurtra, ndërsa rënie e lehtë u vërejt te depozitat afatgjata. Treguesi i pjesëmarrjes së ndryshimit vjetor të parasë së gjerë në PBB u ul dhe në fund të vitit ishte 3,3% (4,7% më 2021). Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në PBB në fund të vitit ishte 68,9%, kundrejt 72,3% të një viti më parë⁴⁰.

Tabela 3


Përbërësit e ofertës monetare - kushtet dhe ndryshimet

	Gjendja			Ndryshimi vjetor		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022
	në milionë denare			në %		
Para të gatshme në qarkullim	43.701	44.480	47.494	21,0	1,8	6,8
Para depozitash	160.765	177.716	188.036	15,2	10,5	5,8
M1	204.466	222.196	235.530	16,4	8,7	6,0
Depozita afatshkurtra në denarë, deri 1 vjet.	44.042	40.033	39.429	-10,2	-9,1	-1,5
Depozita afatshkurtra në valuta, deri 1 vjet.	134.950	160.778	175.061	12,3	19,1	8,9
M2	383.458	423.007	450.020	11,2	10,3	6,4
Depozita afatshkurtra në denarë, mbi 1 deri 2 vjet.	30.665	27.727	28.003	-16,8	-9,6	1,0
Depozita afatshkurtra në valuta, mbi 1 deri 2 vjet.	22.108	24.020	21.779	-8,8	8,6	-9,3
M3	436.231	474.753	499.803	8,0	8,8	5,3
Depozita afatshkurtra në denarë, mbi 2 vjet.	34.667	29.376	25.521	-3,1	-15,3	-13,1
Depozita afatshkurtra në valuta, mbi 2 vjet.	16.092	16.876	22.031	3,0	4,9	30,5
Gjithse depozita (pa para depozitash)	282.523	298.809	311.825	1,0	5,8	4,4
Gjithse depozita	443.288	476.525	499.861	5,7	7,5	4,9
M4	486.989	521.005	547.355	6,9	7,0	5,1

Burimi: BPRMV.

Grafiku 49

Oferta monetare, ndryshimi vjetor dhe struktura




Në vitin 2022, depozitat e përgjithshme në sektorin financiar realizuan rritje prej 4,9%, që ishte më e dobët në krahasim me një vit më parë (7,5%). Nga pikëpamja sektorale, rritja vjen kryesisht nga rritja e depozitave të amvisërive, me një rritje vjetore më të ulët edhe të depozitave të ndërmarrjeve. Nga pikëpamja valutore, rritja është rezultat i depozitave në

⁴⁰ Dallimi më i madh midis PBB-së nominale të realizuar për vitin 2021 dhe 2022 pasqyrohet edhe në treguesit relativë të parasë së gjerë në raport me PBB-në..

valutë të huaj, me rritje më mesatare të depozitave në denarë (përfshi edhe paratë depozituese).

Grafiku 50

Totali i depozitave (me para depozite), ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshim nga këndvështrimi sektorial




Burimi: BPRMV.

Depozitat e amvisërive⁴¹ shënuan rritje vjetore prej 5,8% më 2022 (7,1% më 2021). Në fillim të luftës në Ukrainë, në kushtet e pasigurisë së shtuar, në mars u vu re një rënie mujore afatshkurtër dhe mesatare e kursimeve, pas së cilës depozitat e popullsisë vazhduan të rriteshin. Gjatë vitit 2022, konflikti ushtarak në Ukrainë, goditja në çmimet botërore të produkteve primare, veçanërisht të energjisë, dhe rritja e përgjithshme e pasigurisë shkaktuan një ndryshim, si në strukturën valutore, ashtu dhe në atë të maturimit të depozitave të amvisërive. Në gjysmën e parë të vitit, kur efektet e goditjeve të akumuluar ishin më të theksuara, u vu re një ndryshim i prirjeve të subjekteve ekonomike në favor të një kontributi më të madh të kursimeve në valutë të huaj, në raport me valutën vendase dhe një rritje e komponentit afatshkurtër të kursimeve, që është sjellje e zakonshme në periudha pasigurie. Tashmë në mesin e vitit u vu re një përmbysje e prirjeve, kështu që, në fund të vitit u vu re një rritje e depozitave në valutën vendase dhe në afat të gjatë.

Grafiku 51

Totali i depozitave të amvisërive, ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshim sipas maturimit dhe strukturës valutore



Burimi: BPRMV.

Grafiku 52

Totali i depozitave të korporatave, ndryshimi vjetor dhe kontributi në strukturën e maturimit dhe të valutës



⁴¹ Të dhënat e depozitave përfshijnë edhe paratë e depozitave.

Në vitin 2022, rritja e depozitave të korporatave u ngadalësua për 3,7% (11,6% më 2021). Rritja e ndjeshme e nevojave për likuiditet të kompanive, nën ndikimin e krizës energjetike dhe importit më të shtrenjtë, çuan në një ulje të pazakontë të depozitave të ndërmarrjeve në gjysmën e parë të vitit. Megjithatë, me stabilizimin e trysnive, në gjashtëmujorin e dytë të vitit, mjetet e kompanive në banka shënuan rritje, e cila tejkaloi rënien e gjashtëmujorit të parë. Nga pikëpamja strukturore, rritje u realizua në depozitat afatshkurtra të ndërmarrjeve, me më pak depozita afatgjata me bazë vjetore. Nga pikëpamja valutore, kontributi i depozitave në valutë dhe denarë (përfshirë paratë depozituese) në rritjen e depozitave të përgjithshme të ndërmarrjeve është thuajse i barabartë.

Shkalla e euroizimit, e matur me pjesëmarrjen e depozitave me komponent valutor në totalin e depozitave të sistemit bankar, në vitin 2022 u rrit mesatarisht në nivelin 44,5% (43% një vit më parë). Te depozitat e amvisërive, pjesëmarrja e depozitave me komponent valutor arriti 52% (50,3% një vit më parë), që megjithatë paraqet një rritje mesatare të prirjes së amvisërive për të kursyer në valutë, në krahasim me zhvendosjen më të theksuar në rritje gjatë periudhës së krizës financiare globale.

3.5.2. Aktiviteti kreditor

Edhe gjatë vitit 2022, sektori bankar ofron mbështetje solide kreditore për ekonominë vendase, kurse rritja e totalit të kredive u përshpejtua dhe arriti 9,4% (8,3% më 2021). Në të njëjtën kohë, masat sistematike të Bankës Popullore dhe administrimi i kujdesshëm i rreziqeve nga bankat, kontribuan në ruajtjen e gjendjes së shëndetshme të aftësisë së pagesës dhe të likuiditetit të bankave. Rritja vjetore e totalit të kredive në fund të vitit 2022 arriti në 4,6% të PBB-së (4,1% të PBB-së në vitin 2021), ndërkohë që pjesëmarrja e kredive në PBB mbeti në një nivel relativisht të qëndrueshëm (53,2%).

Grafiku 53

Totali i kredive dhe norma aktive e interesit



Burimi: BPRMV.

Grafiku 54

Totali i kredive, pjesëmarrja në PBB




Sipas Anketës për aktivitetin kreditor të Bankës Popullore, në vitin 2022 vërehet rritje neto e kërkesës për kredi, më e fortë se ndërmarrjet, NDËRKAQ më e dobët tek amvisëritë, me një shtrëngim neto më të fortë të kushteve të kreditimit tek individët dhe ndërmarrjet, në krahasim me vitin e mëparshëm. Nga aspekti i rreziqeve, vazhdon rritja e perceptimit të rrezikut të ndërmarrjet, dukshëm më e fortë në krahasim me vitin e kaluar, analizuar përmes pritshmërive të bankave për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.

Sipas këndvështrimit sektoral, për herë të parë pas një periudhe të gjatë, mbështetja kreditore e bankave në vitin 2022 u drejtua më së shumti ndaj ndërmarrjeve, me një rritje

vjetore prej 11,5% (8,7% në vitin 2021), në përputhje me nevojat e tyre të rritura për likuiditet, para së gjithash për investime në inventarë dhe kapital qarkullues, por edhe për investime në mjete themelore⁴². Sa u përket kreditimit të amvisërive⁴³, shënon një rritje më mesatare prej 7,4% (7,9% në vitin 2021), kurse analiza sipas llojeve individuale të kredive, tregon se bartës të rritjes janë kreditë banesore, me një rritje më të mesatare të kredisë konsumatore. Në lidhje me strukturën valutore të rritjes së totalit të kredive, kontribut pozitiv kanë edhe kreditë në valutë vendore dhe të huaj (përfshirë kreditë në denarë me klauzolë valutore).

Grafiku 55


Totali i kredive, ndryshimi vjetor dhe struktura sektorale



Burimi: BPRMV.


Grafiku 56

Totali i kredisve të amvisërive, ndryshimi vjetor dhe struktura sipas qëllimit



Grafiku 57


Oferta dhe kërkesa (përqindje neto)*



* Për sa u përket kushteve të kredisë, një normë neto negative e interesit nënkupton një lehtësim të kushteve të kredisë. Në kërkesë, një përqindje neto negative nënkupton një ulje të kërkesës.

Grafiku 58

Perceptimi i rrezikut nga bankat (përqindje neto)*



* Në rastin e amvisërive, tregohet mesatarja e përqindjeve neto të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në kushtet e kreditimit gjatë miratimit të kredive banesore dhe konsumatore.

Informacion më të holëshme në lidhje me anketat e aktivitetit të kredisë mund të gjenden në faqen e internetit të BPRMV-së. Burimi: Anketa për aktivitetin kreditor, BPRMV.

⁴² Sipas Anketës së aktivitetit kreditor të Bankës Popullore.

⁴³ Pa kreditë e veprimtarëve të pavarur me punë personale.

IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare 2023 - 2025

Politika monetare e Bankës Popullore⁴⁴ do të vazhdojë të synojë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si objektiv bazë monetar i përcaktuar në përputhje me dispozitat ligjore. Në periudhën e ardhshme, Banka Popullore do të kontribuojë gjithashtu në ruajtjen e një sektori bankar të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe do të mbështesë politikën e përgjithshme ekonomike dhe rimëkëmbjen ekonomike, në kushtet e zgjatjes së konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe të pasigurisë nga zhvillimi i pandemisë së Covid-19, pa rrezikuar realizimin e qëllimit kryesor. Për të realizuar qëllimin e përcaktuar me ligj, Banka Popullore do të vazhdojë me strategjinë e ruajtjes stabile të kursit nominal të denarit në raport me euron. Rëndësia e kursit valutor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe të pritshmërive të qëndrueshme inflacioniste të subjekteve ekonomike buron nga karakteristikat e ekonomisë vendase, si e vogël dhe e hapur, me një varësi të lartë nga importet. Këto aspekte janë veçanërisht të rëndësishme në kushtet e trysnive të theksuara të çmimeve të jashtme dhe të goditjeve në anën e ofertës. Kuadri operativ i politikës monetare, ngjashëm si deri sot, do të vendoset në bazë që përshtatet për të ruajtur stabilitetin dhe likuiditetin e tregut valutor dhe stabilizimin e inflacionit në periudhë afatmesme. Në këtë mënyrë, politika monetare do të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik, si faktor kyç në krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Gjatë vitit 2022, në kushtet e trysnive të vazhdueshme të çmimeve, për të ruajtur stabilitetin e kursit valutor dhe për të stabilizuar inflacionin në periudhë afatmesme, Banka Popullore vazhdoi me përshtatjen e politikës monetare, e cila filloi në fund të vitit 2021. Nga prilli i vitit 2022, e deri në fund, norma bazë e interesit e Bankës Popullore u rrit disa herë, për gjithsej 3,50 p.p., duke arritur në nivelin 4,75%. Në përputhje me rritjen e normës bazë të interesit, u zbatuan edhe normat më të larta të interesit të kredisë njëditore. Gjithashtu, u rritën edhe normat e interesit për depozitat e disponueshme njëditore dhe shtatëditore, të cilat në fund të vitit 2022 arrijnë në 2,65%, përkatësisht 2,70%. Shtrëngimi i politikës monetare synon të stabilizojë pritshmërit inflacioniste të shkaktuara nga goditjet e jashtme të çmimeve, të cilat ekzistojnë për një periudhë më të gjatë. Duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit valutor stabil të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare vendase pasqyrojnë edhe ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane. Gjatë vitit u ndërmorën masa shtesë, përmes të cilave përforcohen sinjalet monetare dhe të cilat kontribuojnë në mbështetjen e mëtejme të procesit të denarizimit të ekonomisë. Kështu, u bë ndryshimi i instrumentit të rezervës së detyrueshme (tre herë) duke i ndarë normat e rezervës së detyrueshme sipas aspektit valutor, me ç'rast u zvogëlua norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet në denarë, ndërsa në të njëjtën kohë, norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë të huaj, u rrit. Këto masa pritet të kenë ndikim pozitiv në strukturën valutore të depozitave në sistemin bankar, duke nxitur kursimet në valutën vendore, që është në përputhje edhe me Strategjinë kombëtare për denarizimin e ekonomisë maqedonase. Po ashtu, u zbatua një masë jostandarde për nxitjen e kreditimit të projekteve që kanë të bëjnë me prodhimin vendas të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Me këtë vendim, baza për ndarjen e rezervës së detyrueshme në denarë për bankat zvogëlohet për shumën e kredive të reja të miratuara për financimin e projekteve të prodhimit vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Në këtë mënyrë, në kushtet e krizës energjetike dhe të rritjes së fuqishme të çmimeve globale të energjisë elektrike, të cilat ndikojnë në tregun valutor, por edhe në çmimet vendase dhe standardin e jetesës, Banka Popullore kontribuon në zbutjen e trysnive dhe të problemeve strukturore në

⁴⁴ Ky seksion ofron një pasqyrë të parashikimeve makroekonomike të Bankës Popullore nga tetori i vitit 2022.

ekonomi. Veç kësaj, kjo masë mbështet "financat e gjelbra" dhe financimin e qëndrueshëm, si objektiv strategjik në planin më të fundit strategjik të bankës qendrore. Gjatë vitit u miratuan masa shtesë sistimore për të forcuar më tej qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

Sipas parashikimeve të fundit zyrtare makroekonomike të Bankës Popullore, rimëkëmbja e ekonomisë vendase pas pandemisë është duke ecur më ngadalë, në kushtet e përkeqësimit të perspektivës ekonomike për shkak të luftës në Ukrainë dhe të thellimit të krizës energjetike, e cila ndikon edhe në shpenzimet e jetesës dhe për pasojë, çon në uljen e normave të parashikuara të rritje ekonomike, në krahasim me pritshmëritë e mëparshme. Rishikimi pasqyron pritshmëritë për një rritje më të ngadaltë të partnerët tanë kryesorë tregtarë, për ndikimin e inflacionit më të lartë, kushtet më të ashpërsuara të financimit, për zinxhirët e vështirësuar të furnizimit dhe për rritjen e pasigurisë që lidhet me pushtimin rus të Ukrainës. Duke marrë parasysh pasigurinë dhe ndryshueshmërinë e madhe të mjedisit, janë përgatitur dy skenarë. Sipas skenarit bazë, rritja në vitin 2023 do të ishte 2,6%, e cila do të mbështetej nga cikli i paralajmëruar i infrastrukturës publike, por edhe nga investimet dhe zgjerimi i kapaciteteve në një pjesë të sektorit të eksportit. Në rast të mosarritjes së këtyre efekteve të pritshme, ndërsa në kushtet kur pritet që kontributi nga kërkesa e jashtme të jetë i vogël, perspektivat ekonomike mund të jenë më pak të favorshme, ndërkohë që skenari alternativ tregon një ngadalësim të mëtejshëm, e më saktësisht, reduktim të shkallës së rritjes në 1,8% në 2023. Në përputhje me supozimet për shterimin gradual të efekteve të goditjeve të jashtme aktuale në ekonominë globale dhe vendore, qetësimi i trysnive inflacioniste, reduktimi i pasigurisë dhe rinovimi i besimit të subjekteve ekonomike, parashikohet rritja e PBB-së në 3,6% më 2024 dhe në 4%, më 2025. Nga këndvështrimi i strukturës së PBB-së, pritet që kërkesa vendore të vazhdojë të kontribuojë pozitivisht në rritje në vitin 2023, kurse në vitin 2024, një kontribut i vogël pozitiv pritet edhe nga eksportet neto.

Pas rritjes së lartë të çmimeve të konsumit në vitin 2022, kur vlerësohen përshtatje në rënie të çmimeve të importit, në vitin 2023 pritet që inflacioni të nadalësohet. Gjithashtu, nën ndikimin e masave të paralajmëruara për subvencionimin na shteti të çmimit të energjisë elektrike për industrinë ushqimore, për periudhën kohore sa zgjat gjendja e krizës në furnizimin me energji elektrike, si dhe për shkak të efekteve të shtrëngimit gradual të politikës monetare, pritet që inflacioni të jetë 8 – 9%, në varësi të fuqisë së rritjes së çmimeve të energjisë elektrike në tregun rregullator. Në aspekt afatmesëm, inflacioni do të vijojë të stabilizohet, duke u ulur në nivelet 2,4% dhe 2% në vitet 2024 dhe 2025, si dhe duke supozuar shterimin e plotë të efekteve të rritjes aktuale të çmimeve të produkteve primare ushqimore dhe energjitike në tregun botëror dhe mungesën e goditjeve të reja në anën e ofertës. Megjithatë, në kushtet e ndryshimeve të konsiderueshme në lëvizjen e çmimeve botërore të produkteve primare, të shkaktuara nga lufta në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj Rusisë nga shumica e vendeve të botës, pasiguria në lidhje me lëvizjet e ardhshme të çmimeve është jashtëzakonisht e lartë.

Vlerësimet për zhvillimet në sektorin e jashtëm në periudhën 2023-2025 theksojnë për një deficit në transaksionet aktuale prej mesatarisht 3% të PBB-së, pas një zgjerimi të theksuar në vitin 2022, si rezultat i kushteve të tejzgjatura të pafavorshme të tregtisë, të shkaktuara nga rritja e çmimeve të importit, sidomos në energji dhe ushqim. Në vitin 2023 pritet ngushtimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse në 5,6% të PBB-së, kryesisht si pasojë e ngushtimit të bilancit negativ në këmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Pra, pritet që efektet negative të luftës në Ukrainë të kalojnë edhe në vitin 2023, ndërsa tregjet e produkteve primare do të stabilizoheshin. Kështu, ulja e kërkesës vendase për energji dhe rritja e prodhimit vendas do të kontribuojnë në një ngushtim gradual të deficitit energjetik, ndërkohë që realizimet solide të eksportit të sektorit të automobilave dhe rimëkëmbja e industrisë së përpunimit të metaleve, si dhe importi më i ulët për konsum dhe investime do të kontribonte

në ngushtimin e mëtejshëm të deficitit tregtar joenergjetik dhe në të njëjtën kohë për një deficit të përgjithshëm më të ulët në bazë vjetore. Po ashtu, pritet që realizimet e mira në eksportin e shërbimeve të vazhdojnë edhe në vitin 2023, gjë që do të çonte në rritjen e mëtejshme të suficitit në këtë kategori. Në vitin 2024 pritet një reduktim i mëtejshëm i deficitit në llogarinë rrjedhëse në 2,1% të PBB-së dhe reduktimi i tij në 1,2% të PBB-së në vitin 2025. Parashikohet që hyrjet neto të projektuara në llogarinë financiare do të financojnë plotësisht transaksionet aktuale në periudhën 2023-2025 dhe do të mundësojnë rritjen shtesë të rezervave valutore. Pritet që pjesa më e madhe e flukseve financiare të vijnë nga huamarrja e jashtme e shtetit dhe nga investimet e huaja të drejtpërdrejta. Treguesit për mjaftueshmërinë e rezervave valutore tregojnë për ruajtjen e tyre në zonën e sigurt gjatë gjithë periudhës së projeksioneve.


Aktiviteti kreditues i sistemit bankar vazhdon të jetë një nga faktorët e rëndësishëm për mbështetjen e rritjes ekonomike. Në vitin 2023 pritet një shkallë e rritjes së kredive për 7,1%, me kushte më pak të favorshme financiare dhe efekt të pafavorshëm të pasigurisë së mëtejshme dhe të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, ndërkaq në periudhë afatmesme parashikohet stabilizimi i aktivitetit kreditues, me një shkallë mesatare të rritjes prej 7,5%. Rritja e kredisë, ngjashëm si deri sot, do të mbështetet nga rritja e depozitave, si burimi kryesor i financimit të bankave. Me stabilizimin e flukseve dhe veprimin e masave të Bankës Popullore për nxitjen e kursimit në denarë, në vitin 2023 pritet një përshejtim mesatar i rritjes së depozitave, i cili do të arrijë 6,5%. Me rritjen e aktivitetit ekonomik dhe rritjen e fuqisë blerëse të popullsisë, në periudhën e ardhshme (2024-2025) pritet një rritje solide e depozitave për rreth 8% mesatarisht.

Pasiguria dhe rreziqet për ekonominë globale dhe atë vendase në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme vazhdojnë të jenë në rënie dhe të theksuara. Tensionet e mëtejshme gjeopolitike nga pushtimi ushtarak rus në Ukrainë, si dhe pandemia e Covid-19, e cila ende nuk është kapërcyer plotësisht, përkeqësojnë mjedisin global, ndikojnë negativisht në perspektivat ekonomike dhe krijojnë trysni shtesë në çmimet botërore, mbi të gjitha në tregjet e energjisë dhe të produkteve ushqimore. Një faktor shtesë që do të kufizojë aktivitetin ekonomik do të jetë shtrëngimi më i fortë i kushteve globale të financimit, duke marrë parasysh rritjen e forcuar dhe afatgjatë të inflacionit në korniza botërore.

Në sferën fiskale, në periudhën afatmesme pritet një konsolidim gradual buxhetor. Deficiti buxhetor do të financohet nga një kombinim i burimeve vendore dhe të jashtme. Politika fiskale e përcaktuar ndiqet nga rreziqe të cilat, ngjashëm si te politika monetare, lindin nga ndikimi i zhvillimeve gjeopolitike në aktivitetin ekonomik global dhe në çmimet botërore, nga perspektivat për tejkalimin e pandemisë, si dhe nga ndryshimet në kushtet financiare dhe të gjendjes së tregjeve financiare ndërkombëtare.

Banka Popullore monitoron me kujdes të dhënat makroekonomike dhe rreziqet e mundshme nga mjedisi vendas dhe i jashtëm dhe është e gatshme të përdorë të gjitha instrumentet e nevojshme e të marrë masa që do të kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor, stabilizimin e pritshmërive inflacioniste dhe stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm.

V. Instrumentet monetare



Në kushtet e ndikimit negativ të theksuar të luftës në Ukrainë në mjedisin vendas makroekonomik, në vitin 2022, Banka Kombëtare vazhdoi ciklin e normalizimit të politikës monetare që filloi në fund të vitit të mëparshëm, duke menaxhuar në mënyrë aktive likuiditetin në valutën vendase nëpërmjet ndërhyrjeve në tregun valutor, ndërkaq nga prilli i vitit 2022 e nisi edhe ciklin e shtrëngimit të kushteve monetare nëpërmjet rritjes së normave të interesit. Ndërhyrjet e Bankës Popullore në tregun valutor, ku qysh në fund të vitit 2021 u vunë re trysni, bënë të mundur ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor të denarit. Për të siguruar stabilitetin afatmesëm të çmimeve, ndërsa në kushtet e trysnive të theksuara inflacioniste të shkaktuara nga çmimet e larta të energjisë dhe të ushqimeve në bursat botërore, të cilat gjallëruan pritshmëritë inflacioniste të subjekteve ekonomike vendase, gjatë vitit 2022, në tetë raste radhazi, Banka Popullore rriti normën bazë të interesit për gjithsej 3,50 p.p., deri në nivelin prej 4,75%. Në të njëjtën kohë, u rritën edhe normat e interesit për depozitat e disponueshme njëditore dhe shtatëditore, të cilat në fund të vitit ishin 2,65%, përkatësisht 2,70%. Ky sistem monetar u mbështet edhe nga disa ndryshime në instrumentin e rezervës së detyrueshme, të cilat kishin për qëllim nxitjen e kursimit në denarë. Përballë krizës energjetike dhe nevojës për përshtatje strukturore të ekonomisë vendase, Banka Popullore prezantoi një masë të re jostandarde në rezervën e detyrueshme, e cila mundëson mbështetje kreditore qëllimplotë për prodhimin vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Në fillim të vitit 2022, për shkak të pasigurisë së tejzgjatur, si pasojë e fillimit të konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe të sanksioneve kundër Rusisë, zinxhirët globalë të furnizimit tashmë të ndërprerë, tregjet e mallrave u përkeqësuan më tej, ndërkaq u thellua edhe kriza globale e energjisë. Në këto rrethana të reja, trysnitë e çmimeve u rritën dhe u pasqyruan në lëvizjet e tregut vendor valutor. Ndryshimet në segmentin e tregut valutor, të cilat u karakterizuan nga rritja e kërkesës për valuta, u udhëhoqën nga kompanitë e sektorit të energjisë, si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë në tregjet botërore. Për shkak të këtyre lëvizjeve të tregut, si dhe për shkak të dinamikës në rritje të inflacionit në korniza ndërkombëtare, e cila u pasqyrua edhe në çmimet vendore, pasiguria u rrit, duke gjallëruar pritshmëritë inflacioniste të popullatës, njëkohësisht duke rritur prirjen e tyre për të ruajtur mjetet monetare të huaja. Rrjedhimisht, këto rrethana krijuan trysni të përkohshme në tregun valutor, të cilat u tejkaluan me reagimin në kohë dhe vendimtar të Bankës Popullore. Banka Popullore ishte e pranishme në tregun valutor, duke kënaqur kërkesën e shtuar për valutë dhe kishte komunikim të përforcuar me publikun për stabilizimin e pritshmërive, që mundësoi ruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit. Prania e Bankës Popullore në tregun valutor, e mbështetur nga niveli solid i rezervave valutore, mundësoi ruajtjen e likuiditetit valutor të

sistemit bankar në nivelin e duhur⁴⁵. Mbështetje shtesë për Bankën Popullore në këto kushte ishte edhe zgjerimi i linjës së repove me BQE-në për të siguruar likuiditet valutor në euro⁴⁶, nga të cilat, edhe në vitin 2022 nuk u përdorën mjetet për shkak të nivelit të kënaqshëm dhe të likuiditetit të mjaftueshëm të mjeteve në valutë. Ndërhyrjet e Bankës Popullore për të shitur valutat gjatë gjysmës së parë të vitit (403,5 milionë euro), të cilat u përdorën si instrument, për menaxhimin aktiv të likuiditetit në sistemin bankar, këto kontribuan në uljen e mjeteve në denarë të bankave. Për të ruajtur nivelin optimal të likuiditetit, u përdorën instrumentet e mbetura monetare. Në fillim Bankat tërhoqën një pjesë të mjeteve të vendosura në depozitat njëditore pranë Bankës Popullore dhe i përdorën për blerjen e mjeteve në valutë, në mënyrë që baraspesha mesatare e këtij instrumenti afatshkurtër, në dy tremujorët e parë të vitit, u ul me rreth 9 miliardë denarë. Ky lloj i menaxhimit të likuiditetit rezultoi nga natyra e depozitave të disponueshme, të cilat mundësojnë fleksibilitet në menaxhimin e ndryshimeve afatshkurtra të likuiditetit dhe disponueshmëri të lartë të mjeteve. Gjatë menaxhimit të ndryshimeve të likuiditetit, bankat përdorën edhe një pjesë të mjeteve të vendosura në bono thesari. Kështu, në ankandet e instrumentit bazë, kërkesa ishte mesatarisht më e ulët për rreth 25% në raport me ofertën, të cilën Banka Popullore gjatë vitit e mbajti në nivelin prej 10 miliardë denarë⁴⁷. Për të kompensuar potencialin e zvogëluar të likuiditetit në denarë, në tremujorin e dytë të vitit, ndonëse në shuma relativisht të vogla⁴⁸, bankat siguruan mjete nga Banka Popullore edhe përmes operacioneve repo, për të krijuar likuiditet, e të cilat kryhen në baza javore.

Si përgjigje ndja rritjes së prirjes për kursim në valutë të huaj, Banka Popullore ndërmori masa qëllimplota, përkatësisht bëri ndryshime në sistemin e rezervës së detyrueshme, për të nxitur më tej kursimet në denarë, që do të arrihej përmes ndryshimeve të duhura në politikën e interesit të bankave. Andaj, në fillim të prillit dhe në qershor⁴⁹ e uli normën e rezervës së detyrueshme, nga detyrimet në denarë, nga 8% në 5% dhe në të njëjtën kohë e rriti normën e rezervës së detyrueshme, nga detyrimet në valuta, nga 15% në 18%. Detyrimi më i ulët për rezervën e detyrueshme në denarë, për shkak të zbatimit të normave më të ulëta, solli në lirim të rreth 7 miliardë denarëve në sistemin bankar, duke kompensuar kështu një pjesë të likuiditetit të reduktuar të bankave. Për të forcuar efektin e ndarjes së normave nga perspektiva valutore, Banka Popullore rriti edhe pjesën e rezervës së detyrueshme në valutë, që bankat e plotësojnë në euro, nga 70% në 75%, ndërsa për menaxhim më fleksibël të likuiditetit valutor, rriti edhe pjesën e rezervës së detyrueshme në euro, e cila plotësohet në bazë mesatare, nga 5% në 10%.

Për shkak të trysnive gjithnjë e më të larta të çmimeve të importit, të cilat janë komponentë hyrëse për disa kategori produktesh dhe ndikuan në pritshmëritë inflacioniste, Banka Popullore reagon që nga muaji prill, duke shtrënguar kushtet monetare dhe duke rritur normat e interesit. Kështu, në tetë raste radhazi, norma bazë e interesit e zbatuar për bonot e thesarit u rrit për gjithsej 3,50 p.p., deri në 4,75%⁵⁰. Ndryshimet në normën referencë të interesit u plotësuan me një rritje të normës së interesit për depozitat shtatëditore të

⁴⁵ Menaxhimi i likuiditetit valutor të bankave përfshiu edhe mundësinë e vendosjeve pa rrezik, në euro, te Banka Popullore, me afat maturimi prej 1 dhe 3 muaj. Bankat kishin një interes mesatar për vendosjen e mjeteve në këtë instrument, të cilin Banka Popullore e aktivizoi në gusht të vitit 2020.

⁴⁶ Në gusht të vitit 2020, BQE krijoi një linjë repo për Bankën Popullore, për të siguruar likuiditet valutor në shumën totale prej 400 milionë euro. Në vitin 2022, për shkak të pasojave globale të krizës ruso-ukrainase, BQE zgjati dy herë mundësinë e përdorimit të linjës repo, deri në janar të vitit 2024.

⁴⁷ Në ankandet e bonove të thesarit, të cilat mbahen në ditën e parë të periudhave të rezervës së detyruar, zbatohet një tender me shumë (një shumë e kufizuar oferte dhe një normë interesi fikse).


⁴⁸ Kërkesa mesatare ishte relativisht e ulët dhe ishte rreth 3,6% të gjendjes së përgjithshme të instrumenteve monetare.

⁴⁹ Në nëntor, por me zbatim nga janari i vitit 2023, norma e rezervës së detyrueshme të bankave për detyrimet në valutë u rrit nga 18% në 19%, ndërsa pjesa e rezervës së detyrueshme në valutë, që bankat plotësojnë në euro, u rrit nga 75% në 77%.

⁵⁰ Rrjedhimisht, norma më të larta interesi u zbatuan edhe në ankandet repo, për të krijuar likuiditet dhe për kreditë e disponueshme njëditore, norma e interesit të të cilave është e barabartë, pra më e lartë për 0,5 p.p. në krahasim me normën e interesit të bonove të thesarit, përkatësisht.


disponueshme për gjithsej 2,40 p.p. deri në 2,70%, ndërsaq norma e interesit për depozitat njëditore u rrit për 2,50 p.p., deri në 2,65%.

Grafiku 59
Korridori i normës së interesit



* 7DD – Depozita të disponueshme shtatëditore; DNj – Depozita njëditore; KNj – Kredi njëditore

Grafiku 60
Rrjedha e likuiditetit nga faktorët autonomë




* FMA – Faktorët e mbetur autonomë

Grafiku 61
Bonot e thesarit dhe teprica e mjeteve likuide të bankave⁵¹



Burimi: BPRMV.

Grafiku 62
Gjendja e instrumenteve monetare



Lëvizjet në tregun valutor janë përmirësuar ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit. Kompanitë nga industria e energjisë elektrike kishin një nevojë të zvogëluar për mjete valutore, e cila u kompensua në masë të madhe nga rritja e flukseve valutore nga transferet private në muajt e verës, të cilat tejkaluan nivelin e parakrizës. Gjithashtu, ulja e prirjes së popullsisë për mjete monetare të huaja ka çuar në një rritje të vazhdueshme të ofertës neto të valutave nga këto subjekte. Në këto rrethana, likuiditeti valutor i bankave u përmirësua ndjeshëm, prandaj nga korriku deri në dhjetor Banka Popullore ndërhyri me blerjen neto të mjeteve të tepërta valutore nga sistemi bankar (gjithsej 245,5 milionë euro), që mundësoi krijimi i likuiditetit në denarë në sasi të përshtatshme. Në të njëjtën periudhë, rritja e vëllimit të ndihmës buxhetore për mbështetjen financiare të sektorit energjetik, sidomos në tremujorin e fundit të vitit, ndikoi në rritjen e mëtejshme të mjeteve likuide të bankave në valutë vendase. Pikërisht për shkak të sasisë së lartë të mjeteve të lira, që nga gushti, bankat nuk kishin nevojë të siguronin mjete nga Banka Popullore përmes ankandëve repo për të krijuar likuiditet. Pozicioni solid dhe relativisht i lartë i likuiditetit kontriboi në rritjen e vazhdueshme të interesit të bankave për rritjen e vendosjeve në bono thesari, kështu që kërkesa në fund të vitit ishte mesatarisht më e ulët se shumica e ofruar nga Banka Popullore. Bankat vazhduan të drejtojnë pjesën më të madhe të tepricës së mjeteve në depozitat e disponueshme njëditore në Bankën

⁵¹ Teprica e mjeteve likuide të bankave i referohet ditës së parë të periudhës së rezervës së detyrueshme kur mbahet ankandi i bonove të thesarit dhe paraqet shumën e përgjithshme të mjeteve në llogaritë e rregullta të bankave në Bankën Popullore, shumën e detyrueshme të bonove të thesarit dhe depozitat e disponueshme në BPRMV dhe kërkesat e tregut të parave, të reduktuara nga detyrimet e tregut të parave dhe shumën e rezervës së detyrueshme për periudhën në vijim.


Popullore, kështu që gjendja mesatare e këtij instrumenti u rrit gradualisht dhe në fund të vitit arriti në 34,5 miliardë denarë, që është rreth nivelit të dhjetorit të vitit 2021⁵².

Shtojcë 1. Lëvizje në tregun e valutave⁵³ dhe ndërhyrjet e Bankës Popullore

Në vitin 2022, tregu valutor në transaksionet e bankave me klientët shënoi rritje neto të shitjes së valutave, e cila korrespondonte me mjedisin e jashtëm ekonomik të ekonomisë vendase, ndërkaq kurset e valutave të të gjitha segmenteve të tregut valutor mbetën në nivel të qëndrueshëm. Rritja e çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, e cila u përforcua nga përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike në fillim të vitit, për shkak të ndërhyrjes ushtarake në Ukrainë, çoi në një rritje të ndjeshme të çmimeve të importit të mallrave (veçanërisht të energjisë, metaleve dhe produkteve të grurit), disa prej të cilave arritën nivele të larta historike. Këto zhvillime në tregjet botërore patën një ndikim të rëndësishëm në këmbimin tregtar të jashtëm të ekonomisë vendase dhe një ndikim të fortë në ofertën dhe kërkesën për valuta nga kompanitë vendase.


Grafiku 63

Shitja neto e valutave të bankave për klientët e tyre




Grafiku 64

Ndryshimi vjetor i ofertës dhe i kërkesës për valuta, sipas klientëve



Grafiku 65

Kërkesa për valuta nga firmat në tregun e valutave, në tremujorë



Grafiku 66

Oferta e valutave nga firmat në tregun e valutave, në tremujorë



Burimi: BPRMV.

Nevoja e kompanive për likuiditet valutor, për prodhimin dhe tregtimin e naftës dhe të energjisë elektrike, kontribuon në rreth 60% të kërkesës vjetore më të lartë (me 1,7 miliardë euro) për valuta nga sektori i korporatave, për të cilën, efekti i çmimit ka ndikim më të madh. Dinamika në rritje e çmimeve të produkteve primare dhe ushqimore në nivel global kontribuoi edhe në rritjen e kërkesës së kompanive për valuta, për tregti dhe prodhim të ushqimeve, pijeve dhe duhanit dhe tregti me shumicë. Kontributin më të madh (rreth 18%) në rritjen vjetore të ofertës për valutë e kanë kompanitë

⁵² Rritje graduale dhe të moderuar shënuan edhe vendosjet në depozitat shtatëditore të disponueshme në Bankën Popullore, por pjesëmarrja e tyre në totalin e bilancit të instrumenteve monetare në fund të vitit vazhdonte të ishte relativisht e ulët, rreth 5%.


⁵³ Në korniza të kësaj analize, tregu valutor përfshin transaksionet ndërmjet bankave dhe klientëve të tyre dhe tregtimin ndërbankar.

e tregtisë dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike (e cila arrin në 1,3 miliardë euro), të ndjekura nga kompanitë e industrisë së metaleve dhe të automobilave dhe kompanitë e sektorit të informatikës. Gjatë rritjes vjetore më të lartë të kërkesës, shitja neto e valutave nga bankat, për nevojat e sektorit të korporatave, ishte më e larta historikisht (në bazë vjetore, më e lartë për 533 milionë euro) dhe kontribuoi në thellimin e deficitit tregtar në bilancin e pagesave.

Një pjesë e rritjes së kërkesës për likuiditet valutor nga sektori i korporatave u plotësua nëpërmjet ofertës së mjeteve valutore nga personat fizikë në tregun valutor dhe të këmbimit, e cila, edhe pse ishte më e lartë në baza vjetore, gjatë vitit kishte dinamika të ndryshme. Në tregun valutor, bankat kishin një pozicion të baraspeshuar në transaksionet me presona fizikë, që është një realizim dukshëm më e mirë në krahasim me vitet 2021 dhe 2020, kur bankat shisnin valutë në bazë neto. Në mënyrë dinamike, në tremujorin e parë të vitit, personat fizikë kishin nevojë neto për mjete në valutë, që shpjegohet me prirjen e tyre për të mbajtur mjete monetare të huaja. Deri në fund të vitit, pritshmëritë e popullsisë në tërësi u stabilizuan, që konfirmohet nga oferta neto mbimesatare e mjeteve të huaja të pagesës nga këto subjekte. Në tregun valutor (dhe posaçërisht në transaksionet me këmbimoret), oferta me mjete të huaja efektive të pagesës nga persona fizikë gjatë gjithë vitit ishte dukshëm më e lartë në krahasim me periudhën para pandemisë dhe kontriboi në një rritje të ndjeshme (me rreth 40% ose me 423,3 milionë euro, në nivel vjetor) të tepërisë së valutave që këmbimoret ua ofrojnë bankave vendase.

Grafiku 67

Blerja e valutës e bankave nga këmbimoret, sipas tremujorëve



Burimi: BPRMV.


Grafiku 68

Oferta/kërkesa neto e valutave nga personat fizikë në tregun valutor, sipas tremujorëve



Në vitin 2022, bankat realizuan shitje neto të valutës për nevojat e klientëve të tyre në vlerë prej 841 milionë euro, që është për 72 milionë euro më shumë në bazë vjetore. Duke pasur parasysh që bankat e siguruan pjesën më të madhe të mjeteve likuide valutore të nevojshme nga burimet e veta, por edhe në tregun ndërbankar të valutave (qarkullim prej 1,033 milionë euro), ndërhyrjet e Bankës Popullore për shitjen neto të valutave më 2022 (158 milionë euro) ishin mesatarisht më të lartë në bazë vjetore dhe katër herë më të ulëta në krahasim me vitin 2020. Duke qenë se trysia në tregun valutor nga kriza energjetike dhe veprimet ushtarake në Ukrainë ishte më e theksuar në tremujorin e parë të vitit, Banka Popullore ndërhyri në gjashtë muajt e parë, duke shitur 403,5 milionë euro. Krahas intervenimeve dhe reagimeve monetare të ndërmarra, Banka Popullore gjatë kësaj periudhe veproi edhe përmes komunikimit të përforcuar për normalizimin e pritshmërive të subjekteve vendore dhe për ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor të denarit në raport me euron. Për shkak të prirjeve më të mira të tregut dhe të likuiditetit më solid valutor të bankave në gjysmën e dytë të vitit, Banka Popullore ndërhyri në periudhën e mbetur me një blerje neto relativisht të lartë prej prej 245,5 milionë euro. Hapësira komode e Bankës Popullore për pjesëmarrje në tregun valutor u mbështet nga niveli solid dhe i përshtatshëm i rezervave valutore, ndërsa kursi i denarit në raport me euron u ruajt në nivel stabil.

Grafiku 69
Ndërhryrjet e BPRMV-së në tregun valutor



Burimi: BPRMV

Grafiku 70
Kursi i mesëm i denarit në raport me euron



Përpos ndryshimeve në sistemin e rezervës së detyrueshme për të nxitur kursimet në denarë, në tetor Banka Popullore përdori masën e re jostandarde, e cila mundëson mbështetje qëllimplotë për lehtësimin e kushteve të kreditimit, kësaj radhe për prodhimin vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Masa synon të zbusë tryshinë nga kriza energjetike, të inkurajojë ndryshimet strukturore në ekonominë vendase dhe të mbështesë financimin e qëndrueshëm. Me këtë masë mundësohet zvogëlimi i bazës për detyrimin e bankave për rezervën e detyrueshme në denarë, për shumën e kredive të reja të miratuara për financimin e projekteve të prodhimit vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Që nga fillimi i zbatimit të masës, pjesa më e madhe e kredive të miratuara (rreth 96%) janë afatgjata dhe janë të paracaktuara për ndërtimin e objekteve të reja, ndërsa pjesa tjetër për rritjen e kapacitetit të instaluar të objekteve ekzistuese. Zbatimi i masës jostandarde mundësoi zvogëlimin mesatar të detyrimit të bankave për ndarjen e rezervës së detyrueshme në Bankën Popullore, për 60 milionë denarë.

Gjatë vitit 2022 Banka Popullore përdori edhe masën jostandarde për rezervën e detyrueshme (të aktivizuar në mars 2020), e cila kishte për qëllim mbështetjen e pandërprerë kreditore të ndërmarrjeve të sferës më të prekur nga kriza shëndetësore⁵⁴. Aktiviteti kreditor i bankave ndaj veprimtarive të mbështetura (shërbyese dhe të reja të shtuara nga viti 2021) në vitin 2022 ishte i dobët, në përputhje me rimëkëmbjen e gjendjes në sektorët e mbështetur, që kontribuoi në rënien (për 1.698 milionë denarë) e gjendjes së këtyre kredive në fund të dhjetorit në 3.998 milionë denarë. Duke marrë parasysh këto zhvillime, masa jostandarde në vitin 2022 kontribuoi në rritjen e detyrimit për rezervë të detyrueshme në denarë për gjithsej 147 milionë denarë.

⁵⁴ Masa mundëson lirin e një pjese të mjeteve likuide që bankat i lënë mënjanë te Banka Popullore, në bazë të rezervës së detyrueshme, duke ulur bazën e detyrimeve në valutën vendase për shumën e kredive të reja të miratuara dhe të ristrukturuara të miratuara për ndërmarrjet që, në përputhje me informacionet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë më të prekura nga përhapja e Covid-19.

Grafiku 71


Ndryshimi i rezervës së detyrueshme të bankave



Burimi: BPRMV

Grafiku 72

Shkalla e rezervës së detyrueshme



Ndryshimet në detyrimet në denarë dhe në valuta të bankave, së bashku me ndryshimet në sistemin e rezervës së detyruar, kontribuan në një rritje vjetore relativisht të lartë të detyrimit të bankave për rezervë të detyrueshme, për gjithsej 2.799 milionë denarë. Në të njëjtën kohë, ndryshimet në rezervën e detyrueshme nga aspekti valutor janë kryesisht pasqyrim i ndarjes së shkallës së rezervës së detyrueshme, ndërsa kontribut përkatës ka edhe rritja relativisht më e fortë e valutave në raport me detyrimet në denarë⁵⁵. Kështu, me zbatimin e shkallëve më të ulëta të rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë vendase, Banka Popullore liroi rreth 7.000 milionë denarë nga mjetet likuide të tërhequra përmes këtij instrumenti, që u neutralizua pjesërisht me rritjen mesatare të këtyre detyrimeve, me ç'rast rezerva e detyrueshme në denarë në bazë vjetore u ul për 4.328 milionë denarë (në nivelin prej 22.619 milionë denarë). Në anën tjetër, rezerva e detyrueshme që bankat e plotësojnë me euro, shënoi rritje relativisht të lartë prej 9.225 milionë denarë (duke arritur në 30.177 milionë denarë në fund të vitit), për të cilën kontributin më të madh (rreth 70%) e ka zbatimi i shkallëve më të larta për detyrimet në valutë.


⁵⁵ Më shumë hollësi rreth ndryshimeve në bazën e depozitave të bankave në rubrikën Agregatët Monetare.

Shtojca 2. Lëvizje në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara dhe në tregun sekondar të letrave me vlerë⁵⁶

Në vitin 2022, bankat kishin një aktivitet dukshëm më të lartë në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara (39.008 milionë denarë) në krahasim me tri vitet e fundit, që më së shumti shpjegohet me zvogëlimin e mjeteve të tepërta likuide në gjysmën e parë të vitit.

Grafiku 73


Qarkullimi i tregut ndërbankar të valutave të pasiguruara



Burimi: BPRM.

Grafiku 74

Likuiditeti i tepërt i sistemit bankar dhe huamarrja e bankave



Sa i përket strukturës së maturimit të depozitave të pasiguruara të tregtuara, edhe në vitin 2022, pjesën më të madhe të nevojave afatshkurtra për mjete në denarë bankat e siguruan nga depozitat e pasiguruara me afat maturimi deri në një javë, përfaqësimi i të cilave ishte historikisht më i madhi (89 %) dhe dukshëm mbi shumën e huamarrjeve me maturim njëditor (të cilat përfaqësohen me rreth 8% në totalin e tregtimit). Krahas këtyre dy maturimeve, pas një ndërprerjeje prej dy vitesh, u realizuan disa transaksione me depozita të pasiguruara me afat maturimi deri në një muaj, pjesëmarrja e të cilave në vëllimin e përgjithshëm, megjithatë, është relativisht e ulët (3%). Struktura e maturimit të tregtimit, si dhe kërkesa më e lartë për mjete likuide të bankave, e përqendruar kryesisht në periudhën prill-qershor, u pasqyrua edhe në huamarrjen mesatare ditore në tregun ndërbankar (rreth 670 milionë denarë), që ishte më e lartë për thujtse pesë herë në bazë vjetore.


Normat e realizuara të interesit në tregun e depozitave ndërbankare të pasiguruara në vitin 2022 kanë ndjekur ciklin e ndryshimeve në normat e interesit të Bankës Popullore. Konkretisht, norma mesatare e interesit ndërbankar e të gjitha transaksioneve (NINB) në fund të vitit ishte 2,54% dhe ishte më lartë për 1,45 p.p., në krahasim me nivelin e dhjetorit të vitit 2021. Në një nivel më të lartë, për 1,46 p.p. në bazë vjetore, ka qenë edhe norma e interesit të kredive të pasiguruara ndërbankare më të tregtuara me afat maturimi njëjavor, e cila në fund të vitit arriti në 2,55% dhe lëvizte rreth normës së interesit të depozitave shtatëditore të disponueshme të Bankës Popullore. Për shkak të nevojës së herëpashershme për të tregtuar depozita të pasiguruara njëditore dhe për shkak të rritjes së prirjes për tregtim me afat maturimi deri në 1 javë, në vitin 2022 u realizuan një numër i vogël transaksionesh (vetëm 2% e shumës totale të tregtuar), të cilat përdoren për llogaritjen e normës së interesit MKDONIA, niveli mesatar i së cilës (1,30%) ishte mesatarisht më i lartë (për 0,33 p.p.) në krahasim me vitin 2021.

Gjatë menaxhimit të likuiditetit, bankat ishin aktive edhe në tregun sekondar, ku vëllimi i letrave me vlerë të tregtuara në vitin 2022 ishte 12.726 milionë denarë dhe ishte dy herë më i lartë në krahasim me vitin e mëparshëm. Nga këndvështrimi i llojeve të transaksioneve, qarkullimi i rritur në tërësi është rezultat i transaksioneve në tregun e repove, ku qarkullimi arriti një nivel historik të lartë prej 10.199 milionë denarë. Во вкупниот промет, со околу 60% преовладуваат трансакциите за купопродажба на благајнички записи, а застапеноста на трансакциите со државни хартии од вредност е поумерена. Nga këndvështrimi dinamike, transaksionet repo ishin të pranishme vetëm në shtatë muajt e parë të vitit, ndërsa në periudhën e mbetur, në kushtet e përmirësimit të pozicionit të likuiditetit, këto lloj transaksionesh munguan në tregun e parave. Blerja dhe shitja përfundimtare e letrave me

vlërë në shumë prej 2.527 milionë denarë u realizua edhe në tregun sekondar, për 54% më pak në bazë vjetore, për të cilën kontribuoi vëllimi dyfish më i ulët i tregtimit me letra me vlerë, shtetërore, ndërmjet bankave⁵⁷. Vëllimi i transaksioneve me letrat me vlerë, shtetërore, në të cilat të paktën një pjesëmarrës është subjekt jobank, u ul për të dytin vit radhazi dhe arriti nivelin më të ulët në tetë vitet e fundit. Tregtimi i letrave me vlerë, shtetërore, në tregun e repove kontribuon në një rritje mesatare të pjesëmarrjes (rreth 0,04%) të letrave me vlerë, shtetërore, të tregtuara në tregun sekondar në shumën totale të letrave me vlerë, shtetërore, të emetuara në vend, mirëpo përfaqësimi vazhdon të jetë relativisht i ulët, duke treguar për likuiditet të dobët të mëtejme të këtyre instrumenteve në tregjet vendore financiare.

Grafiku 75

Qarkullimi i tregut sekondar të letrave me vlerë



Burimi: BPRMV.

Grafiku 76

Struktura e transaksioneve përfundimtare të letrave me vlerë, shtetërore⁵⁸



⁵⁶ Analiza e tregut të parave në Maqedoninë e Veriut ka të bëjë me këto segmente: tregun e depozitave të pasiguruara, tregun sekondar të letrave me vlerë afatshkurtra dhe letrave me vlerë afatgjata të qeverisë (me përjashtim të obligacioneve strukturore), tregun e depozitave të siguruara (tregu i repove).

⁵⁷ Në vitin 2022 është lidhur vetëm një transaksion për shitjen përfundimtare të bonove të thesarit në vlerë prej 950 milionë denarë.

⁵⁸ Koeficienti i likuiditetit të LVSh-ve paraqet raportin ndërmjet qarkullimit të realizuar nga transaksionet me LVSh-të në tregun sekondar gjatë vitit dhe bilancit mesatar të LVSh-ve të emetuara gjatë të njëjtës periudhë.

VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Rritja vjetore e rezervave valutore

Siguria dhe likuiditeti i rezervave valutore

Menaxhimi aktiv i rezervave valutore

Në vitin 2022, rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: rezervat valutore) u mbajtën në zonën e sigurt, e cila mundësoi plotësimin e pandërprerë të kërkesës në tregun e brendshëm valutor dhe ruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit në raport me euron. Konflikti ushtarak në Ukrainë që nga fundi i shkurtit të vitit 2022 ka ndryshuar ndjeshëm kushtet ekonomike globale, duke kontribuar në rritjen e çmimeve të ushqimit dhe energjisë. Trysnitë inflacioniste globale e imponuan nevojën për fillimin e ciklit të shtrëngimit të politikës monetare të bankave më të mëdha qendrore, dhe në përputhje me rrethanat e përshtatjes së strategjisë së investimeve të Bankës Popullore. Sfidat e lidhura me rritjen e inflacionit dhe krizën energjetike ishin të pranishme edhe në ekonominë vendase, duke u shfaqur me ndikim të ndjeshëm në tregtinë e jashtme dhe për rrjedhojë me rritje të fortë të kërkesës për valutë nga kompanitë vendase. Në rrethana të tilla, mbajtja në nivel të lartë e rezervave valutore, në pajtim me të gjitha standardet ndërkombëtare, ka kontribuar që Banka Popullore t'i përgjigjet në mënyrë adekuate nevojave për likuiditet dhe të sigurojë mbrojtjen e kursit të denarit. Si rezultat i kësaj, menaxhimi i rezervave valutore në vitin 2022 u dallua për kujdesin e jashtëzakonshëm dhe përshtatjen e vendimeve të investimit me zhvillimet në ndryshim të tregut vendas valutor dhe tregjeve financiare ndërkombëtare, gjë që mundësoi realizimin e mëtejshëm të parimeve bazë: besueshmërinë dhe likuiditetin e rezervave valutore.

6.1. Gjendja dhe ndryshimet e rezervave valutore


Në vitin 2022, rezervat valutore u rritën me 219,6 milionë euro dhe arritën në 3,863 milionë euro në fund të vitit. Në rritjen e rezervave valutore kanë kontribuar hyrjet neto të shtetit nga transaksionet me jashtë në vlerë prej 99,8 milionë euro⁵⁹, si dhe rezerva e detyrueshme e alokuar më e lartë në euro dhe aktivet e bankave vendase në llogaritë MIPS-EUR (99,3 milionë euro). Kontribut më të vogël në ndryshimin e rezervave valutore ka pasur rritja e vlerës së dollarit amerikan⁶⁰, në kushtet e prirjes së investitorëve për të investuar në instrumente të sigurta mes shqetësimeve të rritura të recesionit dhe pritjeve për shtrëngim të ndjeshëm të politikës monetare të FED-it. Rritja e rezervave valutore ka ardhur kryesisht nga flukset hyrëse nga transaksionet e repove klasike (227.8 milionë euro), të cilat përdoren për administrimin aktiv të rezervave valutore. Konkretisht, krahas huadhënies së rregullt të letrave me vlerë përmes transaksioneve të njëkohshme të repove klasike dhe të anasjellta në të njëjtën shumë, në fund të tremujorit të tretë janë realizuar edhe transaksione shtesë të repove klasike, të nxitura nga kërkesa e lartë për letra me vlerë të cilësisë së lartë si pjesë e rezervave valutore, të cilat kontribuan në rritjen e mjeteve monetare në rezervat valutore. Në drejtim të

⁵⁹ Në fund të shtatorit dhe në muajin nëntor, shteti ka marrë hua në vlerën 246 milionë euro përmes letrave me vlerë të regjistruara (NSV) dhe 107 milionë euro nga kredia nga FMN-ja.

⁶⁰ Dollari amerikan u mbivlerësua në kundërvlerë me euron për 6%, gjë që kontribuoi në rritjen e vlerës së arit në rezervat valutore me 5,9%, pavarësisht rënies vjetore të çmimit të shprehur në dollarë amerikanë nga 0,4%.


kundërt kanë ndikuar shitjet neto të tregut valutor të Bankës Popullore, në kushtet e rritjes së kërkesës për valutë të prira nga kompanitë e sektorit të energjisë, si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë në tregjet botërore. Gjegjësisht, pasiguria që rezultoi nga shpërthimi i konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet kundër Rusisë përkeqësuan më tej zinxhirët globalë të furnizimit dhe tregjet e mallrave tashmë të ndërprera dhe thelluan krizën globale energjetike. Rrethanat e tilla rritën trysnitë e çmimeve dhe u reflektuan në lëvizjet e tregut vendas të këmbimit valutor, të cilat çuan në ndërhyrje në drejtim të shitjeve neto prej 158,2 milionë euro.

Grafiku 77
Faktorët e ndryshimit të rezervave valutore
në milionë euro



Burimi: BPRMV.

Grafiku 78
Portofoli i rezervave valutore
niveli mesatar, në milionë euro



Edhe në vitin 2022, rezervat valutore u shpërndanë në tre portofole (portofoli operativ, i likuiditetit dhe investimit), vëllimi i të cilave u rregullua në mënyrë aktive në pajtim me nevojat afatshkurtra për mjete likuide valutore të tregut të brendshëm valutor dhe të ardhshëm dhe shlyerjet e borxhit të jashtëm publik. Me përjashtim të nevojave afatshkurtra për likuiditet, mjetet në portofolin operativ janë ruajtur në nivel relativisht më të lartë në pritje të kushteve më të favorshme për investime, gjatë normalizimit të politikës monetare të bankave qendrore më me ndikim. Në strukturën e rezervave valutore, nëpërmjet portofolit të veçantë, edhe më tej menaxhohej edhe me arin, siguria dhe likuiditeti i të cilit është veçanërisht i theksuar në kushtet e ndryshimit të lëvizjeve në tregjet financiare.

6.2. Kushtet e tregjeve financiare ndërkombëtare dhe qasja aktive e investimit të rezervave valutore

Rritja e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë, si rezultat i luftës në Ukrainë dhe rritjes globale të çmimeve në sektorin e shërbimeve, kontribuoi në inflacionin më të lartë në dyzet vitet e fundit në mbarë botën, me rritjen e tij në vitin 2022 duke tejkaluar pritshmëritë në shumicën e ekonomive. Pas vëzhgimeve fillestare për natyrën "e përkohshme" të rritjes së çmimeve, bankat qendrore më të mëdha u përballën me vazhdimin e tendencës rritëse të inflacionit, i cili kushtëzoi rritje të normave të referencës së interesit në disa raste dhe në vëllim relativisht të madh. Në të njëjtën kohë, Banka Qendrore e Shteteve të Bashkuara, FED-i, rriti normën e interesit referencë për gjithësej 425 pikë bazë në vitin 2022⁶¹. Në Europë, inflacioni paraqiste kërcënim edhe më të madh për shkak të mungesës së energjisë dhe çmimeve të larta të energjisë, kryesisht gazit natyror, kështu që edhe Banka Qendrore Europiane filloi të shtrëngonte politikën monetare në gjysmën e dytë të vitit. Norma e interesit referencë e operacioneve të rifinancimit (angl. main refinancing operations, MRO) e rriti katër

⁶¹ Interesi i synuar i FED-it në fund të vitit 2021 ishte 0% - 0,25%, dhe në fund të vitit 2022, 4,25 – 4,5%.

herë, nga 0% në fund të 2021 në 2,5% në fund të 2022, por duke mbetur pjesërisht fleksibël në drejtimin e politikës monetare në kushtet e pasigurisë së lartë në lidhje me rrugën e ardhshme të inflacionit. Ky shtrëngim më intensiv i politikës monetare nxiti pritjet e investitorëve në trajektoren rritëse të normave të interesit dhe shkaktoi pasiguri shtesë dhe rritje të ndryshueshmërisë në tregjet financiare ndërkombëtare.

Rritja intensive e normave të interesit dhe qëndrimet kufizuese të autoriteteve monetare në lidhje me vendosmërinë për shtrëngim të mëtejshëm të ndjeshëm të politikës monetare, ndikuan në rritjen e normës së kthimit të instrumenteve me normë të kthimit fiks dhe për rrjedhojë në uljen e vlerës së tyre në treg. Rritja e normave të kthimit të obligacioneve më të sigurta në Eurozonë i kaloi 300 pikë bazë me bazë vjetore. Në kushtet e luhatshmërisë së lartë të tregut dhe rritjes së pritur të mëtejshme të normave të kthimit dhe për shkak të qasjes më të kujdesshme ndaj investimit, në tremujorin e tretë të vitit Banka Popullore uli kohëzgjatjen e korrigjuar të portofolit tregtar me qëllim të ndërmarrjes së rrezikut të normës më të ulët të interesit. Nëpërmjet kësaj qasjeje më të kujdesshme ndaj investimit, sigurohet mbrojtja e portofoleve nga rritja e mundshme e normave të kthimit, potenciali më i madh i likuiditetit, si dhe mundësia e investimit me norma të kthimit më të larta në të ardhmen.

Sfidat e lidhura me trysnitë inflacioniste dhe krizën energjetike ishin të pranishme edhe në ekonominë vendase, e cila në gjysmën e parë të vitit shkaktoi një nevojë të shtuar për valutë në tregun e brendshëm valutë nga sektori i korporatave. Në rrethana të tilla, Banka Popullore e siguroi stabilitetin e kursit të denarit përmes intervenimeve për shitjen e valutës në bankat vendase. Rrethanat e tilla imponuan nevojën e mbajtjes së një niveli të lartë të mjeteve në llogaritë pranë bankave qendrore, gjë që njëkohësisht mundësoi mbrojtjen nga rritja e mëtejshme e normave të kthimit. Rritja e normave të kthimit në vitin 2022 (të cilat ishin pozitive për herë të parë që nga viti 2014) shkaktoi një ulje të përkohshme të vlerës së tregut të letrave me vlerë fikse, por nga ana tjetër, ndikoi pozitivisht në investimet e reja në instrumente financiare dhe rrjedhimisht mbi rezultatet e pritura financiare në vitet në vijim. Ndryshueshmëria në normat e kthimit dhe valutave gjatë vitit të kaluar ka rezultuar në rreze më të larta të tregut, duke kufizuar mundësitë për investime afatgjata. Në rrethana të tilla dhe për të siguruar të ardhura të parashikueshme dhe relativisht të larta, gjatë vitit investimet e reja janë drejtuar kryesisht në portofolin e investimeve deri në maturim⁶². Gjithashtu, rritje të moderuar kanë pësuar edhe investimet në obligacione të "qëndrueshme", gjë që ka rritur pjesëmarrjen e tyre në rezervat valutore. Investimet e tilla janë në pajtim me përcaktimin e Bankës Popullore për investim të përgjegjshëm në instrumente financiare që mbështesin projekte me ndikim pozitiv në mjedis dhe për t'u përballur me pasojat e ndryshimeve klimatike.

Të ardhura shtesë u realizuan edhe nëpërmjet administrimit aktiv të rezervave valutore, me huamarrje afatshkurtër të obligacioneve në tregun e repo-transaksioneve, duke vendosur njëkohësisht mjetet e marra në instrumente afatshkurtra me rendiment më të lartë në tregun e parasë, duke dhënë hua të letrave me vlerë në bazën e siguruar dhe përmbyllëse transaksione repo dhe repo të anasjellta, transaksione të ardhshme (swap) të arit, si dhe transaksione me kontrata të së ardhmes në varësi të ndryshimeve në çmimet e letrave me vlerë.


⁶² Letrat me vlerë të klasifikuara në instrumente financiare që maten me shpenzim të amortizuar.

6.3. Struktura e rezervave valutore

Në vitin 2022, në strukturën valutore të rezervave valutore, më të përfaqësuara ishin fondet e investuara në instrumente financiare në euro, me pjesëmarrje mesatare prej përafërsisht 96%⁶⁴, e cila është në pajtim me strategjinë monetare për kurs të qëndrueshëm të këmbimit të denarit ndaj euros. Pjesa tjetër e rezervave valutore përbëhej nga jeni japonez nga transaksione të siguruara, si dhe instrumente në dollarë amerikanë.

Grafiku 79

Struktura valutore⁶³ dhe ekspozimi ndaj rezervave valutore (mesatarja vjetore)




Burimi: BPRMV.

Qasja e kujdesshme dhe aktive e menaxhimit të rezervave valutore, e cila përfshinte shënjestrimin e instrumenteve më të sigurta financiare për të përmbushur parimin e sigurisë së rezervave valutore, kontribuoi në ruajtjen e mesatares së pjesëmarrjes së instrumenteve të emetuara nga emetuesit/vendet me **rezultatet më të larta të vlerësimit kreditor** (nga "AAA" deri në "AA-") në përafërsisht 70%. Këto instrumente kanë ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut të kredisë dhe konsiderohen si investimet më të sigurta. Për të arritur kthim më të lartë të investimeve dhe për të ruajtur vlerën e rezervave valutore, pjesë e investimeve (ose mesatarisht rreth 17%) janë investuar edhe në instrumente me vlerësim kreditor nga "A+" në "A-". Pjesa më e madhe e këtyre instrumenteve emetohen nga vendet anëtare të Eurozonës (9,5% e rezervave valutore) dhe letrat me vlerë me maturim më të shkurtër, të emetuara nga bankat tregtare me reputacion (7,5% e rezervave valutore).

Grafiku 80


Struktura mesatare vjetore e investimeve sipas klasifikimit kreditor



*Në kategorinë "të tjera" janë të klasifikuara FMN-ja, BIS-i
Burimi: BPRMV.

Grafiku 81

Struktura mesatare vjetore gjeografike e investimeve



* IFN-ja dhe MRB-të – institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat shumëpalëshe të zhvillimit

Në vitin 2022, Banka Popullore udhëheqi pjesë të vogël të investimeve brenda portofoleve në euro dhe në instrumente që kanë vlerësim mesatarisht më të ulët të kredisë së investimeve, por që janë emtuar ose janë të garantuara pa kushte nga vendet anëtare të


⁶³ Struktura bazë valutore e rezervave valutore është në pajtim me strukturën valutore të ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor, detyrimet e shtetit jashtë vendit, këmbimin tregtar të jashtëm të shtetit dhe nevojat e tjera për likuiditet. Struktura taktike e monedhës përcaktohet në bazë të rishikimit periodik të alokimit strategjik të rezervave valutore, brenda devijimeve të lejuara nga struktura bazë valutore.

⁶⁴ Struktura valutore analizohet në terma të gjendjes së rezervave valutore të reduktuara me sasinë e arit.

eurozonës. Kjo shpërndarje është reflektuar në pajtim me rrethanat në **strukturën gjeografike** të vendosjeve të rezervave valutore. Kështu, në vitin 2022 shumica e investimeve ishin në instrumente të emetuara nga ekonomitë kryesore të eurozonës (mesatarisht 44%)⁶⁵, por edhe për vendet e tjera të eurozonës dhe Bashkimit Europian (23,4%)⁶⁶, të cilat shfrytëzojnë mbështetjen e ekonomisë së përbashkët dhe në të njëjtën kohë ofrojnë norma të kthimit mesatarisht më të larta.

Nga aspekti i **llojet e instrumenteve në të cilat janë investuar rezervat valutore**, dhe shumica e fondeve ishin ende të investuara në letra me vlerë (69,9%). Ndër llojet e letrave me vlerë, mbizotëronin letrat me vlerë shtetërore dhe letrat me vlerë të emetuara me garanci shtetërore, të cilat kanë karakterin e investimeve më të sigurta. Normat pozitive të interesit në gjysmën e dytë të vitit 2022 rritën atraktivitetin e vendosjeve në depozita pranë bankave qendrore dhe tregtare. Gjegjësisht, plasmanet afatshkurtra në bankat komerciale u përfaqësuan në vëllim mesatarisht më të lartë se mesatarja e vitit 2021. Pjesëmarrje më të madhe kishin edhe mjetet në llogaritë rrjedhëse pranë bankave qendrore (mesatarisht rreth 15,7%), për të siguruar likuiditet të rezervave valutore, por edhe në pritje të kushteve më të favorshme për investime, në përputhje me parashikimet për rritjen e mëtejshme të normave të kthimit.

Grafiku 82
Struktura e investimeve sipas instrumenteve mesatare në vit



Burimi: BPRMV.

Grafiku 83
Struktura sipas llojit të letrave me vlerë mesatare në vit



Në strukturën e rezervave valutore, pjesëmarrja mesatare e **arit** u rrit nga 9,1% në vitin 2021, në 11,1% në vitin 2022, e cila, me vlerë të pandryshuar, është tërësisht rezultat i rritjes së vlerës së dollarit amerikan⁶⁷, e që kontribuoi në rritjen e vlerës së arit në rezervat valutore.

6.4. Rezultatet e menaxhimit dhe të investimit të rezervave valutore

Për të optimizuar menaxhimin e rezervave valutore, duke marrë parasysh detyrimet dhe qëllimet e ndryshme të rezervave valutore në periudha të ndryshme kohore, mjetet e alokuara në portofolin operacional dhe të likuiditetit shërbejnë për të siguruar mjetet likuide valutore të disponueshme në kohë, ndërkoh që portofoli i investimeve synon rritjen e kthimit nga rezervat valutore dhe përmbushjen e detyrimeve të paparashikuara në afat më të gjatë.

⁶⁵I referohen të a.q. "bërthama të eurozonës", e cila përfshin: Gjermaninë, Austrinë, Luksemburgun, Finlandën, Holandën, Francën dhe Belgjikën.

⁶⁶"Vendet e tjera të Eurozonës dhe BE-së" përfshijnë: Irlandën, Italinë, Portugalinë, Spanjën, Danimarkën, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Rumaninë, Sllovakinë, Slloveninë, Kroacinë, Republikën Çeke dhe Suedinë.


⁶⁷Vlera e dollarit amerikan ka shënuar rritje gjatë vitit 2022 mes prirjes së investitorëve për të investuar në instrumente të sigurta, mes shqetësimeve në rritje të recesionit dhe pritjeve për një shtrëngim të konsiderueshëm të politikës së FED-it.

Për rrjedhojë, krahas fondeve të mbajtura në llogaritë rrjedhëse pranë bankave qendrore, rezervat valutore investohen edhe në instrumente me normë fikse të kthimit, të cilat mund të tregtohen edhe në kushte të favorshme tregu, duke mundësuar realizimin e fitimit nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumentet. Rezultatet financiare në vitin 2022 u përcaktuan më së shumti pikërisht nga rritja e ndjeshme e normave të kthimit të instrumenteve me të ardhura fikse, të cilat kontribuan në ulje të përkohshme të vlerës së tyre në treg. Megjithatë, pritjet që efekti i pafavorshëm i rritjes së normave të kthimit, i cili u reflektua në rezultatin për vitin 2022, të kompensohet plotësisht nëpërmjet arritjeve më të mira bazuar në investimet e duhura në periudhën e ardhshme. Në të njëjtën kohë, efekti i kthimeve u kompensua pjesërisht nga rezultatet e favorshme nga menaxhimi aktiv i portofolit të rezervave valutore, ku **norma totale e kthimit nga investimi dhe menaxhimi i rezervave valutore⁶⁸ ishte -0,21%.**

Menaxhimi aktiv i rezervave valutore, respektivisht investimi në instrumente me rendiment më të lartë, zgjedhja e momentit të përshtatshëm për të hyrë në investim dhe mënyra e strukturimit të portofolit kontribuan në arritje më të mira dhe tejkalim të rezultateve në raport me portfolet përkatëse të referencës⁶⁹.

E analizuar sipas portofolit, portofoli operativ në euro ka kontribut pozitiv në të ardhurat nga investimi i rezervave valutore, duke pasur parasysh normat pozitive të interesit⁷⁰ të cilat nga tremujori i tretë i vitit 2022 zbatohen për mjetet në euro në llogaritë rrjedhëse me bankat qendrore. Portofoli i investimeve në euro, i cili përfshin pjesën më të madhe të rezervave valutore dhe përfshin instrumente me maturim më të gjatë (megjithë instrumentet më të sigurta, përmbajnë gjithashtu investime në instrumente që ofrojnë preminë e rrezikut kreditor) dhe portofolin e likuiditetit në euro⁷¹, e cila është me kohëzgjatje më të shkurtër, nën ndikimin e rritjes së normave të kthimit në eurozonë, respektivisht uljen e përkohshme të vlerës së tyre në treg, pati norma negative të kthimit.

Grafiku 84
Normat e kthimit sipas portfoleve në vitin 2022



⁶⁸ Norma e kthimit nga rezervat valutore mbulon kthimin nga investimi dhe menaxhimin e rezervave valutore, duke përfshirë ndryshimet e llogaritura të çmimeve të letrave me vlerë, ndryshimet e realizuara të kursit të këmbimit nga arbitrazhet valutore dhe operacionet në ar dhe instrumente derivative.

⁶⁹ Portofoli i investimeve në euro menaxhohet në lidhje me portofol referencë, i përfaqësuar nga kombinimi i indekseve referencë të mëposhtëm të publikuar nga "Intercontinental Exchange® (ICE): EG6BB (EG6 W) i përbërë nga letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës me vlerësime kreditore të paktën "AA" dhe me afat të mbetur deri në maturim nga zero deri në një vit; EG61 i përbërë nga letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës me vlerësime kreditore të paktën "AA" dhe me afat të mbetur deri në maturim nga një deri në tre vjet; dhe EG62 i përbërë nga letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës me vlerësime kreditore të paktën "AA" dhe me afat të mbetur deri në maturim prej tre deri në pesë vjet. Kohëzgjatja e rregulluar e portofolit të referencës korrespondon me kohëzgjatjen e rregulluar të portofolit të investimeve.

Portofoli i likuiditetit në euro menaxhohet në lidhje me portofol referencë, i përfaqësuar nga kombinimi i indekseve referuese të mëposhtme të publikuara nga "Intercontinental Exchange® (ICE): EG6BB (EG6W) i përbërë nga letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës, me vlerësimet e kreditit të paktën "AA" me afat të mbetur deri në maturim prej zero deri në një vit; EG61 që përbëhet nga letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës me vlerësime kreditore të paktën "AA" me afat të mbetur deri në maturim nga një deri në tre vjet; dhe EG62 që përbëhet nga letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës me vlerësime kreditore të paktën "AA" dhe me afat të mbetur deri në maturim prej tre deri në pesë vjet. Kohëzgjatja e rregulluar e portofolit të referencës korrespondon me kohëzgjatjen e rregulluar të portofolit të likuiditetit.

⁷⁰ Për herë të parë që nga viti 2014, normat e interesit në eurozonë u kthyen pozitive në tremujorin e tretë të 2022, kur BQE-ja ngriti normën bazë të interesit për operacionet e rifinancimit.


⁷¹ Synohet të përmbushë të gjitha daljet kontraktuale dhe të mundshme gjatë një viti.

Portofoli likuid i dollarit amerikan pati kthim pozitiv, për shkak të kthimeve pozitive të ShBA-së për instrumentet më të sigurta me afat të shkurtër.

Një pjesë e investimeve të rezervave valutore brenda portofolit të investimeve synojnë edhe letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Këto letra me vlerë, të cilat janë vetëm për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale, përbëjnë portofol të veçantë brenda portofolit të investimeve dhe vlerësimi i rezultateve të menaxhimit të tyre tregohet në vlerë absolute, respektivisht nuk rivlerësohen me çmimet e tregut. Për rrjedhojë, këto letra me vlerë kanë kthim të parashikueshëm, pozitiv dhe të qëndrueshëm në nivelin e normave të kthimit kur blihen dhe në të njëjtën kohë ulin ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit. Në kushtet e ndryshimit të lëvizjeve në tregjet financiare dhe për të siguruar të ardhura të parashikueshme dhe relativisht të larta në terma afatgjatë, niveli i portofolit deri në maturim në euro gjatë vitit 2022 është rritur. Ky portofol ka arritur norma pozitive kthimi prej 0,44%, duke qenë se përbëhet nga obligacione qeveritare të emetuara nga vendet anëtare të eurozonës që kanë normë pozitive të kthimit deri në maturim.


Grafiku 85

Vlera mesatare e portofolit deri në maturim në euro (në milionë euro)



Burimi: BPRMV.

Kthimi i portofolit në maturim në euro (në përgjindje)



VII. Shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave

Ligji i ri i Shërbimeve të Pagesave dhe Sistemeve të Pagesave

26 akte nënligjore

Rritje e pagesave digjitale

Funksionimi pa probleme i sistemit pagesor në vend, i cili përbëhet nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, infrastruktura e pagesave, përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe kuadri ligjor për ekzekutimin e tyre, është një nga detyrat themelore ligjore të Bankës Popullore. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore ka rol kryesor operacional, rregullues dhe mbikëqyrës në themelimin dhe funksionimin e sistemeve të pagesave, i cili mundëson ekzekutim të sigurt dhe efikas të pagesave⁷². Gjithashtu, Banka Popullore është katalizatore për ndryshimet në sistemet e pagesave dhe inkurajon proceset për integrimin e inovacioneve në sistemin ekzistues të pagesave dhe për krijimin e kushteve për zhvillimin e zgjidhjeve të reja inovative për ekzekutimin e pagesave, të udhëhequra nga përvoja botërore, veçanërisht nga përvoja dhe praktikrat në vendet e BE-së. Në këtë proces, me interes të veçantë është harmonizimi i rregulloreve dhe praktikave kombëtare dhe europiane, të cilat përveç përfitimeve nga rritja e besueshmërisë dhe efikasitetit të pagesave në vend, ofrojnë kushte për bashkim më të lehtë të shtetit në tregun më të gjerë europian, domethënë në Zonën e Vetme Europiane të Pagesave (SEPA).

Aktiviteti më domethënës në sferën e pagesave që shënoi vitin 2022 është miratimi i Ligjit të ri të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave (LSHPSSP)⁷³, me zbatim nga 1 janari 2023. Për zbatimin praktik të LSHPSSP-së, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të vitit 2022 miratoi 26 akte nënligjore, të cilat i shtellojnë më në hollësi dispozitat e Ligji. Kuadri i ri rregullator, i cili është i harmonizuar dukshëm me legjislacionin europian në sferën e pagesave, mundëson hyrjen e konkurrencës dhe inovacionit në treg, siguron mbrojtje më të madhe të konsumatorëve dhe kushte për përfshirje më të madhe financiare të popullsisë.

Një nga përfitimet më domethënëse të miratimit të LSHPSSP-së është hapja e tregut për ofruesit e rinj të shërbimeve dhe zgjerimi i grupit të shërbimeve të pagesave që do të ofrohen në treg. Pra, përveç bankave, shërbime të pagesave do të mund të ofrojnë edhekursimoreve, si ofrues të rinj të shërbimeve të pagesave do të quhen institucionet e specializuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose emetimin e parave elektronike, përmes të cilave do të kryheshin edhe pagesat. Mjedisi i ri konkurrues do të motivonte ofruesit ekzistues dhe të rinj të shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave për t'u ofruar klientëve zgjidhje inovative për kryerjen e pagesave më të shpejta, më të përshtatshme dhe më të lira. Në këtë kontekst, është planifikuar që më së voni deri në tremujorin e parë të vitit 2024 të prezantohet koncepti i "bankingut të hapur", i cili rregullon në radhë të parë mënyrën se si bankat do të detyrohen të hapin sistemet e tyre të

⁷² Banka Popullore është pronare dhe operatore e Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë (MIPS) si i vetmi sistem në vend për pagesat e mëdha dhe urgjente në denarë ndërmjet pjesëmarrësve të saj, përmes të cilit bëhet shlyerja e transaksioneve të pagesave lidhur me zbatimin e politikës monetare, realizohet shlyerja përfundimtare e sistemeve të tjera të pagesave dhe sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe në transaksione të pagesave për shtetin, autoritetet shtetërore dhe pjesëmarrësit e tjerë në sistem.

⁷³ Ligji i Shërbimeve të Pagesave dhe i Sistemeve të Pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22).

informacionit ndaj ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave, por edhe detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për të garantuar sigurinë e pagesave duke mundësuar autentifikimin e zgjeruar (konfirmimin e identitetit të paguesit, d.m.th. përdorimin e vlefshëm të instrumentit të pagesës prej tij) kur nisin transaksionet e pagesave elektronike. Pritet që "bankimi i hapur" të inkurajojë konkurrencën, inovacionin dhe shfaqjen e modeleve të reja të biznesit. Prandaj, pritet që të hapen mundësitë për përdorimin e zgjidhjeve inovative aplikative në sferën e pagesave, me përdorimin e të cilave qytetarët dhe kompanitë do të kenë mundësi të qasin llogaritë e tyre të pagesave në banka për të inicuar pagesat elektronike në një mënyrë më të lehtë ose për të marrë të dhëna për transaksionet e kryera.

Kuadri i ri rregullator rregullon qartë detyrimet e ofruesve të shërbimeve të pagesave në segmentin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve që rrjedhin nga përdorimi i shërbimeve të pagesave. Kështu, për herë të parë vendoset detyrim për ofruesin e shërbimit pagesor që të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve me marrëveshje kuadër në formë të standardizuar, e cila duhet të përmbajë grup informacioni të detyrueshëm, si dhe mundësitë dhe kushtet sipas të cilat mund të modifikohen ose ndërpriten. Këto dispozita arrijnë transparencë më të madhe të ofruesve të shërbimeve dhe sigurojnë informacion më të mirë, siguri ligjore dhe trajtim të barabartë të konsumatorëve midis ofruesve të shërbimeve të pagesave.

Risi veçanërisht domethënëse për konsumatorët do të jetë krahasimi më i lehtë i tarifave të ofruesve të shërbimeve të pagesave për shërbimet që lidhen me llogarinë e pagesave që ata ngarkojnë prej tyre. Për këtë qëllim, Banka Popullore ka përcaktuar listën e 11 shërbimeve më përfaqësuese që lidhen me llogari pagese që konsumatorët i përdorin më shpesh dhe për të cilat ofruesit e shërbimeve të pagesave do t'i dorëzojnë të dhënat në Bankën Popullore. Tarifat për këto shërbime do të publikohen në faqen e internetit të Bankës Popullore. Duke vepruar kështu, konsumatorët do të jenë në gjendje të krahasojnë lehtësisht tarifat për shërbimet e ofruara nga ofrues të ndryshëm të shërbimeve të pagesave. Në këtë mënyrë pritet që të rritet ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe të lehtësohet vendimmarrja e tyre për përdorimin e shërbimeve të pagesave nga një ofrues specifik i shërbimit të pagesës.

7.1. Transaksionet e pagesave të kryera me instrumente pagesash pa para të gatshme

Numri total i pagesave⁷⁴ në vend në vitin 2022 ishte 195 milionë transaksione dhe shënoi rritje vjetore prej 6,8%, ndërsa vlera e pagesave u zvogëlua për 3,1%, e cila arriti në 5,808 miliardë denarë.

Ndryshimet në zakonet e qytetarëve dhe kompanive, më saktë përdorimi më i shpeshtë i përfitimeve të digjitalizimit të tregut të shërbimeve të pagesave, të forcuara më tej pas shfaqjes së krizës së koronës, janë ende të dukshme përmes rritjes së përdorimit të kartelave të pagesave dhe kanalet digjitale për kryerjen e pagesave. Kështu, në vitin 2022, një rritje vjetore prej 13,1% është shënuar në numrin e transaksioneve me kartela pagese të lëshuara në vend që janë kryer në pikat e shitjes fizike dhe virtuale (internet) në vend, gjë që ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së tyre nga 3, 6 p.p. në totalin e pagesave dhe arriti në 65%. Njëkohësisht, vërehet rënie e numrit total të transfertave të kredisë prej 2,9%, ndërkohë që transfertat e kredive të iniciuara në mënyrë elektronike shënuan një rritje të moderuar


⁷⁴ Pagesat i referohen transaksioneve të personave juridikë dhe fizikë (duke përjashtuar sektorin e institucioneve financiare monetare - IMF). Institucionet financiare jomonetare (jo-IMF) janë çdo person fizik ose juridik që nuk i përket sektorit të IMF-ve. Për qëllime të statistikave pagesore, ofruesit e shërbimeve pagesore nuk përfshihen në sektorin jo-IMF. Instrumentet pagesore që përdoren për realizimin e pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë transfertat e kreditit dhe kartelat pagesore, ndërsa çeqet ishin në përdorim deri në vitin 2007 dhe debitimet direkte ende nuk përdoren si instrument pagesor.

vjetore prej 0,6%, por rënie të peshës së tyre me 1,2 p.p. në totalin e pagesave (18%), ndërkohë që transfertat e kredive të iniciuara në letër pësuan një rënie vjetore prej 6,4%, e cila kontribuoi në ulje prej 2,4 p.p. të pjesëmarrjes së tyre në numrin total të pagesave (17%).

Në vlerën e përgjithshme të pagesave, vazhdojnë të mbizotërojnë transfertat e kredisë me 97,3%, me rritje të pjesëmarrjes strukturore me 5,3 p.p. (pjesëmarrja prej 67.2%) e transfertave të kredisë të iniciuara në mënyrë elektronike në llogari të reduktimit të transfertave të kreditit të iniciuara në letër me 5.5 p.p. (ose pjesëmarrje prej 30,1%), dhe pesha strukturore e vlerës së pagesave me kartela pagese është rritur gjithashtu me 0,2 p.p. (2,7%), në vlerën totale të realizuar me instrumente pagesash pa para të gatshme.

Grafiku 86

Pjesëmarrja strukturore e instrumenteve të pagesave pa para të gatshme në vlerën totale dhe numrin total të pagesave
Burimi: BPRMV



Burimi: BPRMV.

7.1.1. Transfertat e kredisë të iniciuara nga persona fizikë dhe juridikë

Numri total i pagesave të kryera me transfertat e kreditit të iniciuara nga persona fizikë dhe juridikë në vend në vitin 2022 arriti në 65,4 milionë transaksione dhe shënoi rënie vjetore prej 2,9%.

Tabela 4

Transfertat e kredisë si instrument pagese pa para për personat fizikë dhe juridikë

2022		
Numri i transfertave të kredisë të iniciuara nga jo-IMF-të (pjesëmarrja strukturore)	Persona fizik (%)	Persona juridik (%)
Sipas mënyrës së inicimit		
Letre	73,5	35,5
Elektronike	26,5	64,5
Sipas pajisjes në të cilën janë inicuar transfertat elektronike të kreditit		
Llogaritësi personal	40,0	97,8
Celular	54,2	2,2
Bankomat	0,6	/
	0,2	/

Në strukturën e transfertave të kredisë nga pikëpamja e përfituesit, ende mbizotërojnë personat juridikë me 65,8%, ndërsa pjesa tjetër prej 34,2% janë iniciuar nga personat fizikë (përkatësisht 67,4% dhe 32,6% në vitin 2021). Në të njëjtën kohë, vihet re se personat juridikë i kanë shfrytëzuar gjithnjë e më shpesh përfitimet e

bankingut elektronik (64,5% pjesëmarrje në totalin e transfertave të kredive të iniciuara nga

personat juridikë), ndërsa te personat fizikë ende mbizotëron iniciimi i pagesave në sportelet bankare (73, 5%).

Për herë të parë gjatë vitit 2022 vihet re përdorimi më i madh i aplikacioneve celulare, që konfirmon faktin se qytetarët përdorin ndjeshëm privilegjet dhe komoditetin e përdorimit të kësaj pajisjeje për të kryer pagesat. Konkretisht, qytetarët përdorën aplikacionet celulare për iniciimin e transfertave elektronike të kredive me pjesëmarrje prej 54,2% ose rritje prej 4,7 p.p., krahasuar me vitin 2021, në llogari të rënies prej 4,7 p.p. ose pjesëmarrje prej 45% e njehsorëve personalë dhe rënie prej 0,2 p.p. të pjesëmarrjes së bankomatëve.

Te personat juridikë, mbizotëron përdorimi i makinës llogaritëse personale (97,8%), por vërehet rritje e lehtë e pjesëmarrjes strukturore të përdorimit të aplikacioneve celulare të bankingut me 0,4 p.p. krahasuar me vitin 2021, i cili arriti në 2,2% në totalin e transfertave të kredive të iniciuara në mënyrë elektronike nga personat juridikë.

7.1.2. Kartelat e pagesave

Prirja në rritje e numrit total të transaksioneve me kartela pagese⁷⁵, të lëshuara nga emetuesit vendas, në pajisje të vendosura në vend, vazhdoi edhe në vitin 2022 dhe ka arritur në 149,6 milionë. Njëkohësisht, përdorimi i kartela pagese në pikat e shitjes fizike dhe virtuale (internet) shënoi rritje të lartë vjetore prej 13,1%. Kartelat janë përdorur edhe për tërheqjen dhe depozitimin e parave në bankomat, ku numri i këtyre transaksioneve ka shënuar rritje vjetore prej 1,1%. Rritja e pjesëmarrjes strukturore në numrin e transaksioneve në pikat fizike të shitjes vijon me 1,7 p.p. duke arritur në 72,7% në vitin 2022, nën ndikimin e rritjes vjetore prej 13,3%, për shkak të uljes së pjesëmarrjes së transaksioneve të tërheqjes së parave nga bankomati (18,3%), me rritje të parëndësishme prej 0,5%. Si rezultat i ndryshimit të zakoneve dhe kulturës së pagesave të qytetarëve dhe kompanive, përdorimi i kartela pagese në pikat e shitjes virtuale (internet) vendase shënoi rritje vjetore prej 11,6%, megjithëse pjesëmarrja e tyre mbetet e qëndrueshme dhe është ende në nivel relativisht të ulët (pjesëmarrja prej 8,3%). Numri i transaksioneve për depozitimin e parave të gatshme nga bankomatet, shënoi rritje të lartë vjetore prej 22%, por pjesëmarrja e tyre në totalin e transaksioneve me kartela pageseore është ende e ulët (0,7%).

Edhe në vitin 2022 do të ketë rritje të numrit të transaksioneve në vend me kartela pagese nga emetuesit e huaj. Kështu, në терминаlet e vendosura në vend janë realizuar 12,5 milionë transaksione me kartela pagese të lëshuara nga emetues të huaj, me rritje vjetore të ndjeshme prej 48,5%. Analizuar nga aspekti i përdorimit të tyre, edhe gjatë vitit 2022 ato përdoren gjithnjë e më shumë për pagesa në pikat fizike të shitjes, të cilat me rritje vjetore prej 57,3%, çuan në rritje të pjesëmarrjes së tyre prej 4,6 p.p. e cila arriti në 81,9%. Me rritje vjetore më të ulët prej 14,6%, pjesëmarrja e kartelave për tërheqje të parave të gatshme nga bankomatet u ul me 3,9 p.p. dhe u ul në 13,2%, ndërsa pjesëmarrja e përdorimit të kartela pagese në pikat e shitjes virtuale u ul me 0,7 p.p. dhe arriti në 4,9%, me rritje vjetore prej 31,2%.


Rritje e ndjeshme vjetore prej 31,8% në vitin 2022 është vërejtur në përdorimin e kartela pagese të lëshuara nga emetuesit vendas në pajisje të vendosura jashtë vendit, me 12,1 milionë transaksione. Në të njëjtën kohë, u vu re rritje e përdorimit të kartela pagese në терминаlet në pikat fizike të shitjes me rritje vjetore prej 37,8%, gjë që çoi në rritje të pjesëmarrjes strukturore të tyre për 2,9 p.p. i cili arriti në 68,1% dhe rriti përdorimin e

⁷⁵ Transaksionet me karta pagese të emetuara në vend përfshijnë transaksionet në pikat fizike të shitjes, pikat e shitjes virtuale (internet) dhe tërheqjet e parave dhe depozitat në bankomatet në vend.

kartaelave të pagesave në pikat virtuale (internet) të shitjeve të subjekteve të huaja nga 21,1% në vit, ndërkohë që pjesëmarrja e tyre strukturore ra në 30,4%, respektivisht me 2,6 p.p. Tërheqjet e parave me kartela vendore në bankomatë jashtë vendit janë ende të ulëta dhe të qëndrueshme (pjesëmarrja strukturore prej 1,5%, me rënie të parëndësishme vjetore prej 0,3 p.p.).

Grafiku 87

Pjesëmarrja në numrin total të transaksioneve me kartela pagese



7.2. Infrastruktura e pagesave

Infrastruktura e pagesave elektronike në vend po zgjerohet edhe në vitin 2022, si rezultat i zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë pa kontakt, e cila po merr gjithnjë e më shumë vull në fushën e pagesave me kartela pagese. Gjegjësisht, në fund të vitit 2022, nga 2,1 milionë kartela të lëshuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 69,7% e kartelave janë gjithashtu të bazuara në teknologjinë pa kontakt (1,4 milionë kartela), ndërsa 86,3%, respektivisht 27.771 nga gjithësej 30.011 terminale të pikave fizike të shitjes mbështesin edhe pagesat pa kontakt, duke rritur njëkohësisht numrin e tyre përkatësisht me 1,2% dhe 3,1%, krahasuar me fundin e vitit 2021. Rritje e furnizimit dhe përdorimit të terminaleve moderne digjitale për kryerjen e pagesave në vitin 2022 vihet re edhe nëpërmjet rritjes vjetore prej 16,3% të numrit të bankomateve me funksion shtesë për depozitimin e parave të gatshme, ndërsa, përsëri, gjendja e numrit të bankomateve me funksion shtesë për fillimin e një transferte krediti është pothuajse e pandryshuar (298 bankomatë, kundrejt 297 në fund të vitit 2021).

Krahas infrastrukturës solide që mbështet pranimin e pagesave elektronike në vend, zhvillimi i digjitalizimit shihet edhe nëpërmjet përdorimit të kartela pagese të digjitalizuara. Në fund të vitit 2022, numri i kartela pagese të digjitalizuara për kryerjen e pagesave nëpërmjet celularëve dhe pajisjeve të tjera inteligjente për kryerjen e pagesave pa kontakt ishte 40.664, pjesa më e madhe e të cilave (68,6%) janë kartela pagese të digjitalizuara me funksion debiti, ndërsa pjesa tjetër i përket kartelave të pagesave të digjitalizuara me funksion krediti.

Numri i përgjithshëm i llogarive të transaksioneve të klientëve pranë bankave për kryerjen e pagesave në vend në fund të vitit 2022 është 3,75 milionë dhe shënon rënie të vogël vjetore të parëndësishme prej 0,8%, që vjen si pasojë e rënies së llogarive të personave fizikë. Për sa i përket strukturës, numri më i madh, ose 95%, i llogarive të transaksionit janë në pronësi të individëve dhe 5% nga persona juridikë. Çdo i treti depozitues person fizik zotëron llogari për kryerjen e pagesave duke përdorur kompjuterë personalë dhe/ose aplikacione celular për iniciimin elektronik të transfertave të kredisë, ndërsa nga ana tjetër, te

personat juridikë, 44,1% e numrit të përgjithshëm të llogarive të transaksionit mundësojnë pagesat elektronike, të cilat paraqet rritje me 0,8 p.p. duke përfshirë në raport edhe fundin e vitit 2021.


Në fund të vitit 2022, është vërejtur një rritje vjetore prej 16,1% e numrit të përgjithshëm të tregtarëve në vend që pranojnë pagesa me kartela pagese (14.962), e shkaktuar kryesisht nga rritja vjetore e numrit të tregtarëve në pikat virtuale të shitjes nga 19% (1603), si dhe nga rritja vjetore e numrit të tregtarëve që pranojnë pagesa me kartelë në pikat fizike të shitjes me 15,8% (13.359).

7.3. Sistemet e pagesave në vend

Në vitin 2022 vlera totale e transaksioneve në vend të realizuara nëpërmjet sistemeve të pagesave – MIPS⁷⁶, KIBS⁷⁷ dhe KASIS⁷⁸ arriti 16.714 miliardë denarë, me 32,1 milionë transaksione të realizuara, duke shënuar rënie vjetore në vlerë prej 14,2%, dhe rritje vjetore prej 1,4% të numrit të transaksioneve të kryera. Sa i përket vlerës së transaksioneve, pjesa më e madhe është realizuar përmes sistemit pagesor MIPS, dhe atë 97%, ndërsa pjesa tjetër prej 3% e numrit të përgjithshëm të pagesave janë realizuar përmes sistemit pagesor KIBS. Në strukturën e numrit të transaksioneve në të njëjtën periudhë, pjesëmarrjen më të madhe e ka shënuar sistemi pagesor KIBS (76%), i ndjekur nga sistemi pagesor MIPS me 23%, ndërsa KASIS-i ka pjesëmarrje më të vogël (0,03%).

Grafiku 88

Pagesat e realizuara përmes sistemeve të pagesave në vitin 2022



Burimi: BPRMV

Shlyerjet neto të pagesave përmes sistemit pagesor KIBS dhe sistemit pagesor KASIS kryhen në baza të rregullta përmes sistemit të shlyerjes MIPS, i cili në vitin 2022 ka punuar 247 ditë, me disponueshmëri të plotë për pjesëmarrësit e sistemit prej 100%.

⁷⁶ Banka Popullore është pronare dhe operatore e Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë (MIPS) si sistem i vetëm në vend për pagesat e mëdha dhe urgjente në denarë ndërmjet pjesëmarrësve të tij, përmes të cilit bëhet shlyerja e transaksioneve të pagesave lidhur me zbatimin e politikës monetare, realizohet shlyerja përfundimtare në sisteme të tjera pagese dhe sisteme të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe në transaksione pagesash për shtetin, autoritetet shtetërore dhe pjesëmarrësit e tjerë në sistem.

⁷⁷ Shtëpia e kliringut "Sistemi Ndërbankar i Kliringut" ShA Shkup është operator i sistemit të pagesës për shlyerje neto shumëpalëshe të shtyrë për procesimin e pagesave të vogla, shumën e të cilave nuk kalon 1.000.000 denarë.

⁷⁸ Sistemi i Kartelave Ndërkombëtare ShA Shkup (KASIS) është sistem për shlyerje neto shumëpalëshe të vonuara të pagesave me markat vendore të kartelave të pagesave.

7.4. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht

Aktivitetet mbikëqyrëse të Bankës Popullore u realizuan në baza të rregullta, në përputhje me kornizën ligjore kombëtare që ishte e vlefshme deri në fund të vitit 2022⁷⁹, dhe në të cilat janë përkthyer standardet e mbikëqyrjes të pranuar ndërkombëtarisht⁸⁰. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave që kryen Banka Popullore ka për qëllim zvogëlimin e rrezikut që lidhet me shqetësimet e mundshme në funksionimin e sistemeve të pagesave duke përcaktuar rreziqet e mundshme në operimin e tyre, dhe kryhet përmes mbikëqyrjes në terren, me inspektim të operatorit që menaxhon dhe menaxhon sistemin pagesor dhe me mbikëqyrje të rregullt jashtë vendit të funksionimit të sistemit pagesor përmes raporteve që i dorëzohen Bankës Popullore. Në këtë mënyrë, me aktivitetet mbikëqyrëse, Banka Popullore kontribuon në rritjen e besueshmërisë dhe efikasitetit në kryerjen e transaksioneve të pagesave.

Gjatë vitit 2022, Banka Popullore ka përfunduar mbikëqyrjen e pjesshme në terren të operatorit të sistemit pagesor KIBS për të vlerësuar harmonizimin e funksionimit të këtij sistemi pagesor me kërkesat e gjashtë parimeve të zbatueshme për sistemet e rëndësishme të pagesave⁸¹ dhe përfundoi se KIBS-i i respekton parimet që kanë qenë objektiv i mbikëqyrjes, ndërsa janë dhënë disa rekomandime për përmirësimin e mëtutjeshëm të funksionimit të sistemit pagesor. Me këtë mbikëqyrje filloi cikli i dytë i mbikëqyrjes mbi sistemin pagesor KIBS me zbatimin e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht.

Gjithashtu, Banka Popullore është në fazën përfundimtare të mbikëqyrjes së dytë të pjesshme në terren të sistemit pagesor MIPS për të vlerësuar harmonizimin me nëntë parimet e mbetura⁸² e funksionimit të këtij sistemi të rëndësishëm pagesor që nga cikli i parë i mbikëqyrjes me zbatimin e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht.

Në të njëjtën kohë, zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga mbikëqyrja e kompletuar në terren e sistemeve të pagesave mbikëqyret nga Banka Popullore dhe vërehet se ato janë përmbushur brenda afateve të dhëna, duke ulur kështu rrezikun e rënies dhe ndërprerjes së sistemeve.

Njëkohësisht, rregullisht është kryer mbikëqyrja në terren e sistemeve të pagesave, në bazë të së cilës është konstatuar se gjatë vitit 2022 sistemet e pagesave në vend kanë punuar me nivelin më të lartë të funksionimit, disponueshmërisë dhe efikasitetit, pa i regjistruar rëniet e sistemit.

⁷⁹ Ligji i Qarkullimit të Pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15, 199/15, 193/17, 7/19 dhe 31/20), Vendim për mënyrën dhe metodologjinë e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177/21) dhe Vendim për kriteret dhe standardet e funksionimit të sistemeve të pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/16).

⁸⁰ "Parimet mbi Infrastrukturën e Tregjeve Financiare" (PIFM) të Komitetit për Sistemet e Pagesave dhe Shlyerjeve dhe Komitetit Teknik të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë.

⁸¹ Mbikëqyrja e KIBS-it për vlerësimin e harmonizimit të funksionimit të këtij sistemi pagesash të klasifikuar si sistem i rëndësishëm i pagesave kryhet me 13 parime në një cikël.

⁸² Mbikëqyrja e MIPS-it për vlerësimin e harmonizimit të funksionimit të këtij sistemi pagesor të klasifikuar si sistem pagesor me rëndësi sistematike kryhet me 18 parime në një cikël.


VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe i monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut - operacionet e thesarit

8.1. Paratë e emetuara në qarkullim

Me gjendjen e 31.12.2022, shuma e përgjithshme e parave të emetuara në qarkullim është 53.841 milionë denarë dhe në krahasim me fundin e vitit 2021, shënojnë rritje prej 2.460 milionë denarë, ose 4,8%⁸³. Struktura e parave në qarkullim tregon se në fund të vitit, kartmonedhat përbënin 97,8% dhe monedhat 2,2% të vlerës së përgjithshme. Për sa i përket numrit të parave të emetuara në qarkullim, pjesëmarrja e kartmonedhave është 27,7% (118 milionë copë), dhe e monedhave është 72,3% (308,2 milionë copë).

Grafiku 89


Paratë e emetuara në qarkullim



Burimi: BPRMV.


Pjesëmarrje më të madhe në vlerën e përgjithshme të kartëmonedhave të emetuara kanë kartëmonedhat me vlerë nominale prej 1000 denarë (43,1%), 2000 denarë (41,4%) dhe 500 denarë (10%). Kartmonedhat e tjera marrin pjesë me 5,5% në vlerën e përgjithshme. Në vitin 2022, pjesëmarrjen më të madhe të monedhave e kanë monedhat me vlerë nominale prej 10 denarë (32,4%), 50 denarë (22,9%) dhe 5 denarë (19,8%).

